



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 50/24

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 18.03.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43, paragrafi 1 i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28, paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24, paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

### J u f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **28 mars 2024 (e enjte) me fillim në ora 10:00.**

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

### R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 shkurt 2024, vazhduar më datën 07 mars 2024
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 05 mars 2024
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2023
4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023
6. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat
7. Shqyrtimi i Planit lokal të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2024 – 2026
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për varreza të kafshëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë
9. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me objektet në rrugën “Avni Saraçi” në Vushtri
10. Pyetje dhe përgjigje

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 47/24

Nr. i fq. / Br. st - 2 -

Data: / Datum 18.03.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUÇITRN

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
PËRMES:	Sekretarisë së Kuvendit
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 15.03.2024

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **15 mars 2024** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2023  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të përmirësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
2. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi që:  
Drejtoria për Inspektime ta procedojë për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
4. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
5. Shqyrtimi i Planit lokal të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2024 – 2026  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për varreza të kafshëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë

***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***

***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

*Me respekt!*



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -II- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 29 SHKURT, VAZHDUAR MË 07 MARS 2024**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:20. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:*

Adnan Lahu, Ali Januzi, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Galip Audi, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Fatmire Cecelia, Jeton Gjaka, Mek Selaci, Refik Maloku, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

**Munguan:** Agim Bregaj, Fakete Dushi, Gentiana Rama, Gresa Muli, Nurie Halili dhe Shkelzen Xhaferi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 29 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Melihate Basholli-Latifi-kryesuese e kuvendit**-në fillim të mbledhjes prezantoi para kuvendit pikat e dërguara për rendin e ditës në të ndryshme.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit**-para kuvendit prezantoi mocionin e opozitës për shkarkimin e kryesuese së kuvendit, ku ndër të tjera shtoi se ky mocion është bërë me arsyetimin se kohëve të fundit kanë ndodhur zhvillime në kuvendin e komunës që bien në kundërshtim me praktikat parlamentare, në kundërshtim me rregulloren e punës së kuvendit, dhe në kundërshtim edhe me Statutin e Komunës së Vushtrrisë. Jemi dëshmitarë se në jo pak seanca është vepruar në kundërshtim me vullnetin e anëtarëve të kuvendit, dhe siç dihet fakti se asnjë vullnet tjetër nuk mund të mbivendoset mbi votën qytetare të përfaqësuar nga anëtarët e kuvendit, sepse në disa pika ku anëtarët e kuvendit kanë votuar pro janë konsideruar kundër dhe janë rrëzuar vendime në interes qytetar. Duke filluar nga propozim-vendimi për subvencionet për fëmijët e porsalindur, ku ky vendim kishte kaluar për aprovim, ndërsa kryesuesja konstaton se i njëjti nuk aprovohet. Pastaj nuk ishte vepruar drejt as me vendimin për aprovimin e shujtave për shërbyesit civil, por duke u nisur edhe nga praktikat tjera jo parlamentare, ku kryesuesja e kuvendit bënte shkelej permanente



dhe vazhdimisht ndikohet dhe interferohet nga kryetari i komunës dhe të tjerët. Duke marrë për bazë se kryesuesja e kuvendit duhet të jetë e pavarur, duke u nisur nga parim se pushtetet janë të ndara legjislativi dhe ekzekutivi, kërkoj nga të gjithë anëtarët e kuvendit që të mbështesin mocionin për shkarkimin e kryesueses së kuvendit, duke i dhënë dhe hapur rrugën demokracisë dhe funksionimit të kuvendit, duke bërë një kuvend dinjitozë dhe të besueshëm. Në këtë kontekst shtoj dhe vlerësoi se nuk kanë pretendime që ta marrin si parti pozitën e kryesueses së kuvendit, por ceku se ka keqpërdorim dhe keq menaxhim të kuvendit në procesin e vendimmarrjes duke prerë incizimet dhe duke devijuar procesin e vendimmarrjes. Në fund përsërit duke kërkuar që të votohet mocioni për shkarkimin e kryesueses së kuvendit, për faktin se njëjta ka dështuar në drejtimin e kuvendit dhe menaxhimit të tij, sepse mungoj investimet për sallën e kuvendit digjitalizimi, votimi elektronik gjëra për të cilat është dashur të kujdeset kryesuesja e kuvendit.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**-duke adresuar para kuvendit vlerësoi se mocioni i opozitës nuk duhet kuptuar si diçka personale, por degradimi i punës së kuvendit për dy vite radhazi është për keqardhje, kjo dëshmohet me faktin se ka shumë vendime që janë kthyer të kundërligjshme nga ministria për shkak të keq menaxhimit të kuvendit, hiq faktin se në këtë mandat ka ndodhur që të votohet për anëtarë të kuvendit që nuk kanë qenë fare prezent. Pastaj në këtë kuvend merren vendime me shumicë votash e më pas del se vendim nuk është aprovuar, nuk është misioni i opozitës që ta marr pozitën e kryesuesit të kuvendit, por qëllimi është që kuvendi ti kthehet normalitetit. Ai ftoj të gjithë anëtarët e kuvendit që ta votojnë mocionin për shkarkimin e kryesueses së kuvendit, por si duket PDK-ja paska punuar natën ashtu siç e ka zakon.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit**-tha se nuk pajtohet me dy parafolësit e tij, megjithëse ka pasur disa probleme në seancat e kaluara, sepse numërimi i votave nuk ka qenë si duhet, më tej probleme ka pasur edhe tek incizimi i mbledhjeve dhe masa duhet të merren tek IT-ja. Në fund të fundit nëse edhe i kemi votat për shkarkimin e kryesueses, atëherë kush do të udhëheq kuvendin, sepse nëse kjo pozitë do të merret nga opozita atëherë vetëm do të ketë bllokim të projekteve dhe atëherë humbës do të jenë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Në fund tha se ai nuk ka votë për shkarkimin e kryesueses, por zëri i tij do të jetë përherë kritik kur gjërat nuk shkon si duhet, por ai kurrë nuk do të bëhet pjesë e matematikave dhe makinacioneve që janë në dëm të qytetarëve.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit**-tha se gabimi i parë që bërë kryesuesja është se bëri gabimisht konstatimin e prezencës së anëtarëve të kuvendit. Pastaj shtoj se kryetari i komunës, ka nevojë të bëj intervenim në arsyen e tij dhe shtroj se ai bisedon ndonjëherë Ferit Idrizi me kryetarin e komunës duke e pyetur veten e tij se çfarë është duke bërë kryetari i komunës. Nëse shikojmë se çfarë ka bërë kryetari i komunës për këto dy vite atëherë shohim se ai ka hapur një gropë në mes të qytetit, dhe krahasoj se në vitet e 90-ta në Tiranë ka qenë hapur një gropë e quajtur “Gropa e Hajdinit” e cila ka qëndruar për 10 vite e hapur dhe edhe kryetari i komunës për dy vite është marr me këtë gropë dhe asgjë tjetër. Kjo tregon se kjo qeveri ka dështuar për sa i përket realizmit të projekteve sepse akoma nuk ka ujë të pijes, nuk ka trajtimin të ujërave të zeza, nuk funksionon trafiku publik dhe kjo qeveri nuk ka bërë asnjë punë për të cilën është e thirrur për të bërë. Andaj pyeti se çfarë do të thotë qytetarëve dhe familjes së tij pas përfundimit të mandatit, dhe supozoj se çfarë ka për deklaruar se i ka pasur vetëm 12 deputet të cilët i ka mashtruar vazhdimisht duke iu punësuar dikë, duke jap ndonjë favor. Kjo po shihet edhe sot sepse kemi mungesë të deputetëve të opozitës sepse kemi një nënkryetar i cili natën i ka kryer punët në telefon duke i bindur këtë deputet që mos të marrin pjesë në mbledhje, kështu funksionon PDK-ja sepse është parti e natës. Në fund tha se i vjen shumë keq që kryetari i komunës ka pësuar në këtë formë sepse me të ka pasur një ngjashmëri goxha të madhe në rrugëtim por i njëjti është zhytur vetëm në manipulime dhe asgjë tjetër.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit**-nisi diskutimin e tij duke vlerësuar se shkelësit e rregullores po kërkojnë shkarkimin e kryesuese së kuvendit. Ai shtoj se në fillim të mbledhjes u shkel rregullorja konkretisht neni 35 i saj ku thuhet: Para miratimit të rendit të ditës, anëtarët e kuvendit mund të diskutojnë për çështje që nuk janë të parapara në rendin e ditës, por që janë të rëndësishme dhe me interes për komunën. Prandaj meqenëse pika për shkarkimin e kryesues është në rendin e ditës atëherë kur të vjen radha e shqyrtimit atëherë duhet të diskutohet për këtë pikë. Kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që ta zbatoj rregulloren e punës së kuvendit.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit**-tha se ata që thirren në shkeljen e rregullores ata flasin me minuta të tërë duke shkelur rregulloren. Më tej shtoj se në fillim të këtij mandati është zgjedhur kryesuesja e kuvendit, dhe një ndër votat për të zgjedhur ka qenë edhe vota e tij si anëtarë i kuvendit nga radhët e LDK-së, pa pasur asnjë interes personal duke tejkalluar edhe vijat partiake e politike, por duke llogaritur që zhbllkohet puna funksionimi i kuvendit, njëkohësisht duke respektuar figurën e kandidatës znj. Melihate Basholli-Latifi si një kandidate me bagazh dhe përvojë të gjatë në jetën institucionale lokale. Sot jemi para një situatë krejt tjetër kur opozita kërkon shkarkimin e kryesueses për shkak të mënyrës së menaxhimit të këtij kuvendi jo krejt për fajin e saj, por edhe për problemet që i ka sjell qeverisja komunale në kuvend si dhe për nivelin e përbërjes së këtij kuvendi. Prandaj sot me të drejt po i kërkohet kryesues së kuvendi dorëheqja si një hapë drejt gjetjes së një zgjidhje të kësaj situatë që e ka kapluar këtë institucion tash e disa muaj. Nëse kryesuesja nuk jep dorëheqje ai do e mbështes mocionin e opozitës për shkarkimin e saj, respektivisht vendimin e kryesisë së LDK-së që mund të jetë një rrugë e rëndësishme për adresimin e situatave funksionale në kuvend dhe për të siguruar ristrukturimin e nevojshëm të funksionimit të institucionit. Zgjedhja e një kryesuesi apo kryesuese të re të afat për të udhëhequr dhe menaxhuar situatë të ndërlikuar në kuvend, mund të jetë hapi i duhur për të ristrukturuar funksionimin e institucionit të ligjvënës, kjo tregon përgjegjësi dhe përkushtim për integritetin dhe efikasitetin e këtij procesi.

*Në vazhdim grupi kuvendar i LDK-së dhe ai LVV-së leshtuan sallën e mbledhjes, ndërsa në sallë mbetën 16 anëtarë të kuvendit, kuorum i pamjaftueshëm për të vazhduar punimet e mbledhjes plenare dhe në këtë rast kryesuesja e kuvendit e ndërpreu mbledhjen në ora:10:44.*

**Më datën 07 mars 2024 ditë e enjte ora 14:20 kryesuesja e kuvendit hapi punimet e mbledhjes së ndërprerë të datës 29 mars 2024. Ajo konstatoj se në sallë janë të pranishëm 19 anëtarë (munguan 16 anëtarë të kuvendit), kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të plotfuqishme me pika e rendit të ditës të mbetura nga mbledhja e ndërprerë.**

**Prezent:** Melihate Basholli Latifi, Mentor Hasani, Kushtrim Hyseni, Nurie Halili, Basri Menxhiqi, Galip Avdiu, Zojë Hajrizi, Blerina Shala, Jeton Gjaka, Bekim Zabërgja, Mensur Kastrati, Spasoje Stefanovic, Mensur Kasumi, Arlind Grantolli, Agron Përçuku, Faton Hyseni, Behar Duraku, Alban Bajrami dhe Ali Januzi.

**Munguan:** Adnan Lahu, Agim Bregaj, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Gentiana Rama, Gresa Muli, Leonora Gërguri, Mek Selaci, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi Gjyshinca, Refik Maloku, Shkëlzen Xhaferi, Sylejman Mehulli dhe Ymer Haradinaj.

**Agron Perçuku, anëtar i kuvendit-** deklaroi sot jemi mbledhur për ta vazhduar seancën e rregullt të kuvendit komunal për të diskutuar për pikat e rendit të ditës. Një prej propozimeve për të hyrë në rend të ditës është edhe mocioni për shkarkimin e kryesueses së kuvendit komunal znj. Melihate Basholli Latifi, i parashtruar nga LDK dhe VV. Si anëtar i këtij kuvendi, unë vij nga njëra prej këtyre subjekteve politike – LDK. Në seancën e kaluar e kam mbështetur në parim këtë mocion dhe veprimet e mia janë arsyetuar me kërkesën time për dorëheqjen e kryesueses, në mungesë të funksionimit të kuvendit në mënyrën më të mirë të mundshme. Megjithatë, sot mungesa e dy partive opozitare pa asnjë alternativë tjetër, nuk i përjashton ata për përgjegjësitë që i kanë para qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Prandaj, sot përsëri i kërkoj kryesueses që të japë dorëheqje, për të siguruar funksionimin e kuvendit në një mënyrë të drejtë. Nëse kjo nuk ndodhë, unë nuk do të marrë pjesë në votim për këtë pikë të rendit të ditës. Sa u përket pikave tjera të rendit të ditës, do të jem prezent dhe do të kontribuoj në të mirë të qytetarëve të Vushtrrisë, ku për këtë jam edhe përfaqësues i tyre në kuvend. Nuk jemi këtu për t’ja rregulluar X-personit “pazaret politike”, kemi edhe obligim para qytetarëve, kur nuk ka alternativë, atëherë mos ta bllokojmë procesin e kuvendit. Kryetar dhe nënkryetar, zgjedhja apo shkarkimi i kryesueses së kuvendit është përgjegjësi e anëtarëve të kuvendit. Kërkesa ime është që të mos përziheni në udhëheqjen e kryesueses së kuvendit dhe mos shkaktoni problematika në këtë kuvend. Problemet që i keni në qeverisje komunale, po reflektojnë edhe në kuvendin komunal.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit:** pas deklarimit të anëtarit të kuvendit, Agron Perçuku se nuk merr pjesë në votim, atëherë të pranishëm jemi 18 anëtarë, kurse me mospjesëmarrjen e Agronit në votim mbesim 17 anëtarë të pranishëm dhe nuk kemi kuorum për të vazhduar punimet. Unë kisha propozuar që kërkesa për shkarkim të kryesueses mos të hedhet në votim dhe të vazhdohet me pikat tjera.

**Melihate Basholli Latifi, Kryesuese e kuvendit:** deklaroi se në këto momente na është bashkëngjitur në mbledhje edhe anëtar i kuvendit, Ali Januzi.

**Feri Idrizi, Kryetar i Komunës:** dua t’ju siguroj juve si anëtarë të kuvendit dhe qytetarët e Vushtrrisë se zgjedhja dhe shkarkimi i kryesueses së kuvendit është në dorën tuaj dhe nuk është në dorën e ekzekutivit, as në dorën time e as të nënkryetarit. Kështu që, çdo vendim që e merrni ju, për neve është i respektueshëm. Ajo çka nuk kisha dashur të shoh është që nëse janë mbledhur nënshkrimet për shkarkimin e kryesuese, atëherë kjo çështje duhet të marr një epilog për faktin se nuk guxojmë të mendojmë në bllokimin e punës së kuvendit sepse dëmtohet interesi qytetar. Apeloj që kjo çështje të votohet sot dhe të merret një vendim merititor. Po ashtu ai propozoi që në rend të ditës të futet një propozim-vendim për ofrimin e ndihmës për shërim me z.Remzi Rashicën.

**Melihate Basholli Latifi, Kryesuese e kuvendit-** njoftoj se me kërkesë të DKA-së, pika e persët e rendit të ditës duhet të hiqet nga shqyrtimi në rend dite Propozim-vendimi për emërim të komisionit për ndarjen e bursave, sepse kjo pikë gabimisht është proceduar në kuvend, sepse një komision të tillë e formon me vendim kryetari i komunës.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit i procedoj për votim në mënyrë individuale pika e dërguar në të ndryshme dhe atë si vijon:

**Kuvendi pas votimit me 17 vota “kundër” 1 votë “abstenim” dhe 1 anëtarë nuk mori pjesë në votim, nuk e aprovoj për inkorporim në rendin e ditës kërkesën e grupit kuvendar LDK dhe LVV për shkarkimin e kryesuese së kuvendit.**

**Kuvendi pas votimit me 19 vota “për” aprovoj për futej në rendin e ditës peticionin e banorëve të fshatit Nadakoc për emërimin e rrugës me emrin “Haxhi Haxha”.**

**Kuvendi pas votimit me 19 vota “për” aprovoj për futej në rendin e ditës propozim-vendimin për përkrahje financiare për shërim për z. Nysret Haradinaj.**

**Kuvendi pas votimit me 19 vota “për” aprovoj për futej në rendin e ditës propozim-vendimin për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2023.**

**Kuvendi pas votimit me 18 vota “për” aprovoj për futej në rendin e ditës propozim-vendimin për Bartjen e të Hyrave Vetanake nga viti 2023 në vitin 2024.**

**Kuvendi pas votimit me 19 vota “për” aprovoj për futej në rendin e ditës propozim-vendimin për përkrahje financiare për shërim për z. Remzi Rashica.**

**Kuvendi pas votimit me 19 vota “për” e hiqi nga rendi i ditës pikën e pestë-propozim-vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e bursave në Komunën e Vushtrrisë.**

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për” aprovoi këtë:**

## **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 janar 2024, vazhduar më datën 01 shkurt 2024;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA për Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022;
4. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2023 në Komunën e Vushtrrisë;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2023;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2023;
7. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024;
9. Shqyrtimi i peticionin e banorëve të fshatit Nadakoc për emërimin e rrugës me emrin “Haxhi Haxha”;
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim- vendimin për përkrahje financiare për shërim për z. Nysret Haradinaj;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim- vendimin për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2023;
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim- vendimin për Bartjen e të Hyrave Vetanake nga viti 2023 në vitin 2024;

13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim- vendimin për përkrahje financiare për shërim për z. Remzi Rashica;

14. Pyetje dhe përgjigje.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 janar 2024, vazhduar më datën 01 shkurt 2024;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 25 janar 2024, vazhduar më datën 01 shkurt 2024.**

2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023;

**Shaban Salihu, zv. Komandant i Stacionit Policor në Vushtrri**-paraqiti sqarime lidhur me gjendjen e sigurisë në zonën e përgjegjësisë në Vushtrri, mund të thuhet se gjendja e sigurisë është e qetë dhe stabile. Ai njoftoi se kanë një bashkëpunim të mirë me të gjithë akteret me ata komunal dhe të tjerët e gjithashtu kanë një bashkëpunim të shkëlqyeshme me qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Është inkurajues fakti se kemi rënien të numrit të veprave penale në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022. Nga 967 vepra penale sa ishin në vitin 2022 në vitin 2023 kemi 879 sosh apo rënie prej 9.1%. Sa i përket zbulimit të veprave penale është arritur objektivi në masën ku 69.3% e rasteve janë zbuluar nga ana e policisë. Gjatë vitit 2023 zyrtarët policor kanë arrestuar rreth 582 persona për raste të ndryshme. Gjithashtu ai paraqiti edhe informata tjera për dy mujorin e parë të viti 2024 duke u përgjigjur në temat e ngritur nga anëtarët e kuvendit.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA për Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me 19 vota “për” aprovoj Raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA për Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022.**

4. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2023 në Komunën e Vushtrrisë;

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2023;

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2023;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me 19 vota “për” aprovoj Raportin për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2023.**

7. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023;

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me 18 vota “për” aprovoj Planin e Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024.**

**9.** Shqyrtimi i peticionin e banorëve të fshatit Sfaracak për emërimin e rrugës me emrin “Haxhi Haxha”;

**Agron Perçuku, anëtar i kuvendit**-tha se kuvendi i komunës ka formuar listat rezervë për emërtimin e rrugëve dhe në Drejtorinë e Urbanizimit ka emra që presin për emërtim të rrugëve, dhe nëse tejkalohen këta emra atëherë po bëhet një diskriminim. Në këtë listë rezervë ka plotë emra të personaliteteve meritore dhe kësajsoj kjo çështje duhet të procedohet në Drejtorinë e Urbanizimit për trajtim të mëtejshëm për emërtimi e kësaj rruge.

**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës**-sqaroi se kjo është një rrugë e re, pjesë e një segment ku janë ndërtuar disa shtëpi dhe ata banorë kanë kërkuar që kjo rrugë të emërohet. Këta banor janë pothuajse të gjithë familjar dhe sugjeroi që kjo çështje të përkrahet.

**Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit**-tha se ka pasur kërkesa edhe më herët, ka edhe tani kërkesa për emërim të rrugëve, është më mirë që këto kërkesa të votohen në listë në pako ashtu që mos të bëhen ndarje të tilla.

**Agron Perçuku, anëtar i kuvendit**-tha se kjo çështje duhet të procedohet në Drejtorinë e Urbanizimit, komisionit kompetent për emërim të rrugëve dhe kësajsoj të bëhet emërtimi i kësaj rruge.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-tha se në komunën tonë vërtet kemi personalitete dhe figura që kanë lënë gjurmë dhe kanë hyrë në analet e historisë, por në kontekstin e emërtimit të rrugëve me emrat e këtyre figurave sikur nuk iu kemi dhënë vendin meritore. Ai përsërit një propozim të tij të kamotshëm për nënën e Sherif Tërstenës Hatiqe Tërstena, e cila ka bërë një sakrificë të jashtëzakonshme, që është torturuar nga UDB-ja jugosllave dhe edhe përkundër kësaj emri i saj askund nuk figuron. Po ashtu edhe dy figura tjera janë hallat e Gjeneralit Rrahman Rama, që kanë qenë bashkëshorte të Adem dhe Hamëz Jasharit. Prandaj lidhur me këtë çështje ai apeloj që këto figura mos ti harrojmë dhe tu japim vendin që e meritojnë. Në fund tha se është e pa dinjëtetshme që një figurë siç është Ukshin Kovaçica të emërtohet një rrugë disa qindra metra kur ai meriton shumë më tepër.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 17 vota “për” 2 “abstenime” vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën **29 shkurt 2024 të vazhduar me 07 mars 2024**, konform obligimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, ka shqyrtuar peticionin e banorëve të fshatit Sfaracak, të parashtruar në emër të z. Xhemajl Mlinaku, që lidhet me kërkesën e këtyre banorëve për emërimin e rrugës me emrin “Haxhi Haxha” në fshatin Sfaracak, andaj Kuvendi i komunës pas një analize të hollësishme, nxori këtë:

### **Rekomandim**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që ta themeloj një komision për emërimin e rrugëve (pasi që komisionit aktual i ka skaduar



mandati) dhe të merret me kërkesën që është objekt shqyrtimi për emërtimin e rrugës me emrin “Haxhi Haxha”.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, që ta informoj kuvendin e komunës dhe parashtruesit e peticionit për veprimet e ndërmarra lidhur me këtë çështje.

**10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim- vendimin për përkrahje financiare për shërim për z. Nysret Haradinaj;**

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-pyeti se deri ku ka shkuar proceduar për zbatimin e vendimit për ofrimin e ndihmës për shërim për z.Nasuf Aliu. Kërkoj që në mënyrë urgjentet të zbatohet ky vendim, mos të ketë vonesa sepse kemi të bëjmë me çështje shëndetësore.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së**-sqaroi se kodi i programi 730 shëndetësia dhe mirëqenia sociale, nën-programi 74450 shërbimet e shëndetësisë primare. Lidhur me zbatimin e vendimit për Nasuf Aliun ceku se kemi ngecej për arsye të hapjes së ID-furnitorëve në Ministrinë e Financave.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 19 vota “për” vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim z. Drilon (Nysret) Haradinaj, nga fshati Stanoc i Epërm, i ndahen mjete financiare në shumë prej pesëmijë euro (5,000.00 €), ndihmë financiare për mjekim jashtë vendit të prindit të tij Dr. Nysret Haradinaj.

**2.** Mjetet financiare të cekur si në pikën paraprake të këtij vendim do të sigurohen nga buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, kategoria subvencione dhe transfere, programi 730 shëndetësia dhe mirëqenia sociale, nën-programi 74450 shërbimet e shëndetësisë primare.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim- vendimin për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2023;**

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së**-sqaroi se duke u bazuar në Ligjin për Ndarjet Buxhetore, jemi të obliguar ta sjellim për votim këtë propozim-vendim për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2023, dhe me këtë po ruhet struktura e buxhetit e aprovuar për vitin 2023, dhe po ashtu paraqiti vlerat për secilën kategori ekonomike. Në kuadër të këtyre shumave do të hartohen edhe tabelat financiare lidhur me shpërndarjen e të hyrave vetanake në vitin 2024.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 19 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim bëhet shpërndarja e tejkallimit të planit të të hyrave vetanake për vitin 2023 në kategoritë ekonomike si në vijim:

1.1. Paga dhe Mëditje .....	11,511.00 €
1.2. Mallra dhe shërbime .....	220,900.88 €
1.3. Investime kapitale.....	666,159.46 €

**Totali i mjeteve të bartura.....898,571.34 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim- vendimin për Bartjen e të Hyrave Vetanake nga viti 2023 në vitin 2024;

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së**-paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke shtuar se në kuadër të këtij propozim-vendimi kemi edhe tablat ku janë projektet shumica të kontraktuara dhe disa janë projekte të reja.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga Fondi (21) për vitin 2023 në vitin 2024 në kategoritë si në vijim:

1.1 Paga dhe Mëditje .....	20,000.00 €
1.2 Mallra dhe shërbime .....	55,787.12 €
1.3 Shpenzime komunale.....	9,268.14 €
1.4 Subvencione dhe transfere.....	15,679.78 €
1.5 Investime kapitale.....	560,799.04 €

**Totali i mjeteve të bartura.....661,534.08 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim- vendimin për përkrahje financiare për shërim për z. Remzi Rashica;**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim z. Remzi Rashica, nga fshati Studime e Poshtme, i ndahen mjete financiare në shumë prej pesëmijë euro (5,000.00 €), ndihmë financiare për mjekim jashtë vendit.

2. Mjetet financiare të cekur si në pikën paraprake të këtij vendim do të sigurohen nga buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, kategoria subvencione dhe transfere, programi 730 shëndetësia dhe mirëqenia sociale, nën-programi 74450 shërbimet e shëndetësisë primare.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**14. Pyetje dhe përgjigje:**

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-** parashtror pyetje për Drejtoreshën e Urbanizimit, në vitin e kaluar kompania kontraktuese “Rahovica comerc” ka shtruar dy rrugë në fshatin Gracë, ndërsa dy anësoret kanë mbetur pa u mbushur me zall, për këtë pyeti se a do të ndërmerren veprime për të përfunduar këto punime.

**Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-**pyeti drejtoreshën e Urbanizimit se si do të veprohet për emërimin e rrugëve a do të veprohet sikur më herët me peticione apo përmes komisionit. Ndërsa drejtoreshën e Kulturës pyeti për rregullimin e disa raftave në muzeun e shkollës në Oshlan. Drejtorin e Shërbimeve Publike e pyeti se a është paraparë rregullimi i kanalizimit të shkollës në fshatin Oshlan.

**Blerina Shala, anëtare e kuvendit-**pyeti Drejtorin e Shërbimeve Publike se ka ndërmarr ndonjë masë për rregullimin e urës në rrugën kryesore që lidhë fshatin Pantinë me fshatin Oshlan.

**Fortun Krasniqi, drejtoreshë e DUMM-së-**njoftoi se mbushja e bankinave në fshatin Gracë, do të bëhet pas përmbushjes së obligimeve kontraktuale ndaj operatori ekonomik, ku kontrata është deri në muajin qershor 2024 kështu që jemi brenda kontratës. Ndërsa lidhur me emërimin e rrugëve do të jep përgjigje me shkrim.

**Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-**sqaroi se ka mjetet të planifikuar dhe kanalizimi dhe ura në fshatin Oshlan do të trajtohet këtë vit.

**Agron Perçuku, anëtar i kuvendit-**pyeti kryetarin e komunës lidhur me një tender që është i vitit 2021 për renovimin e objekteve sportive, nga gjendja në teren shihet se nuk është bërë asnjë investim, pyeti se këtë vit a do të ketë investime në objektet palestra sportive, stadiumi i gomës dhe

stadiumi i Qytetit të Vushtrrisë, çfarë do të ndodh me atë tender a është anuluar apo do të vazhdoen investimet.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-sqaroi** se ka disa tender apo projekte që kanë mbetur të pa përfunduara siç është ai i Depos së patates për të cilin komuna ka paguar një dënim rreth 45,000.00 €, për shkak se kur është vendosur të ndërtohet në fshatin Pestovë është vendosur me vendim të Kuvendit të Komunës sipas procedurës së rregullt, ndërsa kur është vendosur të dislokohet në fshatin Nadakoc është bërë vetëm me vendim të ish-kryetarit që ka përbërë shkelje dhe operatori e ka paditur komunën dhe e ka fituar rastin. Projekti tjetër është ai i Stadiumit “Musa Abazi” dhe për këto projekte do të shkëputen kontratat, sepse këtyre operatorëve iu është dhënë mundësia që ti kryejnë punët dhe nuk i kanë përfunduar sipas afatit. Lidhur me kontratat e lidhur në këtë mandat të gjitha janë duke u përcjllur nga afër dhe shumica e projekteve kapitale në vlera të mëdha janë hartuar projekte dhe ato do të përfundojnë brenda afatit.

**Mbledhja përfundoi në ora: 15:30.**

**Bastri Duraku**

---

**Procesmbajtës**

**Melihate Basholli-Latifi**

---

**Kryesuese e Kuvendit**



REPUBLIKA E KOSOVË



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,**  
**MBAJTUR MË 5 MARS 2024 PËR NDER TË EPOPESË SË UÇK-së**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:05.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, Kryetari i komunës z.Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z.Shpëtim Zhegrova, drejtorët e drejtorive komunale, kryetari i Bashkësisë Islame në Vushtrri, zv. Komandanti i Policës në Vushtrri, përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, anëtarë të familjeve të dëshmorëve, përfaqësues të subjekteve politike në Vushtrri, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtarë tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë ka kuorum të mjaftueshëm për zhvillimin e mbledhjes.

Në fillim të mbledhjes u intonua himni kombëtar dhe ai shtetëror i Kosovës, në nderim të jetës dhe veprës së Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe Epopesë së UÇK-së.

Më pas kuvendi me një minutë heshtje nderoi jetën dhe veprën e Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe gjithë të rënëve për liri.

**Melihate Basholli-Latifi – kryesuese e kuvendit-** I nderuari Kryetar i komunës, z. Ferit Idrizi; I nderuari nënkryetar i komunës, z. Shpëtim Zhegrova;

Të nderuar drejtorë të drejtorive;

Të nderuar anëtarë të kuvendit;

Të çmuar familjarë të dëshmorëve, të veteranëve, të invalidëve, të martirëve e të rënëve për liri;

Të nderuar përfaqësues të organizatave të dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

Të nderuar përfaqësues të partive politike;

Të nderuar përfaqësues të FSK-së, KFOR-it, të policisë së Kosovës;

Të nderuar përfaqësues të mediave, të shoqërisë civile dhe ju të pranishëm;

Zonja dhe zotërinj;

Shumë të nderuar qytetarë të Komunës së Vushtrrisë.

Jam jashtëzakonisht e nderuar dhe e privilegjuar që sot të shpall të hapur këtë seancë solemne kushtuar Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes Jashari, dëshmorëve, martirëve dhe të rënëve për liri. Në çdo përvjetor të datave 5, 6 e 7 mars, ne përkujtojmë sakrificën sublime, vetëflijuese e unike të familjes Jashari, kujtojmë e nderojmë luftën për çlirim dhe rënien heroike të kryekomandantit tonë legjendar Adem Jashari, përkujtojmë dëshmorët, martirët e të rënëve për liri. Kujtojmë e nderojmë luftën e shenjtë

të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; kujtojmë e nderojmë veteranët e invalidët e luftës; kujtojmë e nderojmë të burgosurit politik; kujtojmë dhe nderojmë viktimat civile, sakrificën e popullit, sakrificën e secilit që punoi e kontribuoi për çlirimin dhe shtetndërtimin e vendit. Të nderuar të pranishëm, derisa sot kujtojmë se sa e gjatë, sa sfiduese e sa e mundimshme, por edhe me plot krenari, ka qenë rruga për çlirim, për liri e për pavarësi, duhet të mos harrojmë se ne duhet të jemi të bashkuar e të përkushtuar që të jetësojmë synimin e më të mirëve tanë ndër breza. Sa herë i kujtojmë ata, ne rivlerësojmë se sa e shenjtë e sa e rëndësishme është liria dhe bashkohemi më shumë se kurrë për realizimin e idealeve tona, gjegjësisht idealeve të dëshmorëve tanë. Derisa sot përkujtojmë këto data të rëndësishme të historisë sonë, fatkeqësisht në mesin tonë nuk gjenden çlirimtarët tanë të cilët padrejtësisht po gjykohen në Gjykatën e Hagës, për çka jemi të sigurt se do të dalin fitimtar edhe kësaj radhe. Qoftë i përjetshëm nderimi e kujtimi për Kryekomandantin Legjendar Adem Jashari dhe familjen e tij! Qoftë i përjetshëm nderimi e kujtimi për dëshmorët, martirët e të rënë për këtë vend brez pas brezi! Qofshim ne ata që realizojmë ëndrrën shekullore kombëtare! Ju faleminderit për vëmendje!

**Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë**—në fillim të diskutimit të tij përshëndeti gjithë të pranishmit:

Të nderuara familje të dëshmorëve;

Të nderuara familje të martirëve;

Të nderur ish të burgosur politik;

I nderuar kryetar i Shoqatës të Familjeve të Dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

I nderua zv. Komandant i Stacionit Policor në Vushtri;

I nderuar kryetar i Bashkësisë Islame në Vushtri;

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë;

Të nderuar përfaqësues të subjekteve politike në Vushtri;

I nderuar nënkryetar i komunës, kryesuese e kuvendit, drejtor të drejtorive komunale, gjithë ju të pranishëm;

Të dashur qytetarë të Komunës së Vushtrrisë.

Sot është një ditë e veçantë edhe për nga dimensionin historik, edhe për nga festa e madhe historike, por edhe për nga lavdia që nuk ka penë e as shkrim që mund t'i thurë lavditë dhe ta përshkruajë në detaje këtë ditë të madhe. Është epopeja e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është fillimi i një epoke të re, është fillimi i një dekade të re, është lufta çlirimtare e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, është qëndresa heroike e familje Jashari, është lufta unike për liri dhe pavarësi kombëtare, është lufta e cila kulmoi me involvimin e faktorit ndërkombëtar, është lufta që bëri botën demokratike dhe faktorin ndërkombëtar, të kthejnë kokën kah shqiptarët e Kosovës që luftuan gjatë për liri dhe pavarësi që kur u nda Shqipëria në vitin 1913 dhe u futën forcat serbe në këto territore. Lufta jonë ka vazhduar përgjatë gjithë historisë me sakrificën më sublime në vitin 1918-1924, për të vazhduar në vitin 1945, sakrificat në demonstratat e vitit 1968, 1981, greva e minatorëve e vitit 1989, rezistenca paqësore e viteve 90 –ta, që kulmoi me daljen në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me 28 nëntor 1997 dhe në fund sakrificat sublime e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij dhe deri në atë kohë faktori ndërkombëtar i shikonte karshi proceset që po zhvilloheshin në trojet shqiptare, veçanërisht në Kosovën e okupuar të gjakosur e të robëruar nga okupatori serb. Por Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij i aktivizoi mekanizmat ndërkombëtarë dhe ishte vetë ambasadori amerikan ai i cili kishte dhënë një deklaratë ndryshe për Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ishte i pari Robert Gelbard që i shprehu ngushëllime familjes Jashari dhe ishte diplomacia ndërkombëtare e cila iu kthye fuqishëm në mbështetje popullit



shqiptar në mbështetje të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kjo shënon kthesën nga një luftë guerile në një luftë frontale të përmasave kombëtare ku u thirr edhe mobilizimi i përgjithshëm. Ishte kjo koha më e lavdishme, por pa armatim të mjaftueshëm për të gjithë ata vullnetarë dhe vullnetare të cilët prisnin në rresht për të ngjitur Bjeshkëve të Nemura për ta kaluar kufirin Kosovë-Shqipëri, për të arritur deri në Tropojë për t'u armatosur dhe për t'ju bashkëngjitur luftës çlirimtare. Prandaj sot në këtë ditë të shenjtë në epopenë e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe rënien heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, sot shënojmë epopenë e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sot flamujt valojnë lirshëm në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjithçka që ndodhi gjatë historisë sonë kulmoi me lirinë dhe pavarësinë e Kosovës e cila për 100 vjet ishte e okupuar nga barbarët serbë. Andaj ne të gjallët jemi të privilegjuar, ne të gjallët jemi me fat që e pritëm këtë ditë dhe e festojmë këtë ditë në mënyrën më të mirë në vendin tonë në institucionet tona, të bashkuar i gjithë spektri politik i Kosovës, bashkë me shoqatat e dala nga lufta dhe me familjet e dëshmorëve, bashkë me veteranët dhe invalidët e UÇK-së, ata që i lanë gjymtyrët e tyre në betejat e luftës vetëm e vetëm për t'ia sjellë lirinë Kosovës.

Si kryetar i komunës së Vushtrrisë ndihet i privilegjuar të adresohet përfaqësuesve të zgjedhur të qytetarëve të Vushtrrisë dhe është nder që në mesin tonë kemi edhe dy bashkëluftëtarët e Komandantit Legjendar Adem Jashari z.Ali Januzi-Pasoma dhe z.Ramadan Manovi që kontribuan për lirinë e Kosovës.

Në fund ai apeloj për të gjithë që në ditë festive të këtyre datave të gjithë të jemi të bashkuar, sepse të gjithë jemi hisedar të këtyre festave, të bashkohemi rreth sakrificës së Komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse emblema e UÇK-së është vula e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Lavdi e nderim jetës dhe veprës të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij dhe gjithë dëshmorëve të kombit respekt!

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**- në fillim të diskutimit të tij përshëndeti gjithë të pranishmit:

Të nderuara familje të dëshmorëve;

Të nderuara familje të martirëve;

Të nderur ish të burgosur politik;

I nderuar kryetar i Shoqatës të Familjeve të Dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

I nderua zv. Komandant i Stacionit Policor në Vushtrri;

I nderuar kryetar i Bashkësisë Islame në Vushtrri;

Datat 5,6 dhe 7 mars 1998 kanë hyrë në analet e historisë më të re për Kosovën dhe shqiptaret anë e mbanë ka ata jetojnë. Këto data në kujtojnë dëshmoret të cilët iu kemi shumë borxh dhe asnjëherë nuk guxojmë ti harrojmë sepse këtë janë shtyllat e atdheut tonë, janë krenaria jonë. Kjo për faktin se ne që sot jemi të lirë jemi në saje të heroizmit të tyre. Në vazhdim citoj disa vargje të poetit tonë të mirënjohur Naim Frashri: <Shumë e bardhë kjo ditë për të gjithë shqiptaret, do të na sjell në dritë që s'kishin të parët> dhe shtoj se kush e solli këtë dritë vërtet gjaku i dëshmorëve. Në çdo përvjetor ne i kujtojmë me dhimbje por jemi edhe krenar me veprat e tyre të cilat do të mbesin të pavdekshme në faqen e historisë sonë të lavdishme. Në vazhden e diskutimit të tij ai evokoj disa kujtime me Komandanti Legjendar Adem Jashari, dhe familjaret e tij se si kishin bërë plane për organizmin e radhëve të UÇK-së dhe përballjen me armikun serb. Në fund ai tha se Adem Jashari dhe familja e tij janë madhështore do të mbesin të pavdekshëm në memorien kolektive të kombit tonë. Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!

**Gëzim Zuçaku, kryetar i Shoqatës të Familjeve të Dëshmorëve** - në adresimin e tij para anëtarëve të kuvendit pasi përshëndeti gjithë të pranishmit, tha se sot, me krenari kujtojmë ditët e Epopesë së UÇK-së: 5, 6 dhe 7 marsin e 1998 – ë. Me krenari kujtojmë luftën e Komandantit

Legjendar Adem Jasharit. Me krenari kujtojmë sakrificën e madhe të Jasharëve legjendarë. Nuk ka përkufizim gjuhësor, historik dhe filozofik që kap përmasat e kësaj sakrifice. Kjo Epope mori përmasat e ngjarjeve të krijimit të botës së re në hapësirat gjeografike shqiptare, të ndërrimit të epokës së robërisë nga epoka e lirisë. Në ditët e Epopesë së UÇK-së u sprovuan vlerat më të larta të kombit: trimëria, besnikëria dhe shpirti heroik. Përmasa e flijimit historik mori dimensione legjendare. Ato ditë heroike nuk u bënë gërmadha kullat e Jasharëve, në të vërtetë, gërmadhë u bë sundimi serb në Kosovë. Gurët e kullave të Jasharëve u bënë gurë të piramidave kufitare të shtetit të Kosovës. Prandaj kjo sakrificë legjendare për liri u bë model unikat në historinë kombëtare dhe botërore. Njerëzit shpirtmëdhenj jo vetëm prekën historinë, por i dhanë trajtë asaj. Dhe çmimi ishte i lartë, por, faqja e historisë u bë shumë e ndritshme. Me luftën dhe rënien e tyre UÇK-ja u rrit në përmasa gjithëkombëtare, diplomacia botërore u vu në anën e luftës së drejtë të shqiptarëve. Me të drejtë, në analet e historisë moderne botërore, Ushtria Çlirimtare e Kosovës vlerësohet si projekti më i suksesshëm politiko-ushtarak. Vizioni politik i UÇK-së krijoi parakushtet për intervenimin e Aleancës më të fuqishme ushtarake në interes të vendit tonë. Në këto ditë të shënuara ndjejmë dhimbje të madhe sepse krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe komandantët e saj gjenden padrejtësisht në Tribunin e Hagës, sepse në këtë rast nuk akuzohet individi, por akuzohet lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këto përmasa që po zhvillohet rendi i ri ndërkombëtar, besojmë dhe shpresojmë se do ta kuptojnë se Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte e drejtë dhe e saktë dhe se ne nuk ishim agresorë, por ishim viktimë, ne shpresojmë që krerët e UÇK-së shumë shpejt të lirohen dhe të kthehen fitimtar në Kosovë. Lavdi Komandantit Legjendar Adem Jashari, lavdi gjithë Dëshmorëve të kombit, nder dhe respekt për gjithë invalidët dhe veteranët e UÇK-së, urime Epoja e UÇK-së, Zoti e Bekoftë Republikën e Kosovës dhe popullin e saj.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-** në adresimin e tij para kuvendit si përfaqësues i LDK-së pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi:

Sigurimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore definohet si “sistem i organizuar për përmirësimin e praktikave apo kualitetit të kujdesit mjekësor”. Përmirësimi i kualitetit përfshin përpjekjet e vazhdueshme nga të gjithë anëtarët e organizatës për të përbushur nevojat dhe pritjet e pacientëve. Gjatë vitit 2023 aktiviteti ynë ka qenë i orientuar në plotësimin e kriterëve dhe dokumentacionit të Sitemit të Menaxhimit të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore në monitorimin dhe vlerësimin e auditorit të jashtëm, të anagazhuar nga AQH Zvicrane.

Gjatë vlerësimit kemi pasur një vlerësim 8 orësh nga Auditor ndërkombëtar dhe vlerësimi preliminar ka qenë që i kemi plotësuar kriteret për menaxhimin e blloqeve (12 blloqe të vlersimit) në mënyrë të kënaqëshme me disa vërejtje që duhet t'i plotësojmë për vlersimin e ardhshëm në vitin vijues.

Gjatë këtijë viti kemi punuar në informimin e stafit për shfrytëzimin e procedurave operative standarde dhe kemi vendosur në çdo vend pune në formë të shkruar PSO (Porcedura Standarde Operative) si dhe përgjegjësitë

e shërbimeve ku stafin e kemi furnizuar me literaturën dhe janë obliguar t'i monitorojnë në ngritjen e nivelit të shfrytëzimit të PSO.

Në bazë të planit, gjatë këtij viti kemi mbajtur 4 takime të Komiteteve të Cilësisë duke i adresuar detyrat dhe aprovimin e dokumentacionit që është i domosdoshëm për plotësimin e dokumentacionit të SMC (Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë). Në mbledhjen e fundit kemi aprovuar tre (3) dokumente që kanë qenë Konformitetet të mëdha nga vlerësimi dhe tani kemi plotësuar obligimet e SMC nga vlerësimi.

Në këtë vit është punuar një Audit (Shkalla e vlerësimit të vaksinimit me Hep.C te stafi) dhe janë marr hapat e duhur që t'i sigurojmë vaksinat e duhura, që të krijojmë siguri të stafit në punë dhe që është duke u zhvilluar. Gjithashtu është punuar edhe një Rishqyrtim Kolegial për të ndihmuar Vizitat shtëpiake të fëmijëve, grave shatëtzëna dhe pacientëve me gjendje të rëndë terminale, me rekomandime që të rritet efikasiteti i këtij shërbimi.

Për ngritje të nivelit të cilësisë së SHSH në bashkëpunim me Drejtorin e drejtorisë së Shëndetësisë së Komunës, kemi zhvilluar edukimin për ultrazërin e abdomenit që ka pasur sukses dhe shpresojmë të vazhdojmë me punë pas Vitit të Ri.

### Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

Bazuar në raportin e ZHVP-së lidhur me aktivitetet e ndërmarrura, ka bërë bashkëpunim me QZHMFM-në Prishtinë dhe QTMF-në Mitrovicë, duke realizuar planprogramin gjatë vitit 2023. Koordinatorin e Cilësisë së bashku me Kryeinfermieren e QKMF-s dhe trajnerët e Mjekësisë Familjare ka bërë një Audit-klinikë dhe një Rishqyrtim kolegial, po ashtu në pjesën e dytë të vitit 2023.

ZHVP- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional për mjekët dhe infermierët, është komponent me rëndësi të veçantë për institucionin e QKMF-së. Në QKMF mbahen takime të rregullta me mjekë dhe infermierë të cilat organizohen përmes përgjegjëses për ZHVP. Gjatë vitit mbahen takime profesionale për profesionistët mjekësor, për çdo muaj 10 ligjërata, këto ligjërata nuk mbahen vetëm në muajin korrik dhe gusht. Zakonisht janë mbajtur ligjërata me tema që kanë qenë të përzgjedhura nga këshilli profesional i QKMF-së dhe nga ky vit janë të certifikuar nga OMK.

ZHVP gjithashtu mbanë ligjërata të përmuajshme për infermierë dhe ligjërata në komunitet, me theks të veçantë në edukim dhe promovim shëndetësor. Ligjëratat në komunitet mbahen zakonisht në viset rurale, në objektet e qendrave shëndetësore apo në shkolla fillore, ligjëratat mbahen edhe për adoleshentët në shkollat e mesme.

### Këshillimorja për Edukim dhe Motivim Shëndetësor

Këshillimorja për Edukim dhe Motivim Shëndetësor, për sëmundje kronike joinfektive me theks Hipertensionin, Diabetin dhe Astma, është fryt i bashkëpunimit me donatorë Zvicëran për kujdes të qashtëm dhe cilësor (AQH).

Vizita mjekësore, matjes së tensionit, glikemisë dhe asthmus, furnizimi me broshura për edukim dhe preventivë për këto sëmundje, dhënia e librezave për pacientë ku përshkruhet edhe terapia që e merr pacienti, regjistrimi i matjeve të tensionit dhe glikemisë për përcjellje të gjendjes shëndetësore. Po ashtu është bërë trajnimi i stafit shëndetësor, mjekë dhe infermierë, për edukim shëndetësor motivues, ku kemi përfituar trajnime të shumta si për stafin menaxherial, profesionistët shëndetësor. Numri i pacientëve nga janari deri në dhjetor 2022, këshillimore për sëmundje kronike, në KPSH si QKMF, QMF-1 QMF-2, QMF-3, QMF dhe AMF 7 fshatra, janë këshilluar pacientë me sëmundje kronike Diabet, Hipertension dhe Asthma.

Të dhëna për hipertensionin, diabetin dhe astmën, në 2023.

Numri i përgjithshëm i pacientëve në këshillimore për periudhën janar – dhjetor 2023:

Nr.rendur	Sëmundjet	Nr.pacientëve	Nr.Shërbimeve
1.	Diabet	243	988
2.	Hipertension Arterial	17	70
3.	Vizita Astmë	7	30
4.	Pacient me DM dhe HTA	932	3786
5.	Pacient me faktor rrezikut DM-HTA	16	66
Totali		1215	4940



Vizitat shtëpiake për gra shtatzëna, lehonat dhe fëmijët deri në moshën 3 vjeç

Gjatë vitit 2023, DSHPS dhe QKMF kanë arritur të vazhdojnë bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me donatorë për realizimin e projekteve me bashkëfinancim.

Në koordinim dhe bashkëpunim të MSH, UNICEF-in dhe AMC-ën, vazhdohet të implementohet programi i vizitave shtëpiake për gra shtatzëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare.

Në bashkëpunim me UNICEF-in dhe AMC-në kemi vazhduar projektin për vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare.

Si rezultat i përbushjes së planprogramit, QKMF është shpërblyer me një veturë për kryerjen e vizitave në terren nga Ministria e Shëndetësisë.

Puna në terren ka mundur të hasim në shumë raste me interes, mirëpo rastet të cilat janë referuar për trajtim dhe identifikim të mjekut familjar, pastaj te pediatri, kanë qenë gjithsej 15 të tilla. Këto raste të veçanta kryesisht kanë të bëjnë me ngecje në rritje dhe zhvillim.

Numri i vizitave shtëpiake në komunën e Vushtrrisë, në vitin 2022:

Shërbimet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Numri i vizitave për fëmijët 0-3 vjeç	383	314	338	223	295	339	444	366	477	426	284	165	4054
Numri i vizitave për shtatzëna	59	47	45	23	78	58	84	72	65	55	37	39	662
Numri total i vizitave.	442	361	383	246	373	397	528	438	542	481	321	204	4716

Qytetarët e komunës së Vushtrrisë, në nevojë për dhënie dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore, përveç vizitave mjekësore janë dhënë shërbime të ndryshme si dhe janë aplikuar terapitë e nevojshme nga projekti, sipas listës esenciale të Ministrisë së Shëndetësisë.

Nga muaji janar 2023, projekti konkretisht realizohet me përpikëri sipas marrëveshjes, ku kemi 6 ekipe mjekësore të përbërë nga 1 mjek dhe 2 infermierë. Puna për ofrimin e shërbimeve mjekësore ditore është kryer sipas këtij plani me dy ekipe mjekësore (2 mjekë dhe 4 infermierë), njëri ekip i cili e organizon punën për dhënie e shërbimeve mjekësore në vise urbane, kurse tjetri në vise rurale me dy automjete. Terapinë dhe materialin e nevojshëm për ofrimin e shërbimeve mjekësore, si këshillimin (pacientët me sëmundje kronike, pacientët me sëmundje malinje, shtatzënat dhe lehonat etj.), vizitat mjekësore, marrjen e anamnezës, matjen e tensionit, matjen e glukozës, matjen e saturimit, matjen e pulsit, matjen e temperaturës, përshkrimin e terapisë sipas nevojës, EKG, dhënie e terapisë paranterale (intravenoze dhe intramuskulare), kateterizimin, pastrim dhe fashim të plagës deri në shërim, referime te nivelet tjera të kujdesit shëndetësor sipas nevojës.

Orari i punës është 7/13 orë, që do të thotë se punohet 7 ditë të javës me orar 13 orë, duke përfshirë edhe vikendet, festat etj.

Ofrimi i shërbimeve mjekësore për vizitat shtëpiake sipas marrëveshjes së Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide me seli në Prishtinë.

Nr.	Raport 12 mujor 2023	Numri total i vizitave	Meshkuj	Femra	Numri i vizitave të pacientëve mbi 65 vjeç	Numri i vizitave lehonave	Numri i vizitave të fëmijëve deri 3 vjeç	Totali i Shërbimeve
1	Janar 2023	2765	1019	1746	945	37	288	8077

2	Shkurt 2023	3264	1176	2088	1046	51	341	1249
3	Mars 2023	3180	1250	1930	1016	45	338	6309
4	Prill 2023	2278	919	1359	999	23	217	6284
5	Maj 2023	4240	1182	3058	989	78	298	13283
6	Qershor 2023	2401	962	1439	914	58	339	6262
7	Korrik 2023	2338	1039	1299	927	84	424	5418
8	Gusht 2023	2770	1194	1576	983	72	366	11286
9	Shtator 2023	2524	1096	1428	934	20	75	5839
10	Tetor 2023	1487	744	743	806	15	63	3003
11	Nëntor 2023	1371	660	711	810	18	100	2829
12	Dhjetor 2023	1729	693	1036	908	33	54	3038
	<b>Totali</b>	<b>30347</b>	<b>11934</b>	<b>18413</b>	<b>11277</b>	<b>534</b>	<b>2903</b>	<b>72877</b>

#### Shtëpia Rezidenciale Lumadh

Ka si pikësynim që rezidentët të marrin asistencë individuale nga punëtorët dhe të ndjejnë siguri në veprimet e veta dhe kjo arrihet me vetëpërmbytje e durim të madh të punonjësit social, pasi që veprimet e rezidentëve janë të ngadalshme dhe të pakoordinuara, varësisht shkallës së zhvillimit psikik, andaj kujdesi duhet të jetë maksimal.

Momentalisht i kemi 12 rezidentë, prej tyre janë 10 femra dhe 2 meshkuj.

Rezidentët i kemi nga komunat e ndryshme si në vijim :

Komuna e Vushtrrisë 4, Komuna e Mitrovicës 2, Komuna e Skenderajt 2, Komuna e Prishtinës 2, Komuna e Obiliqit 1, Komuna e Shtimes 1.

Procedurat dhe kriteret për vendosjen e personave në shtëpi komuniteti janë respektuar në bazë të udhëzimit administrativ Nr.11/2014. Marrëveshja e Mirëkuptimit (MM) në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPS) dhe Komunës së Vushtrrisë, në vitin 2015.

Kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me QPS-të e komunave të lartëcekura dhe vizita të ndryshme nga personat përgjegjës për rastet që ndodhen në strehim.

#### Puna në grup

Kjo metodë e punës sociale kërkon një durim dhe përkushtim të jashtëzakonshëm pasi që të gjitha veprimet e rezidentëve janë të pakoordinuara. Puna në grup ka për qëllim rritjen e shkallës së shkathtësive sociale, personale të rezidentëve, që me punë dhe veprime të ndryshme kërkohet që të arrihet qëllimi i caktuar i integritetit dhe bashkëpunimit më të mirë në rrethin social.

#### **Qendra për Punë Sociale**

Në Asistencë Sociale janë 1224 familje, prej tyre 1171 familje me 5197 anëtarë janë shqiptarë si dhe 53 familje me 134 anëtarë janë minoritete. Gjatë këtij viti janë parashtruar 88 kërkesa për asistencë sociale, prej të cilave 54 janë aprovuar, ndërsa 34 prej tyre janë refuzuar si familje të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret. Ndërsa janë riaktivizuar 14 familje. Asistenca sociale i është ndërprerë 119 familjeve, të cilat kanë qenë shfrytëzuese të asistencës sociale.

## Shërbimet Sociale

Në periudhën raportuese krahasuar me vitin paraprak, numerikisht, numri i klientëve ka pasur ngritje si rezultat i trajtimit të kategorive të reja dhe e gjithë kjo ka rezultuar edhe me rritjen e evolumit të punëve dhe ofrimit të shërbimeve përmes formave të mbrojtjes sociale. Të gjitha këto konkretizohen përmes shënimeve të mëtutjeshme. Vlenë të theksohet se gjatë kësaj periode kemi pasur 48 raste të trajtimit të bashkëshortëve me marrëdhënie të çrregulluara, ku 19 janë në procedurën e shkurorëzimit, 7 kanë arritur pajtim dhe 22 ndarje.

Nga këto familje janë 34 fëmijë, prej tyre 13 i janë besuar nënës në përkujdesje, ndërsa 21 u janë besuar babait në përkujdesje. Gjithashtu kemi pasur edhe 10 kërkesa për besimin e fëmijeve nga gjykata, për të cilat janë dhënë mendime dhe janë punuar raportet vlerësuese të gjendjes së tyre sociale, ekonomike dhe emocionale. Janë zbatuar në masë më të madhe format e mbrojtjes sociale si, vënia nën kujdestari të fëmijëve pa kujdes prindëror (2 raste), 3 kujdestari për raste të veçanta, asistencë sociale si dhe shërbime të tjera të punës sociale. Ndiqma (në natyrë) këtë vit, krahasuar me atë paraprak, ka qenë shumë më e vogël me që është varur nga donatorët.

Në këtë periudhë kemi këtë gjendje: 26 raste të delikucencës së të miturëve dhe 5 raste fëmijë me sjellje asociale, 31 raste kundravajtje, gjithsej 62 raste të trajtuara të fëmijëve në konflikt me rregullat dhe ligjin.

Punëtorët e shërbimeve sociale asistojnë në polici dhe gjykatë për rastet e të miturëve delikuent në përgjithësi. Në këtë drejtim me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira në procesin e risocializimit dhe riedukimit kemi pasur bashkëpunim të drejtëpërdrejtë me policinë, familjen, Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe subjektet e tjera.

Gjatë tretmanit psiko-social të fëmijëve dhe të miturve, Qendra ka vendosur kontakte permanente me të miturit, familjet apo kujdestarët e tyre si dhe bashkëpunim me subjekte tjera si OJQ, shkollat etj. Puna ka qenë e përqëndruar në identifikimin gjegjësisht diagnostifikimin e rastit, hulumtimin e personalitetit të fëmijut, identifikimin e interesave të të miturit dhe harmonizimin me normat e përgjithshme morale dhe juridike, organizimi dhe racionalizimi i kohës së të miturëve, etj.

Gjatë periodës që po raportojmë ka pasur shtim të rasteve ku kemi 48 raste të raportimit të dhunës familjare, ndaj femrave dhe raste ndaj antarëve të familjes, çka është mjaft brengosëse kur të kemi parasysh se rastet po shtohen dhe ekipet e Qendrës për Punë Sociale duhet të jenë në gadishmëri që t'ju ofrojnë asistim në polici, asistim në gjykatë, vendosje në strehim të përkohshëm, seanca konsultuese e këshilluese dhe bashkimin familjar.

Sikurse edhe kategoritë e tjera të mbrojtjes sociale edhe këto kategori të moshës së pleqërisë kanë pasur tendencën e rritjes, mirëpo në këtë periudhë rëndësi të veçantë i kemi kushtuar sidomos të moshuarve pa kujdes familjar ku i kemi pasur të vendosur 4 raste, 3 në shtëpinë e pleqëve në Skenderaj dhe 1 në Prishtinë, 2 kërkesa të reja ku janë dhënë 2 raporte për bashkim familjar, tek të afërmit jashtë shtetit.

Vlenë për tu theksuar se pranë kësaj qendre janë 53 familje minoritare shfrytëzues të ndihmës sociale, prej tyre 20 familje serbe, 28 rome, 4 familje ashkalinjë dhe 1 familje turke.

## Administratë

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar dhe u është dhënë përgjigje të gjitha kërkesave të palëve brenda afateve të përcaktuara. Kemi vazhduar me shërbimin e veçantë për bashkatdhetarë gjatë muajve të verës, me ç'rast kemi caktuar tre (3) sportele të veçanta vetëm për bashkatdhetarët me qëllim të shërbimit sa më të mirë dhe më të shpejtë për mërgimtarët e komunës sonë. Po ashtu me vendim të kryetarit të komunës Zyra e Gjendjes Civile ka filluar të punoj edhe të shtunave prej orës 10:00 deri në ora 14:00.

Komisioni kompetent për përzgjedhjen e këshillave lokale, ka vazhduar me përzgjedhjen e 7 kryetarëve të këshillave lokale, duke e plotësuar kështu në 25 numrin e kryetarëve të këshillave lokale. Si drejtori, kemi pajisur me kartela identifikuese të gjithë kryetarët e këshilleve, përmes një procedure të prokurimit.

Gjatë vitit të kaluar janë bërë dhe shumë investime kapitale të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve të punës.

Shërbimet në Drejtorinë e Administratës janë dhënë në mënyre efektive dhe efikase dhe tërë kjo falë angazhimit të stafit të cilët përveç angazhimeve ditore dhe punës me palë, kanë qenë të angazhuar edhe në punë të tjera shtesë sipas kërkesës së eprorëve të tyre.

## Zyra e Gjendjes Civile

Shërbimi i Gjendjes Civile gjatë periudhës janar-dhjetor i ka pranuar mbi 82000 kërkesa të qytetarëve dhe institucioneve të ndryshme dhe për të gjitha këto kërkesa zyra e gjendjes civile ka ofruar përgjigje dhe shërbime në mënyrë efektive dhe efikase duke vendosur për secilën kërkesë veç e veç, trendi i ngritjes së efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe më efektive është në ngritje të vazhdueshme në këtë shërbim duke ju falënderuar angazhimit, profesionalizmit dhe punës që bëjnë zyrtarët e gjendjes civile dhe procesit të digjitalizimit të regjistrave dhe dokumenteve të gjendjes civile si dhe harmonizimit të procedurave në ofrimin e shërbimeve dhe të lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile.

Përmes Regjistrit Qëndror Elektronik të Gjendjes Civile është bërë ndërlidhja dhe harmonizimi i të dhënave personale të gjendjes civile për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe shtetasëve të huaj me Leje Qëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës në platformën (elektronike) online E-Kosova, prandaj që nga muaji qershor i vitit 2022 është mundësuar pajisja (nxjerrja) e certifikatave të gjendjes civile nga kjo platformë, pa pasur nevojë që të paraqiten në zyrat e gjendjes civile. Zyra e gjendjes civile i ka marrë të gjitha masat që të zbatojmë vendimin e MAPL-së për shpalljen e muajit prill si muaj për regjistrimin falas të të gjitha fakteve të lindjes për komunitetin RAE, mirëpo në zyrën e gjendjes civile në komunën e Vushtrisë nuk është paraqitur asnjë rast i këtij komuniteti për regjistrim me vonesë dhe falas.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe janë nxjerrë këto vendime dhe shkresa të tjera:

1.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të lindjes	12
2.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të vdekjes	34
2.	Vendime për ndërrimin e emrit personal	54
3.	Vendime për korrigjime të të dhënave personale në RQ	122
4.	Vendime për korrigjimin e të dhënave në regjistra fizik	62
5.	Vendime për anulimin e faktit të lindjes	14
6.	Dëshmi të vdekjes	216
7.	Lajmërimi dhe ç'lajmërimi të adresës së vendbanimit	452
8.	Vendime për korrigjimin e Akteve të lindjes,	3
9.	Vendime për korrigjimin e Akteve të vdekjes	16

10.	Vendime për korrigjimin e Akteve të martesës	10
11.	Aplikime për natyralizim (fitim të shtetësisë)	2
12.	Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim	72
13.	Aplikime për rikthimin e shtetësisë së Kosovës	12
14.	Aplikime për fitimin e shtetësisë me martesë	11
15.	Aplikime për natyralizim (fitim të shtetësisë) si pjesëtar i diasporës	44
15.	Regjistrime në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile për herë të parë dhe gjenerimin e numrit personal	162
<b>Gjithsej regjistrime të bëra</b>		<b>1298</b>

**Numri i dokumenteve të lëshuara:**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Lëshuara</b>
1.	Ekstrakt i lindjes	31015
2.	Certifikata të lindjes	15707
3.	Certifikata të martesës	7960
4.	Certifikata të vdekjes	3095
5.	Certifikata të Statusit martesor	830
6.	Certifikata të shtetësisë	262
7.	Certifikata familjare	7932
8.	Certifikata të vendbanimit	4189
9.	Vërtetim nga arkivi	598
<b>Gjithsej</b>		<b>71588</b>

**Regjistrime në Regjistrat e Gjendjes civile**

1.	Regjistrime të lindjes	164
2.	Martesa	696
3.	Regjistrime të vdekjes	368
4.	Regjistrime të Shtetësisë	14
5.	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	284
6.	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	64
7.	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	53
9.	Shkurorëzime	101
<b>Gjithsejtë regjistrime të bëra</b>		<b>1744</b>

Në këtë periudhë janë verifikuar **386** qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa që nga fillimi i sistemit të ri me **19.02.2013** janë të verifikuar apo të regjistruar në sistemin e gjendjes civile **101809** qytetarë të komunës së Vushtrrisë.

<b>Përshkrimi i punëve, detyrave dhe intervenime të bëra</b>	
Formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshëm apo zgjidhja e probleme softuerike.	177
Mbështetje për personel në shfrytëzimin e resurseve të teknologjisë informative.	177
Zgjidhja e problemeve dhe defekteve të ndryshme.	166
Postime në ueb-faqe dhe mirëmbajtja e ueb-faqes zyrtare	21
Lekturimi i dokumenteve të ndryshme për të gjitha organet e komunës si dhe konsultime për lekturim.	83
Shërbime përkthimi, përkthimi i dokumenteve apo përkthim simulantë sipas nevojës të organeve komunale	164
Pranimi i mallrave dhe administrimi i depos, transaksione të kryera në sistemin Pasurisë.	191
Riparime dhe punë të ndryshme për mirëmbajtje të objektit komunal.	403

Që nga muaji gusht 2023 janë rekrutuar: Zyrtari për teknologji informative dhe Zyrtarja për depo. Janë identifikuar pasuri të paregjistruara që nuk kanë kaluar përmes depos dhe janë në vlerë prej **62,097.74 €** e cila tani më është e regjistruar nga zyrtarja e depos, ku përfshihen pajisje të TI, inventarë dhe pasuri tjetër, Kontratën e AQP-së “Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera”.

#### Qendra e Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë

Qendra e shërbimeve me qytetarë në Komunë, gjatë kësaj periudhe ka qenë në shërbim të qytetarëve të Vushtrisë, duke iu dhënë informacionet e duhura mbi kërkesat e tyre, duke iu ndihmuar në përpilimin e kërkesave dhe duke ju percjellur përgjigjet në kërkesa nga të gjitha drejtoritë.

Në kuadër të organeve të administratës janë paraqitur gjithsej 62 386 kërkesa, prej të cilave janë:

<b>Nr.</b>	<b>Pershkrimi</b>	<b>Nr. Kerkesave</b>
1	Drejtoria për Administratë	41 604
2	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	8800
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	2954
4	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural	680
5	Drejtoria për Shërbime Publike	891
6	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	1696
7	Drejtoria për Arsim	754
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	801
9	Drejtoria për Inspeksion	517
10	Personeli	1687
11	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	737
12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	252
13	Zyra Ligjore	747

14	Kryetari i Komunës	177
15	Drejtoria e Prokurimit	18
16	Kuvendi i Komunës	50
17	Zyra Lokale e Komuniteteve	9
18	Njësia e Auditimit të Brendshëm	5
		62 386

## Shërbime Publike

Drejtoria për Shërbime Publike bën rregullimin e qytetit dhe mbrojtjen e ambientit, mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të asfaltuara dhe të rendit të katërt. Rregullimin e qarkullimit të komunikacionit, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, parkingjet, transportin lokal. Përcjell largimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike, mbikëqyrë punën e lëmisë së furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të zeza, menaxhon me procedurat e bartjes dhe deponimit të hedhurinave, pastrimin dhe larjen e rrugëve, shesheve dhe sipërfaqeve publike, mirëmbajtjen e shtratit të lumenjve, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e varrezave, parqeve dhe gjelbërimit të qytetit. Mbikëqyrë dhe menaxhon punën e autoparkut të Kuvendit Komunal etj.

### Furnizimi me ujë

Gjatë këtij viti kemi qenë të orientuar në përmbylljen e projektit për kyçjen e ekonomive familjare në rrjetin e ujësjellësit në të gjitha fshatrat e komunës, projekt ky i kontraktuar dhe në përfundim e sipër. Në këtë projekt kanë vazhduar të kyçen ekonomitë familjare të mbetura deri më tani në 5 fshatra dhe është bërë pranimit teknik i punëve të kryera në fshatrat: Akrashticë, Pantinë, Bukosh, Vërnice, Novolan, Liqej, Taraxhë, Druar, Reznik, Mihaliq, Stanoc i Poshtëm, Stanoc i Epërm, Ropicë, Vilanc, Samadrexhë, Sfaraqak, Smrekonicë. Gjithashtu kemi qenë të orientuar në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të kësaj fabrike si dhe krijimin e TASK-FORCES për eliminimin e keqpërdorimit të ujit të pijes, në mënyrë që të kemi furnizim më të rregullt me ujë.

### Largimi i ujërave të zeza

Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit po ashtu janë bërë investime të shumta sidomos në shtrirjen e rrjetit primar, kolektorëve kryesor në një numër të konsiderueshëm të fshatrave, duke nënshkruar kontratën për projekte dyvjeçare për vitet 2023-2024. Gjatë vitit 2023 janë nënshkruar tre kontrata dyvjeçare dhe janë realizuar mjetet e planifikuara në tërësi duke përfshirë fshatrat: Akrashticë – Balinc 1800 m, Shtitaricë 900 m, Stanoc i Poshtëm 1780 m, Reznik 1865 m, Mihaliq 826 m, Bruznik 500 m dhe në qytet rruga “Nimon Ferizi” 620 m. Fshatrat Duboc 1817 m, Galicë 171 m, Liqej 1585 m, Pantinë - Ashlan 1126 m, Bukosh 502 m, Smrekonicë 439 m, Kollë 605 m, Gllavotin 527 m, Gojbulë 679 m, Pasomë 2203 m, Pantinë lagjja “Shaqiri” 918 m, dhe Pestovë 926 m. Ndërsa, për shkak të nënshkrimit me vonesë janë realizuar punë vetëm në fshatrat Dumnicë e Poshtme 1500 m dhe një pjesë në Nadakoc – Studime.

### Largimi i ujërave atmosferike

Në kuadër të planit të punës së Drejtorisë me planin financiar, është paraparë që të intervenohet në pastrimin e pusetave të kanalizimit atmosferik. Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të përroskave dhe rrjedhave të ujit në qytet, përmes kontratës me “Ndërmarrjen UNITETI”.

### Menaxhimi i Mbeturinave

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë, ka bërë rishikimin e planit pesëvjeçar për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë 2022-2026.

Si rezultat i këtyre angazhimeve, Komuna e Vushtrrisë është duke bërë ofrimin e shërbimit për të gjitha vendbanimet e komunës. Gjithashtu është duke u bërë grumbullimi i ndarë i mbeturinave të rreth 1500 ekonomive familjare, të cilat janë duke u paketuar në qendrën për paketim në Bukosh. Në garat për “Mjedis të Pastër”, Komuna e Vushtrrisë i kishte plotësuar kriteret e qasjes ndaj fondeve të Qeverisë Gjermane dhe Bashkimit Evropian dhe ka përfutur mjete të konsiderueshme nga GIZ-ja të cilat janë konvertuar në dy kompaktorë 8 m<sup>3</sup> dhe një kompaktor 16 m<sup>3</sup>, me të cilët jemi furnizuar gjatë vitit 2022. Furnizimi me një autofshesë gjatë vitit 2023, si dhe pritet të furnizohemi edhe me rreth 1000 kontejnerë 120 l dhe 240 l. Po ashtu është bërë eliminimi i qëndrueshëm i deponive ilegale si deponia në fshatin Bajskë dhe aktualisht i kemi vetëm pesë deponi të tilla. Si rezultat i këtij angazhimi ndërmarrjes “UNITETI” i është siguruar një stabilitet financiar dhe kemi arritur që në masë të madhe t’u përmirësojmë gjendjen e ambientit. Tashmë shërbimet bazike të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve konsiderohen të përbushura si rezultat i implementimit të plotë të Planit Operativ. Përveç përmbylljes së proceseve për shërbimet bazike, janë zhvilluar aktivitete për fillimin e procesit të ndarjes së mbeturinave në burim.

Edhe pse jemi ballafaquar me problemet e shkaktuara nga ngritjet enorme, kemi arritur që të bëjmë inkasimin e mjeteve në vlerën 543,027.83 € si dhe kemi bërë filtrimin e listave duke implementuar Vendimin e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, për lirim nga pagesa të rasteve sociale, për periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Ky është viti i tretë prej themelimit të Ndërmarrjes Lokale “Përparimi”, përmes së cilës janë ofruar shërbimet e sigurimit dhe pastrimit të objekteve si dhe është bërë mbjellja e luleve dekorative, mirëmbajtja e hapësirave publike dhe ndriçimit publik. Gjithashtu, përmes Ndërmarrjes komunale “Përparimi” është bërë mirëmbajtja e të gjitha hapësirave publike. Kjo praktikë e mirëmbajtjes së hapësirave publike në qytet është treguar mjaft e suksesshme pasi që janë kursyer mjete të konsiderueshme financiare të buxhetit të komunës si dhe është bërë punë më e madhe në terren. Gjithashtu është bërë e tërë përgatitja për dhënien në menaxhim Ndërmarrjes “Përparimi” procesin e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave.

Gjatë kësaj periudhe është bërë hartimi dhe dorëzimi në AMM. Raporti për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2022 dhe gjithashtu është hartuar dhe dorëzuar në MAPL Raporti i Sistemit për Menaxhim të Performancës në ofrimin e shërbimeve komunale për vitin 2022.

Në kuadër të projektit për ndërtimin e rrugëve me kubza betoni janë investuar 261.000 euro dhe janë realizuar gjithsej 2486 m.

Me qëllim të rritjes së shkallës së sigurisë për këmbësorët është investuar në ndërtimin e trotuareve në tre (3) vendbanime, në vlerë prej 83,500.00 €

### Ndriçimi publik

Ka vazhduar zgjerimi në mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit të rrugëve në qytet dhe në fshatra, sipas Marrëveshjes me Ndërmarrjen “Përparimi”, si dhe rregullimi i ndriçimit në rrugën “Basri Beqiri”.

### Komunikacion

Në kuadër të fushës së trafikut është menaxhuar kontrata për shërbimet e transportit me auto-merimangë. Janë nxjerrë vendime për bllokim të shiritave rrugor dhe vendime për shfrytëzim të parkingjeve nga operatorët e transportit të udhëtarëve me Radio-Taksi, vendime për ndaljen e mjeteve motorike për ngarkim-shkarkim.

Është realizuar kontrata e furnizimit dhe vendosjes së sinjalizimit horizontal dhe vertikal, ku është bërë sinjalizimi horizontal dhe vertikal i shtigjeve për biçikleta në vlerën 15.883,20 €, duke synuar të krijojmë një rrjet funksional dhe të integruar dhe rritjen e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, pra krijimin e kushteve për lëvizje të lirë të biçikletave. Gjithashtu është realizuar kontrata për vendosjen e monitorëve digjital në hyrje të qytetit, në vlerën prej 49,498.72 €.

Në fushën e transportit publik ka vazhduar mbajtja e rendit të udhëtimit nga Operatorët Ekonomik të cilët mbulojnë 54 vendbanime.

### Parkingjet publike

Hapësira për parkingje brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë të cilat janë në shërbim të qytetarëve, janë 29, me gjithsej 1168 vend-parkingje, prej të cilave 22 hapësira posedojnë vende të rezervuara për persona me nevoja të veçanta. Ndërsa lokacioni i rezervuar për parkimin e mjeteve motorike “TAKSI” është 62.



## Urbanizmi dhe Mbrojtja e Mjedisit

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, kryesisht janë mbajtur takime të organizuara nga sektori i planifikimit urban për çështjet e rregullimit urban (të prezantuara në vijim). Pjesëmarrja në konferenca të organizuara nga niveli qendror dhe grupe tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Takimet e rregullta me komunitetet e zonave të ndryshme, propozimet e ndryshme për rregullimin e infrastrukturës dhe është punuar në rritjen e bashkëpunimit në mes të DUMM me drejtoritë e tjera, për qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe efikasitetit për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, në interes të qytetarëve Komunës së Vushtrrisë.

Është zbatuar në përpikëri Plani Zhvillimor Komunal ku zyrtarët përgjegjës gjatë çdo shqyrtimi të kërkesave të pranuar që kanë të bëjnë me ndërtime dhe informime tjera rreth destinimit të parcelave kadastrale të tyre, janë udhëzuar me destinimin e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal. Po ashtu, kërkesat e parashtruara për marrjen e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve për kategorinë e parë (I) dhe të dytë (II), janë trajtuar me përkushtim të lartë dhe në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunal në fuqi.

### Sektori i urbanizmit

Gjatë periudhës janar-dhjetor për vitin 2023 është marr me shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me kushtet e lokacionit, lejeve ndërtimore, lejeve paraprake, leje për rrënimin e objekteve, leje përdorimi të objekteve, informacione për destinimin e sipërfaqeve nga planet përkatëse rregulluese duke kaluar nëpërmes procesit të daljes në terren dhe incizimit të gjendjes faktike në terren, ku përmes sektorit për planifikim urban e ka vazhduar procesin e mëtutjeshëm për finalizim.

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar kërkesat si më poshtë:

- Vendime për Leje Ndërtimore - /28
- Vendim për Leje për punë të KEDS- 2
- Refuzime për Leje Ndërtimore / 5
- Leje Rrënimi / 8
- Kërkesa të ndryshme –714

Lejet ndërtimore:

PROCESI I LEJEVE TË NDËRTIMIT PËR VITIN 2023									
Nr.	Data e aplikimit të lejes	Data e ndërtimit të lejes	Frymëzues / Frymëzues (Përfundim)	KATEGORIA E NDËRTIMIT	Kompani / Investitori	Passivi	Luaja	Çelësi (objekti)	Destinimi i objektit
1	09.03.2023	20.03.2023	Ened Xhaferi	I	Ened Xhaferi	P-70202024-09247-3	Rr. "Mustafa Xhaferi"	P-0	Objekt Ekonomik - depo për rritjen e Entitetit
2	15.03.2023	12.04.2023	Fahmi Haxhiu	II	Fahmi Haxhiu	P-70202016-06492-0	Rr. "Gasp Baderiu" dhe sheshi "Adem Jashari"	B-5-P-2	Objekt Afarist Hoteles
3	27.02.2023	11.05.2023	Get Hën sh.p.k.	II	Jenne Bajraktari	P-70202016-06556-0	Rr. "Morris e Luvie"	B-P-3-PH	Objekt Hulumtues Afarist
4	18.02.2023	24.02.2023	Luljeta Çakaj	I	Luljeta Çakaj	P-70202021-09425-0	Rr. "Amerika"	P-0	Depo e punëve dhe punëve
5	05.02.2023	25.05.2023	Blerim Sejdiu pronar Blerim Sejdiu B.L. me emër tregtar N.T.P. "Jehona-S"	II	Blerim Sejdiu	P-70202016-06052-0	Rr. "Bashkë Përsëri"	B-P-3	Objekt Afarist Banimor
6	30.03.2023	08.06.2023	NB Construction sh.p.k.	II	Kryeta Fleta, Elmas Uka	P-70202016-06605-0	Rr. "Hoshi Zeka"	2B-P-7-Ph	Objekt Afarist Banimor, blloku A dhe B
7	07.04.2023	09.06.2023	Arioni Company sh.p.k.	II	Naser Imeri	P-70202016-06512-1	Rr. "Rrumbullaku Hyzeta Hyseni"	Bloku A B-P-3-Ph; Blloqe B, C, D dhe E 2B-P-5-Ph	Kompleksi Banimor Afarist; Blloku A, B, C, D, E
8	24.04.2023	05.08.2023	Finni Project sh.p.k.	II	Ardën Jusufi	P-70202016-06647-0	Rr. "Jeton Tersteni"	B-P-7	Objekt Afarist Banimor, ndërtesa A, B, C dhe D
9	17.05.2023	24.07.2023	Arben Hajdari	I	Arben Hajdari	P-70202016-01495-13	Rr. "Nevzat Zambari"	P-1	Shërbim Banimor
10	02.06.2023	23.06.2023	Bedri Elezi	I	Bedri Elezi	P-70202016-02174-1	Rr. "Eures Muzi"	B-P-2	Objekt Afarist Banimor
11	13.06.2023	18.07.2023	Nurije Halili	I	Nurije Halili	P-70202009-09493-0	Rr. "Sejdi e Ramadan Manori"	P-NK	Kompleksi Banimor - 4 bujtina
12	21.06.2023	09.08.2023	Naser Imeri	II	Naser Imeri	P-70202016-03913-2	rr. "Avni Klinaku"	P-1	Objekt banimor
13	19.06.2023	04.07.2023	Haxan Haxan	I	Haxan Haxan	P-70202061-09250-0	Rr. "Kushte Dehmeti"	P-0	Dhomë Mjalti
14	14.07.2023	24.07.2023	Bezirik Gerguri	I	Bezirik Gerguri	P-70202020-06674-0	Rr. "Zeqir Raxhica"	P-1	Shërbim Banimor
15	10.07.2023	03.08.2023	Muratfa Mulliqi	I	Muratfa Mulliqi	P-70202016-03096-12	Rr. "Jeton Tersteni"	P-1	Shërbim Banimor
16	18.07.2023	16.08.2023	Holime Ferçuku	I	Holime Ferçuku	P-70202068-01317-3	Rr. "Shkëlbi I UÇK"	S-P-1	Objekt banimor - Bujtinë
17	10.07.2023	22.08.2023	Murat Bajraktari	II	Murat Bajraktari	P-70202046-02149-1	Rr. "Toni Bler"	P-0	Restaurant Piceri - fast food
18	01.08.2023	14.08.2023	Batriati Building sh.p.k.	II	Imfi dhe Nisuf Zhegova	P-70202016-06637-0	rr. "Imzaji Qemalli"	2B-P-3-Ph	Objekt Afarist Banimor
19	18.08.2023	01.09.2023	Xhavit Hajdari	II	Elhava Hajdari	P-70202016-01026-2	Rr. "Faruk Baqiri"	B-P-2	Objekt banimor Garazh
20	03.02.2023	12.10.2023	Lini Project sh.p.k.	II	Ferit Haxhembeu	P-70202016-06490-0	Rr. "Jeton Tersteni"	B-P-7	Objekt Banimor afarist blloku 1 dhe 2
21	07.06.2023	03.11.2023	Dijteri sh.p.k.	II	Vilazrim Zariqi	P-70202016-06642-0	Rr. "Kodin Zeka"	2B-P-3-Ph	Objekt Afarist Banimor
22	12.09.2023	14.11.2023	Zariqi Group sh.p.k.	II	Valon Zariqi	P-70202016-06607-0	Rr. "Tosaj Fudini"	2B-P-3-Ph dhe B-P-3	Objekt Afarist Banimor, blloku A dhe B
23	05.09.2023	18.11.2023	Katriati Dhalli	I	Katriati Dhalli	P-70202016-03006-25	Rr. "Hoshi Selman Manori"	P-2	Shërbim Banimor
24	18.09.2023	17.10.2023	Dijteri Estate sh.p.k.	II	Muharrem Zariqi	P-70202016-06651-0	Rr. "Eures Muzi"	2B-P-3-Ph	Objekt Afarist Banimor
25	29.09.2023	14.11.2023	NTP Rika	II	Isa Feriz	P-70202016-06640-0	Rr. "IS Prilli"	2B-P-7	Objekt Afarist Banimor
26	22.09.2023	08.12.2023	Premium Building sh.p.k.	II	Syleme Suleju	P-70202016-06651-0	Rr. "Gasp kastrion Shkullaba"	2B-P-3-Ph; B-P-4-P-3-Ph; 2B-P-3-Ph	Objekt Afarist Banimor, 3 Blloqe
27	09.11.2023	08.12.2023	HB Petrol sh.p.k.	II		P-70202016-1395-0	Rruga "Ana Liri"	P-0	Objekt restorant pompë derivatese
28	03.10.2023	22.12.2023		II	Bashkim Fazbu	P-70202016-02226-4	Rr. "Tabu Sazimi"	B-P-1	Objekt Banimor Afarist

Janë aprovuar kërkesat e kompanive si KEDS dhe Operatorëve të internetit për shtrirjen e rrjetit nëntokësor, vendosjen e ormanëve MDF etj.

**Spektori për planifikim urban**

Gjatë periudhës njëvjeçare është bërë sistematizimi i lëndëve të ndryshme, koordinimi profesional dhe ligjor brenda drejtorisë, zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, kontrollimi i rregullt i projekteve kapitale, zgjidhje dhe përgjigje ndaj kërkesave të qytetarëve, përgatitja e projekteve konkurruese ideore, vizitat e punimeve në terren, mbikëqyrja e projekteve, monitorimi dhe aprovimi për Kushte dhe leje Ndërtimore, pranime teknike të disa projekteve, mbajtja e disa seminareve të organizuara nga organizata të ndryshme, takimet me grupet punuese për Hartimin e Raportit të Vlerësimit Vullnetar Lokal.

**Kushte ndërtimore:**

- Vendime për caktimin e Kushteve Ndërtimore - 45
- Vendime për Refuzim - 6
- Në Procedurë për kushte ndërtimore / 6
- Të hedhura poshtë / 5
- Informim nga Plani / 15

## Sektori për mbrojtje të mjedisit

Në respektim të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimit Administrativ për dhënien e Lejeve Mjedisore Komunale, kemi lëshuar me kërkesën e palëve, kemi shqyrtuar 5 kërkesa për Leje Mjedisore Komunale dhe 20 Vendime për Leje Mjedisore Komunale.

Procesi i legalizimit ka filluar më 15 korrik 2019, pas miratimit të pesë (5) udhëzimeve administrative të legalizimit të ndërtimeve pa leje. Me rifillimin e këtij procesi, ky sektor ka pranuar numër të madh të palëve të interesuara për vazhdimin e shqyrtimit të lëndëve, si dhe aplikimeve të reja të ndërtimeve pa leje.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar gjithsejtë **487** kërkesa, si në vijim:

- Vendime për Legalizimin e objekteve / 160
- Vendim për listë të pritjes / 50
- 76 të regjistruara në RDPP.

Është bërë gjithashtu unifikimi i Adresave në sistemin Aris, mirëmbajtja e Sistemit të Adresave. Janë digjitalizua në Sistemin e Arisit të gjitha objektet e legalizura dhe të përfunduara. Në bazë të memorandumit të bashkëpunimit me Agjensionin Kadastral është duke u bërë plotësimi i sistemit të adresave duke u bazuar në gjendjen në terren, projekt i Bankës Botërore ku Agjensioni Kadastral mbështet Komunën e Vushtrisë me një staf mbështetës.

Gjatë vitit 2023 në Dumm kanë shërbyer dy (2) përfaqësues të Agjencionit Kadastral të Kosovës të cilët kanë zhvilluar vizita në terren dhe sipas gjendjes së terrenit i kanë harmonizuar të dhënat në sistem.

Në 10 raste është dhënë prona komunale në shfrytëzim, më pak se një (1) vit.

## PROJEKTET NË DREJTORINË E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

1. Kontraktimi i kompanisë me Konkurs Projektimi për Hartimin e Projektit
2. Rikonstruimi i Bulevardit Adem Jashari dhe Lidhja me Parkun e Qytetit
3. Kontraktimi i kompanisë për Hartimin e Projektit të Rr. “2 Maji”, “Bekim Berisha”, “Lumni Surdulli” dhe “Avni Saraçi”.
4. Kontraktimi i tre (3) kompanive për Hartimin e Projekteve
5. Llot 1 – Hartimi i projekteve të Infrastrukturës
6. Llot 2 – Hartimi i projekteve të Ndërtesave
7. Llot 3 – Hartimi i projekteve të Shesheve.

## Kulturë Rini dhe Sport

Bazuar në Planin e Punës së DKRS-së për vitin 2023, në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" punët kanë rrjedhë sipas planit, duke realizuar në tërësi planin e punës, por duke e plotësuar atë edhe me aktivitete të reja shtesë të cilat ndonëse nuk janë paraparë në planin e punës. Punët kanë dalë si rezultat i ideve të reja të stafit të drejtorisë sonë, apo edhe qytetarëve që janë marr me aktivitete kulturore, por edhe institucionet tjera me të cilat kemi bashkëpunuar gjatë këtij viti.

Ndër aktivitetet kulturore të organizuara janë: akademitë përkujtimore, organizimet e koncerteve, shfaqjet teatrale, ekspozita, promovime të librave të autorëve të ndryshëm, organizimi i ditëve të diasporës, tryeza, monografi, kurse për vizatim në pikturë, takimet e poeteshave shqiptare dhe aktivitete tjera të shumta.

### Biblioteka “Naim Frashëri”

Biblioteka amë “Naim Frashëri” posedon **38477** libra (tituj). Në sektorin e fëmijëve janë **12297** libra, ndërsa në sektorin e të rriturve janë **26180** libra.

Në sektorin për fëmijë janë dhënë për lexim **4132** libra;

Në sektorin për të rritur janë dhënë për lexim **2820** libra;

Në dy sektorët janë dhënë për lexim **6952** libra;

Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar **1033** lexues;

Janë përpunuar **560** libra;

Lexues të ri të regjistruar **136** persona;

Janë dhuruar nga autorë të ndryshëm **234** libra.

Libra të blera: **1318** libra (**296** tituj), me përkrahje financiare nga MKRS-ja

Në sektorin për fëmijë librat më të kërkuara për lexim ishin: **“Lulet e Verës”**, i autorit Naim Frashëri dhe **“Princesha Argjiro”** i autorit Ismail Kadare.

Në sektorin për të rritur, librat më të kërkuara për lexim ishin: **“Historia e Skënderbeut”** e Marin Barletit dhe **“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”** i Ismail Kadaresë.

Gjatë kësaj periudhe, bibliotekën e kanë vizituar qindra nxënës të shkollave të fshatrave dhe të qytetit të Vushtrrisë.

### Muzeu Historik Etnografik

Objekti i Muzeut të Vushtrrisë është një nga objektet e përfshira në projektin “EU for All” (UE për të gjithë), mbështetur nga Bashkimi Europian në Kosovë. Projekti ka filluar të implementohet më 8 maj 2023, falë të të cilit do t’ju mundësohet qasje e lehtë të gjithëve, në veçanti personave me nevoja të veçanta.

Është kompletuar dokumentacioni i projektit të planifikuar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport:

“Rikonstruimi i Muzeut, Shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit” dhe është dorëzuar në Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Mitrovicë, për të vazhduar pastaj me procedurat komunale deri te implemmentimi. Stafi i muzeut ka punuar intenzivisht në risistemimin dhe pastrimin e koleksioneve të muzeut. Në kuadër të punëve hulumtuese në terren janë identifikuar dhjetra e qindra eksponate të ndryshme nga fusha e etnologjisë, të punuara me motive gjeometrike e florale. Eksponatat janë identifikuar në familjet: Kuqani, Bunjaku, Gjaka, Mehmeti, Jetullahu, Ispahiu, Qerkezi, Mikushnica, Tiriqi, Merovci, Bytyqi, etj. Gjithashtu është vazhduar me punën hulumtuese në deponitë e metalit në Vushtrri, ku shpeshherë dërgohen eksponate shumë të rëndësishme nga metali në këmbim të të hollave minimale.

Muzeu u pasurua me mbi 40 (dyzet) ekspoante nga materiale të ndryshme të dhuruara. U inventariuazuan gjithsejtë 58 eksponate nga kultura materiale, 47 nga sektori i etnologjisë, 8 nga sektori i teknologjisë, 3 nga sektori i arkeologjisë, eksponate etnologjike etj.

Muzeu organizoi aktivitete të cilat kishin për qëllim promovimin, edukimin dhe vetëdijësimin e gjeneratave të reja, përmes komunikimit muzeor.

### Sektori i Rinisë – Aktivitetet:

Takime pune dhe informues me përfaqësuesit e OJQ-ve rinore, me OSCE, trajnime për Rrobaqepësi dhe Modë për gra dhe vajza, të grupmohave të ndryshme. Takime pune me përfaqësuesit e The Power of Mind dhe KVRL-së, me përfaqësuesin e OJQ “Levizja Koha”

Organizata Rinore “Aces” në bashkpunim me sektorin e rinisë dhe Departamentin e Rinisë – MKRS, ka planifikuar që të organizojnë trajnime për të rinjtë në komunën e vushtrrisë, është hartuar projekt-propozimi dhe do të dërgohet për financim.

Është në realizim e sipër projekti “Komuna për të Rinjtë”. Ky projekt realizohet nga Komuna e Vushtrrisë në bashkpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Bankës Botërore si dhe organizatës facilituese CDF. Ky projekt do të ketë një impakt të mirë për zhvillimin e aktiviteteve rinore, pasi që shuma totale për mbështetjen e të rinjëve në total arrin vlerën 250’000.00 dollar amerikan.

Trajnime për shkathtësi të buta, kurse për kompjuter, kurse për gjuhë të huaja, kurse për matematikë, të mbajtura nga Qendra Rinore “Hareja” e cila është licencuar në fund të vitit të kaluar.

Punë dhe takime të ndryshme me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve rinore.

Janë njoftuar të gjitha OJQ-të rinore, KVRL-ja, Qendra Rinore si dhe grupet joformale të të rinjve për thirrjen publike për mbështetje financiare nga Komuna, po ashtu janë njoftuar.

### Sektori i Sportit

Aktiviteti	Gjithsejt	Me pagesë	Pa pagesë
Stërvitje	2724		
Ndeshje	315		
Rekreacion	164		

Nr. rendor	Emri i shfrytëzuesit të Palestrës	Stërvitje		Ndeshje		Rekreacion	
		Me pagesë	Pa pagesë	Me pagesë	Pa pagesë	Me pagesë	Pa pagesë
1	Kl. i Boksit KALAJA		135				
2	Kl. i Boksit VUSHTRRIA		128				
3	Kl. i Basketbollit VU BASKET		394		72		
4	Kl. i Basketbollit VUSHTRRIA – F		153		12		
5	Kl. i Basketbollit VUSHTRRIA – M		153		15		
6	Kl. i Gjmnastikës VUSHTRRIA		216				
7	Kl. i Hendbollit VUSHTRRIA-F		144		36		
8	Kl. i Hendbollit VUSHTRRIA – M		144		36		
9	Kl. i Hendbollit SAMADREXHA – F						
10	Kl. i Hendbollit SAMADREXHA – M						
11	Kl. i Volejbollit VUSHTRRIA – F		180		36		
13	Kl. i Volejbollit AS VUSHTRRIA – M		144		36		
14	Kl. i Volejbollit AS VUSHTRRIA – F		144		36		
15	Kl. i Pingpongut H.PRISHTINA		216				
16	Kl. i Pingpongut VUSHTRRIA		216				
17	Kl. i Xhudos VICIANUM		108				
19	Kl. i Mundjes KOSOVA		64				
22	Gzim Sokoli						
25	Shoqata e të Shurdhërve		36				
27	Agron Neziri						
28	Besart Muja						
29	Kl. i Basketbollit GJIMNAZISTI		36				
30	KXH Studenti		72				
31							
	TOTALI		2579		279		144

### Arkivi Historik

Arkivi Historik është institucion i cili pranon, evidenton, rregullon dhe publikon lëndën arkivore. Mundëson shfrytëzimin e saj për hulumtime shkencore dhe punë profesionale si dhe për nevoja tjera të cilat janë në interes për organet, organizatat, institucionet, personat civil-juridik.

Është bërë pranimi i lëndës arkivore nga institucionet lokale, Dokumente nga Drejtoria e Administratës, Bujqësisë, Urbanizmit, Prokurimit. Dokumentacioni është vendosur në depon e Arkivit në ormane metalike, i pasistemuar me përjashtim të Drejtorisë së administratës.

Gjatë kësaj periudhe është bërë sistemimi klasik i dokumentacionit, brenda kushteve dhe mundësive të cilat i posedon Arkivi. Ekziston edhe një pjesë e dokumentacionit në gjendje jo të mire, në mungesë të rafteve arkivore.

Në bashkëpunim me DKRS kemi pasur edhe një prezantim të dokumenteve arkivore për grupin punues nga qyteti VAXJO-Suedisë. Ky prezantim ka qenë në kuadër të projektit për digitalizimin e dokumenteve arkivore. Në kuadër të këtij projekti përfshihet edhe vizita në qytetin e VAXJO, ku pjesë e grupit punues është edhe udhëheqësi i Arkivit.

Subvencionet: Janë ndarë gjithsejtë 90.000.00 euro, prej të cilave, 70.000.00 euro mbështetje financiare përmes thirrjes publike për klubet sportive, aktivitetet rinore dhe kulturore, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve për shkrimtarët e Vushtrrisë, për piktorët si dhe për organizimin e festivaleve, në kuadër të DKRS për Ansamblin e Qytetit “AKV Hasan Prishtina” dhe bendeve të ndryshme muzikore.

### Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

Nr. Rend.	LËNDËT E ARRITURA Janar – dhjetor 2023	Gjithsejtë
1.	KËRKESAT E ARRITURA	<b>8800</b>
2	AKTVENDIME PËR BARTJE TË PRONËS	<b>1360</b>
3.	AKTV. PËR PËRMIRËSIM TË EMRAVE NË RDPP	<b>260</b>
4.	AKTVENDIME PËR REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	<b>108</b>
5.	AKTVENDIME PER ÇREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	<b>92</b>
6.	VËRTETIME-CERTIFIKATA TË NDRYSHME	<b>338</b>
7.	NDARJE DHE BASHKIM TË PARCELAVE	<b>657</b>
8.	INQIZIMI I GJENDJES FAKTIKE	<b>37</b>
9.	REGJISTRIM DHE FSHIRJE E BARRËS TATIMORE	<b>12</b>
10.	KOPJE TE PLANIT	903
11.	LISTA POSEDUESE	2994
12.	KËRKESA ZYRTARE TË NDRYSHME	<b>142</b>
13.	REGJISTRIM DHE FSHIRJE E MASËS SË SIGURISË	<b>16</b>
14.	LËNDËT NË PROCEDURË	<b>34</b>
15	Kërkesa tjera (identifikim, dalje në teren, ankesa etj).	<b>194</b>

Për nevoja të përfituesve të ndihmës sociale janë lëshuar 870 certifikata që nuk posedojnë pasuri të paluajtshme si dhe 326 certifikata pronësore.

Gjatë periudhës raportuese janë lëshuar 2994 certifikata pronësore dhe 903 kopje të planit.

Gjatë periudhës raportuese nuk kemi zhvilluar asnjë procedurë të shpronësimit të pronës së paluajtshme për interes publik, ndërsa kemi zhvilluar tre procedura administrative lidhur me lirimin e pronës komunale.

Pranë kësaj drejtorie, gjatë kësaj periudhe kemi aprovuar kërkesa zyrtare të ndryshme të parashtruara nga ana e organeve komunale, gjyqësore, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare etj.

### Menaxhimi i pronës komunale

Në menaxhim kemi 25 Kontrata për dhënie në shfrytëzim të tokave bujqësore, në pronësi të komunës dhe 28 Kontrata për dhënie me qera të lokaleve afariste, në pronësi të komunës.

Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, bazuar në Ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së Komunës, ka përpiluar dhe publikuar në Ueb-faqen e Komunës Listën e përgjithshme të pronave komunale. Gjithashtu, kemi hartuar Listën e veçantë të pronave të komunës të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim në vitin 2024. Kjo “Listë” është miratuar nga Kuvendi i Komunës në seancën e muajit dhjetor, ashtu si e parasheh ligji në fuqi.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, nuk janë lidhur kontrata të reja për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale. Vlera e inkasuar nga pronat komunale të dhëna në shfrytëzim për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, arrinë shumën prej 18,987.21€.

Janë kryer punë të ndryshme për nevoja të Komunës, gjegjësisht të drejtorive tjera gjatë realizimit të projekteve të ndryshme (asfaltim të rrugëve, rregullim të trotuareve, lirim të hapësirave publike etj.).

### Mbrojtje dhe shpëtim

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë vitit raportues përveç punëve të rregullta ka qenë e angazhuar në rastet e intervenimeve me kompaninë e kontraktuar në situata emergjente në terren, për eliminimin e pikave kritike nga vërshimet e lumenjve dhe përroskave. Nga reshjet e shiut që ndodhën në muajin janar dhe mars u rrezikuan nga vërshimet sipërfaqe të tokave bujqësore dhe vendbanime si: Stanoci i poshtëm, Lumadh-i, Vushtrria (shtëpitë afër lumit Tërstena), Pestova, Nadakoci, Mihaliqi, Druari, Vërnica, Novolani, Pantina, Sllakovci, Cecelia, Samadrexha, Maxhunaj etj. Mirëpo, me angazhimin e pandërprerë të stafit të Drejtorisë dhe Kompanisë, është arritur që të eliminohen rreziqet për dalje nga shtrati të lumenjve. Në shumicën e këtyre rasteve kemi pasur takime me pjesëtarë të FSK-së, AME-së me Policinë e Kosovës - Stacioni në Vushtrri, Njësinë e zjarrfikësve, KFOR-in, Kryqin e Kuq, QOR 112 të cilët na kanë dalë në ndihmë. Rasti më kritik është shënuar në fshatin Stanoc i Poshtëm, ku familja e Shemsedin Segashit është detyruar të evakohet te të afërmit.

Si pasojë e rrëshqitjes së masivit kodrinoro-malor në Fsh. Sllakovc është mbyllë në tërësi aksi i rrugës Sllakovc-Kurillovë, që mëpastaj është sanuar dhe është bërë hapja e rrugës.

Me qëllim të vlerësimit të dëmeve, Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, ka bërë vlerësimet e dëmeve në tokat bujqësore, dërsa është themeluar edhe një komision tjetër Ad-hoc për vlerësim të dëmeve në ekonominë familjare.

Dëmet në bujqësi nga të reshurat atmosferike në muajin Janar 2023, janë: 21,674.23 euro.

Dëmet në Ekonomi Familjare nga të reshurat atmosferike, zjarri dhe era, në muajtë janar-shkurt dhe mars, janë: 14,617.00 euro.

Gjithsejtë kërkesa për vlerësim të dëmit kanë parashtruar 373 qytetarë, prej tyre janë vlerësuar 319 kërkesa, kurse janë refuzuar 54 kërkesa.

Vlera e dëmeve në Ekonomi Familjare nga shiu, zjarri dhe era në muajtë mars, prill, maj, qershor dhe korrik, është: 134,014.00 euro.

Vlera e dëmeve në Bujqësi të shkaktuara nga shiu, për muajtë prill, maj dhe qershor 2023, është: 930,249.15 euro.

Vlera e dëmeve në biznese nga shiu në muajin qershor është 39,601.84 euro.

Vlera e dëmeve në ekonomi familjare nga shiu, në muajin qershor është 254,174.00 euro.

Vlera e dëmeve në bujqësi nga shiu, për muajin qershor është 633,092.15 euro.

Gjatë muajve shtator, tetor dhe nëntor 2023, në komunën e Vushtrrisë janë shkatuar dëme në ekonomi familjare dhe bujqësi, ku shkaktar ishin zjarret fushore, zjarri në shtëpi, qentë endacak dhe era e fortë, në vlerë: 23,457.00 euro.

**Dëmet në total: 2,125,415.42 euro.**

### Njësia për zjarrfikje dhe shpëtim

Sa i përket gjendjes së përgjithshme të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri në rajonin e komunës së Vushtrrisë me rrethinë, në krahasim me vitin e kaluar (2022), mund të thuhet se gjatë këtij gjashtëmujori të vitit 2023, ka pasur më shumë raste e veçanërisht atyre të zjarreve (fushore, malore) të shkaktuara nga temperaturat dhe pakujdesia e faktorit njeri.

Gjendja e përgjithshme e mbrojtjes (parandalimit) nga zjarri në qytet, duke marr parasysh (objektet vitale) edhe pompat – stacionet për furnizim të qytetarëve me derivate dhe gas pothuajse është e volitshme, pasi që këta i (kryejnë) eliminojnë masat kryesore të sigurisë nga zjarri dhe e marrin shumë serioz situatën dhe 70% prej tyre i kanë të evituara mangësitë në objekte.

Gjendja në objekte publike është pothuajse e mirë, ndërsa në objekte banimi (ndërtesa të vjetra të ndërtuara para 40-50 vitesh) nuk kanë hidrante, ujë të pijshëm, nuk ka rregull dhe askush nuk interesohet për mirëmbajtjen e tyre.

Është punuar mjaft në ngritjen e vetëdijes qytetare duke i njoftuar qytetarët me rrezikun i cili mund t'iu kanoset nga pakujdesia apo mosdija e tyre.

Në aspektin e parandalimit të zjarrit është arritur sukses, pasi që numri i zjarreve në objekte ndërtimore tani është në rënje të dukshme.

	LIOJI I INTERVENI MIT	Jan.	Shk. u.	Mars	Pri ll	Maj	Qersh	Kor.	Gus. h.	Sht. a.	Te t.	Nënt.	Dhjet.	GITHËSE JTË
1	ZJARRË	8	11	12	9	4	9	41	137	165	135	13	16	560
2	INTERVENI MET ME TEKNIKË	11	2	8	7	11	10	11	7	6	1	9	12	95
3	SHËRBIME	4	14	9	6	11	10	20	20	22	23	12	8	159
4	AKSIDENTE KOMUNIKACIONI	3							3	1	1	1		9
5	VËRSHIME	7				1	64							72
6	ALARME TË RREJSHME	2	2					1	2	1	1		2	11
	<b>Gjithësejtë:</b>	<b>35</b>	<b>29</b>	<b>29</b>	<b>22</b>	<b>27</b>	<b>93</b>	<b>73</b>	<b>169</b>	<b>195</b>	<b>161</b>	<b>35</b>	<b>38</b>	<b>906</b>
<b>Zjarre në</b>		<b>SIPËRFAQE TË HAPURA</b>												
1	Mal		1	1					4	15	13		1	35
2	Sipërfaqja e djegur (hektar)		15	1					3.7	14	14.6		0.3	48.6
3	Bari i thatë		3	1				24	106	128	104	4	5	375
4	Sipërfaqja e djegur (hektar)		5.5	0.3				11.3	75.2	128	137	2	1.9	360.4
5	Sipërfaqe bujqësore								2	3	3			8
6	Sipërfaqja e djegur (hektar)								1.2	1.8	7.8			3
7	Të tjera	3	2	4	4	3	4	9	17	14	8	2	5	75
	<b>Gjithësejtë:</b>													493

Me gjithë problemet e paraqitura konsiderojmë se Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim me përgjegjësinë më të madhe ka ndërmarrë të gjitha masat, procedurat dhe aktivitetet e duhura, duke azhurnuar dhe mundësuar realizimin e Planit të veprimit për menaxhim të situatës në terren dhe se angazhimet e kompanive dhe akterëve tjerë relevant kanë qenë në përputhje me kërkesat e drejtorisë dhe nevojave të qytetarëve për t'u siguruar qëndrim nëpër shtëpitë e tyre dhe lëvizje të lirë.

Konsiderojmë se menaxhimi i situatës në terren është kryer me mjaft sukses.

### Inspekcioni

Drejtoria Për Inspektime në Komunën e Vushtrrisë gjatë kësaj periudhe kohore ka kryer aktivitetet e inspektuese me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira, operatorëve ekonomik në aplikimin e dispozitave ligjore dhe ushtrimin e veprimtarive.

Në kuadër të Drejtorisë për Inspektime veprojnë Inspektorë të fushave të ndryshme, andaj raportin vjetor të punës po e paraqesim në mënyrë të detajuar për secilin sektor, ashtu siç janë paraqitur aktivitetet sipas fushave të bazuara në planin e punës për vitin 2023.



Inspektorati i tregut

	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	NR/SASIA	VLERA NË €
1	PROCESVERBALE	261	
2	PRANIME TEKNIKE TË LOKALEVE	118	7,300.00 €
3	URDHËRESA TË NDRYSHME	48	
4	KËRKESA TË PRANUARA	127	
5	KËRKESA TË MIRATUARA	118	
6	KËRKESA TË REFUZUARA	9	
7	KËRKESA NË PROCEDURË	0	
8	GJOBA TË SHQIPTUARA	14	
9	GJOBË MANDATORE TË REALIZUARA	13	3,750.00 €
10	<b>GJOBË mandatore e realizuar- NDERMJETËSIM – Gjykatë</b>	1	600.00 €
11	<b>GJOBË MANDATORE TË REALIZUARA me UNIREF - MINT</b>		200.00 €
12	GJOBË MANDATORE TË PAREALIZUARA	1	200.00 €
13	MBYLLJE TË PËRKOHSHME TË LOKALEVE AFARISTE	3	
14	MALL I LARGUAR NGA SHITJA DHE ASGJËSIMI I MALLIT – <b>VLERA NË €</b>	50,177.50 €	
15	PAGESË PËR ASGJËSIM TË MALLRAVE		450.00 €
16	Ankesa të konsumatorit të pranuar nga MINT	4	
17	Ankesa nga MINT të realizuara në favor të konsumatorit	2	
18	Ankesa nga MINT të PA BAZUARA nga konsumatori	2	

SUBJEKTE AFARISTE TË PAJISURA ME PËLQIM MBI PLOTËSIMIN E KUSHTEVE MINIMALE TEKNIKE

APLIKUAR	118
TË VENDOSURA	118
NË PROCEDURË	-
Mjete të inkasuara në €	7,300.00 €

Malli i asgjësuar

Sasia e mallit të asgjësuar, vlera në euro	50,177.50 €
Të hyra nga malli i asgjësuar	450,00 €

Një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit zë vend edhe vetë zëri i shoqërisë civile dhe informimi, edukimi dhe ngritja e vetëdijësimit të konsumatorëve përmes mekanizmeve të ndryshëm. Inspektorati i Tregut bazuar në kompetencat për të cilat është i autorizuar, është angazhuar në krijimin e një ambienti sa më të sigurtë në Mbrojtje të Konsumatorit, për produktet të cilat janë në qarkullim, në tregun e brendshëm, të kenë plasmanë sa më të sigurt, për përdorim apo për konsum të gjerë.

### Inspektorati i komunikacionit

Gjatë zbatimit të planprogramit të hartuar nga inspektorët e komunikacionit, për këtë periudhë kohore kemi lëshuar procesverbale, vendime për pranime teknike të autotaksive, vendime për gjoba mandatorë ku dhe janë inkasuar mjete, bazuar në vendimet.

Me qëllim të përmirimit të gjendjes së transportit rrugor në territorin e Komunës së Vushtrrisë janë marrë masa konform dispozitave ligjore si dhe inspektimet janë kryer në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Stacioni në Vushtri.

Qëllimi i inspektimit ka qenë mbikëqyrja dhe inspektimi i të gjithë operatorve që merren me veprimtarinë mbi transportin e udhëtarëve dhe mallrave që qarkullojnë në territorin e Vushtrrisë.

Të hyrat nga Drejtoria për Inspektime,

Pranime teknike të automjeteve	360.00 €
Gjoba mandatore	300.00 €
Totali i të hyrave	660.00 €

Pranimi teknik i automjeteve,

APLIKUAR	72
TË VENDOSURA	72
NË PROCEDURE	-
Mjete të inkasuara në €	360,00 €

Janë lëshuar 106 procesverbale, janë nxjerrë 48 aktvendime/urdhëresa dhe janë shqiptuar 4 gjoba.

### Inspektorati për shërbime publike

Aktivitetet:

Procesverbale	119
Vendime	20
Gjoba	20
Gjoba të realizuara	19
Shuma e mjeteve nga gjobat e realizuara	2425 euro

Pas inspektimit të subjektet e caktuara, kemi bërë edhe riinspektimin dhe kemi përcjellë në vazhdimësi për të parë nëse janë zbatuar urdhërat e dhëna me procesverbal. Deri tani, përveç një rasti i cili është më specifik, rastet e tjera janë të përfunduara. Gjatë këtyre tre muajve sa jam pjesë e Drejtorisë për Inspektime në Komunën e Vushtrrisë, kam shqiptuar një gjobë e cila është paguar brenda afatit të paraparë me ligj.

### Inspektorati i Higjienës Komunale – Shërbimeve Publike

Janë bërë inspektime dhe mbikëqyrje të vazhdueshme bazuar në rregulloren komunale që e rregullon këtë lami. Angazhimi për mbikëqyrjen e pastërtisë së qytetit me rrethinë dhe objektet komunale, ka qenë në përditëshmëri e vazhdueshme. Po ashtu kemi bërë inspektime, mbikëqyrje të rregullta të papastërtisë rreth objekteve banesore dhe përcjellien e hedhjes së hedhurinave në kontejner nga banorët. Janë bërë inspektime përgjatë ditëve të tregut me qëllim të heqjes së mallit nga trotualet dhe hapësirave publike të zëna nga shitësit ambulant, si dhe përcjelljen e mbajtjes së pastërtisë së vitrinave të lokaleve afariste si dhe përgjatë sezonit dimëror në përcjellje të pastrimit të borës para lokaleve afariste.

Të gjitha kërkesat e qytetarëve të cilat janë drejtuar për Inspektoren e Higjienës Komunale – Shërbimeve Publike, janë zgjidhur brenda afateve ligjore.

Kemi 56 shënime zyrtare. Janë dorëzuar raporte javore, sipas kërkesës së Drejtorit të Inspeksionit. Nga inspektimet dhe konstatimet janë hartuar 59 procesverbale, 77 urdhëresa dhe tre (3) gjoba mandatore.

Mjetet e inkasuara nga gjobat janë: 225 euro.

#### Inspektorati i ndërtimit - Aktivitetet e implementuara

Në kuadër të kontrollimit të terrenit, janë përpiluar procesverbalet dhe Aktvendime për ndërtimet me leje-ndërtimi dhe ato pa leje-ndërtimi.

Ndërprerja e ndërtimeve pa leje, ndalimi i punimeve është urdhëruar me afat kohor dhe janë vendosur shirita rrethues të cilët ndalojnë punimet pa leje deri në pajisjen me dokumentacion përkatës të lejes ndërtimore. Shumica e ndërtimeve pa leje janë shtëpi banimi, por ka edhe objekte afariste.

Janë lëshuar procesverbale për ndërtimet pa leje-ndërtimi dhe pa pëlqime urbanistike, kryesisht për ndërtime të banimit individual, por ka pasur edhe raste të ndërtimeve për të cilat kërkohen pëlqimet urbanistike, siç janë: terasat para objekteve, ndryshimet në objektet ekzistuese me leje ndërtimi, ndryshimet në kulmet e objekteve dhe në fasadat e tyre.

Janë lëshuar Vendimet për ndërprerje të punimeve për objektet që kërkohet leja e ndërtimit por të cilat nuk janë pajisur me leje-ndërtim, vendimet për ndërprerjen e punimeve kanë karakter të urdhëresës së prerë, për ndërprerje të punimeve deri në pajisje me leje-ndërtimi.

Gjobat mandatorë janë lëshuar në bazë të udhëzimit administrativ për shqiptimin e gjobave mandatorë, për ndërtimet pa leje dhe pjesëmarrësve në ndërtim si dhe në mbështetje të Ligjit për Kundërvajtje 05/L-087, të cilët kanë punuar në kundërshtim me dispozitat ligjore, në lidhje me ndërtimin e objekteve.

Kërkesat për inspektime kanë të bëjnë kryesisht me inspektimet rutinë të cilat bëhen nga Investitorët e ndërtimeve me leje-ndërtimi për inspektimet e fazave të ndërtimit, prej fillimit të ndërtimeve deri në përfundimi të ndërtimit. Ne si drejtori i jemi përgjigjur këtyre kërkesave duke vizituar vend-ndërtimet dhe plotësuar kartelën e inspeksionit.

#### Zyra ligjore

Numri i lëndëve të pranuar	Ankesa të pranuar	Ankesa të miratuara , Refuuzuar Hedhura posht	Urdhëre sa të hartuara	Urdhëre sa të pranuar	Kërkesa, Njoftime, përgjigje në kërkesë të hartuara	Shkresa të hartuara për kryetarin	Vendime të hartuara	Vendime të pranuar	Pëlqime të pranuar
495	24	16 -4 -4	2	1	30	8	11	27	7

#### Zyra ligjore e komunës

Gjatë periudhës raportuese, janë kryer këto punë dhe detyra:

- Janë përgatit 44 draft-ankesa kundër aktgjykimeve të shkallës së parë;
- Janë përgatit 253 draft-përgjigje në padi;
- Janë dhënë 6 opinione ligjore me shkrim, sipas kërkesave të parashtruara.
- Kam marrë pjesë në komisione të ndryshme të themeluara nga kuvendi dhe kryetari.

Në Zyrën Ligjore është i punësuar për momentin vetëm një zyrtar, është e domosdoshme që të paktën edhe një zyrtar të punësohet në këtë zyrë.

## Zyra për Informim

Zyra për Informim e Komunës së Vushtrrisë gjatë vitit 2023 ka përcjellë të gjitha aktivitetet e kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive, si dhe të zyrave e njësive të Komunës, për të cilat janë publikuar lajme në ueb-faqe dhe në rrjetin social të Komunës së Vushtrrisë, në facebook.

Janë publikuar me kohë të gjitha dokumentet e Prokurimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës, të gjitha raportet financiare të Komunës së Vushtrrisë, si dhe konkurset e Komunës së Vushtrrisë.

### Transparenca:

Komuna e Vushtrrisë ka shënuar progres në të gjitha raportet që kanë vlerësuar transparencën komunale.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në raportin e fundit të performancës së Komunave të Republikës së Kosovës, në transparencën komunale, Komunën e Vushtrrisë e ka vlerësuar me 95.93 pikë. Instituti GAP, ka vlerësuar transparencën buxhetore të Komunës së Vushtrrisë me 93.5 pikë, që nënkupton ngritje për tetë pozita nga viti paraprak.

### Konsultimet publike, takimet publike dhe dëgjimet publike

Gjatë vitit 2023 janë organizuar 9 konsultime publike për rregullore, strategji dhe plane të ndryshme. Janë mbajtur 14 dëgjime publike për buxhetin e vitit 2024. Gjithashtu janë mbajtur 2 takime publike me qytetarë, ku kryetari i Komunës së Vushtrrisë Ferit Idrizi, ka raportuar për punën e tij për periudhën Janar-Qershor dhe për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023. Për të gjitha këto janë mbajtur e publikuar procesverbale dhe janë përgatitur raporte, të cilat gjenden të publikuara në ueb-faqen e Komunës së Vushtrrisë.

Raporti për vitin 2023, gjendet në këtë link: <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/ep-content/uploads/sites/33/2024/01/Raporti-per-konsultime-takime-degjime-2023-SCAN-1.pdf>

### Qasja në dokumente publike

Komuna e Vushtrrisë gjatë vitit 2023 ka pranuar gjithsejtë 19 kërkesa për qasje në dokumente publike, ku të gjitha kërkesat janë aprovuar dhe kanë marrë përgjigje. Pesë kërkesa kanë qenë nga mediat, 12 kërkesa nga OJQ-të dhe dy kërkesa nga qytetarët.

Raporti me të gjitha detajet është i publikuar në ueb-faqe dhe gjendet në këtë link: <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/ep-content/uploads/sites/33/2024/01/Raporti-per-qasje-ne-dokumente-publike-Janar-Dhjetor-2023.pdf>

Komuna e Vushtrrisë ka filluar me publikimin e buletinit mujor, i cili publikohet në mënyrë elektronike në ueb-faqen zyrtare. <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/category/buletini/>

### Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

Njësiti Komunal për të drejtat e njeriut, Zyrtarja për barazi gjinore, Zyrtarja për drejta të njeriut dhe mbrojtjen e fëmijës, gjatë këtij viti ka pasur qëllim kryesor promovimin e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, promovimin e të drejtave të fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, grave vetushqyese.

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2023, NJKDNJ, ZBGJ, ZDNJ dhe ZMF, kemi mbajtur tryeza, takime, vizita, trajnime, punëtori etj. Që do të përmenden në vijim:

Janë mbajtur trajnime organizuar nga OSCE, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, nga Zyra për Qeverisje të Mirë e Republikës së Kosovës, nga OJQ Mitrovica Women Association for Human Rights, Trajnime organizuar nga FODEM etj. Për tema të ndryshme nga fusha e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Janë organizuar poashtu punëtori nga Asociacioni i Komunave dhe MAPL, dy punëtori organizuar nga USAID, OSBE, nga Caritasi zviceran, nga Predaplus, Zyra për Qeverisje të mirë, nga Qendra Kosovare për

Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës me tema nga më të ndryshmet për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut.

Është organizuar gjithashtu tryezë e rrumbullakët ku është diskutuar për fuqizimin e grave të viseve rurale.

Janë realizuar vizita në shkolla ku është bisedua për parandalimin e dhunës dhe sigurinë në shkolla, pastaj lidhur me sfidat e mekanizmit kundër dhunës në familje; aktivitet të përbashkët në kuadër të fushatës kundër trafikimit me njerëz, "TRAFIKIMI PREKË TË GJITHË! TA MBROJMË VETËN DHE FËMIJËT TANË"! Mesazhi i fushatës ishte "MOS HESHT". Janë mbajtur ligjëratat kundër Sidës me temë: "Mbroje vetën dhe të tjerët".

Janë realizuar edhe aktivitete që janë të lidhura me punën dhe aktivitetin e NJDNJ dhe barazisë gjinore.

### **Njësia e Personelit**

Menaxhimi i përditshëm i procedurave të personelit në administratën komunale:

- Shpallja e konkurseve për vendet e lira të punës në Shërbimin Civil të Komunës, në Arsim dhe Shëndetësi, përmes Sistemit Informativ të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ-HRMIS) si: Lëvizje brenda kategorisë, avancime në detyrë dhe pranimit jashtëm.
- Përcjellja e trajnimeve për nëpunësit civil.
- Përgatitja e vendimeve për nëpunësit civil të cilëve iu ka përfunduar marrëdhënia e punës.
- Përpunimi i të dhënave për nëpunësit e administratës komunale për çdo muaj dhe dërgimi i tyre në Departamentin e Thesarit dhe Departamentin e Menaxhimit të Zyrtarëve Publik (DMZP).
- Kontakte javore me IKAP-in për çështje të trajnimeve të nëpunësve.
- Bashkëpunimi me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, lidhur me procedurat e rekrutimit për nëpunësit civil dhe lidhur me ankesat e aplikantëve për vendet e lira të punës në administratën komunale.
- Përcjellja e disiplinës në punë, nëpërmjet Sistemit Elektronik, në bashkëpunim me udhëheqësit e drejtpërdrejtë.
- Është bërë vlerësimi i nëpunësve civil nga drejtorët e drejtorive komunale, në bashkëpunim me njësinë e personelit.
- Njësia e personelit në administratën komunale ka pranuar kërkesa nga studentët dhe të posa-diplomuarit për kryerjen e punës praktike në komunë, të gjitha kërkesat në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive janë aprovuar, praktikantët kanë kryer punën praktike në komunë dhe janë pajisur me vërtetime.

### **Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim**

Puna e Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim ka për qëllim promovimin e të drejtave të komuniteteve, qasjen e barabartë të të gjitha komuniteteve në shërbimet publike dhe krijimin e kushteve për kthimin e refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të kthyer në procesin e riadhesimit.

Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim kryen detyrat dhe përgjegjësitë e saj në koordinim të plotë me Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Administrimit të Vetëqeverisjes Lokale, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe bashkëpunon me organizata vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në fushën e të drejtave të komuniteteve, kthimit, riadhesimit dhe riintegrimin, si dhe merr pjesë në Mbledhjet e Komitetit Komunal për Siguri në Bashkësi, Komitetit Komunal për Komunitete, Komiteteve Lokale për Siguri Publike, Pjesëmarrja në komisionet komunale etj. Të gjitha takimet tjera me ftesë të Kryetarit të Komunës, Takimet e rregullta me komitetet e fshatrave dhe koordinimi për të gjitha çështjet thelbësore, interesi për komunitetet joshumicë që jetojnë në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim ka punuar 12 muajt e fundit për të ofruar ndihmë për komunitetet joshumicë në zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen.

Përmes bashkëpunimit të rregullt me të gjitha Drejtoritë në komunë, si dhe bashkëpunimit me Kryetarin e Komunës, kemi arritur të zgjidhim mjaft probleme të komunitetet joshumicë.

Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim dhe partneri strategjik i UNHCR-së Advancing, së bashku kanë punuar në listën e familjeve të zhvendosura brenda vendit që jetojnë në territorin e komunës së Vushtrrisë. - Janë regjistruar 21 familje.

Gjatë vitit të kaluar, KFOR-i slloven ndërtoi një shtëpi të parafabrikuar (shtëpi montazhë) për familjen e zhvendosur Markoviq të cilët jetojnë në fshatin Gojbulë. Bëhet fjalë për një familje dy anëtarëshe të shpërngulur nga Prishtina dhe që jetonin në kushte shumë të këqija.

Sa i përket personave të riatdhesuar në vitin paraprak 2023, kemi pasur 16 raste që është dashur të lëshohet një vërtetim se janë kthyer nga vendet ku kanë kërkuar azil, për të aplikuar për projekte individuale në Zyrën Komonale të Punësimit, ndërsa 6 familje kanë paraqitur kërkesë për t'u mundësuar pagesën e qirasë. Komisioni Komunal për Riatdhesim i ka shqyrtuar këto kërkesa dhe ka marr vendim që t'ua mundësojë pagesën e qirasë. Qiraja paguhet nga fondi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, sektori i riatdhesimit.

Janë miratuar 11 grante për persona të riatdhesuar në projektin "INTEGRA", i cili është financuar nga një organizatë e huaj gjermane, PREDA PLUS dhe nga komuna e Vushtrrisë.

U mbështetën projekte Start-Up me vlerë 2500 euro. Komuna e Vushtrrisë e ka financuar këtë projekt me pjesëmarrje prej 20%.

Në bashkëpunim me OSBE-në dhe organizatën joqeveritare VORAE, i është ofruar ndihmë qendrës arsimore rome në fshatin Prelluzhë.

Në komunën e Vushtrrisë janë miratuar dy projekte individuale për komunitetet joshumicë në vlerë prej 4.000 eurosh, ku pjesëmarrja e shfrytëzuesit ka qenë 10% e vlerës së projektit.

#### Përfundim

Në këtë raport është paraqitur në mënyrë të detajuar puna dhe aktivitetet e kryetarit – ekzekutivit të Komunës, brenda vitit 2023, dhe është arritur që në masë të kënaqshme të përmbushen objektivat e përcaktuara në planet e punës.

Mirëpresim sugjerimet dhe propozimet me rastin e shqyrtimit, përkatësisht diskutimeve të këtij raporti në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe kuvend të komunës, të cilat do të mund të përfshihen në tekstin final të këtij raporti.

Me respekt:

**Ferit Idrizi**



Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATE/A:	28.02.2024
REFERENCË:	10 Nr. <u>139</u> /24
PËR:	KPF-në dhe KK-në
PËRMES:	Ferit Idrizi Kyetar i Komunës
NGM/:	Drejtori i DKA-së, Albanez <del>Fahiraj</del> <u>Alban</u>
TEMA:	Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/24

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-068, për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nenit 5, të Ligjit Nr.04/L-032, për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.209/2022, Drejtoria Komunale e Arsimit, paraget këtë informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/24. Drejtoria Komunale e Arsimit, objektivat e veta të planifikuar i ka realizuar në bashkërenditje të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI-Prishtinë), me Sektorin e Inspektoratit në Mitrovicë, si dhe me partnerë të jashtëm të arsimit.

## Përmbajtja

Për punën e Drejtorisë së Arsimit.....	3
Numri i nxënësve viti shkollor 2023/2024 .....	3
Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat .....	6
Investimet kapitale:.....	8
Trajtime:.....	10
Donacionet.....	11
Suksesi i gjysmëvjetorit të parë 2023/24 .....	12
Numri i mungesave të gjysmëvjetorit të parë, të vitit shkollor 2023/24 .....	15
X. Sfidat.....	16



## Për punën e Drejtorisë së Arsimit

Viti shkollor 2023/24 ka filluar më 1 shtator 2023, ndërsa gjysmëvjetori i parë ka përfunduar më 12 janar 2024, bazuar në UA. Nr. 21. 23.

Fillimi i vitit shkollor 2023/24 u përball me një pengesë të papritur, për shkak të ndryshimit të papritur në politikën e subvencionimit të librave nga Ministria e Arsimit.

Vetëm dy javë para fillimit të vitit shkollor, Ministria njoftoi për një ndërrim nga furnizimi i drejtpërdrejtë i librave për komunat, në një model ku prindërit do të subvencionohen drejtpërdrejtë, për ti bërë vetë blerjet. Ky ndryshim i papritur krijoi sfida logjistike në pajisjen e nxënësve me tekstet e nevojshme në kohën e duhur, duke vonuar kështu fillimin e kurrikulës për një numër të shkollave, veçanërisht ato rurale.

Drejtorja e Arsimit në Komunën e Vushtrrisë, veprimi me efikasitet për të zbutur ndikimin e këtij ndryshimi të politikës. Ekipi ynë monitoroi nga afër dhënien e mjeleve për prindërit. Ofroi udhëzimet dhe ndihmën e nevojshme për shkollat, gjatë kësaj periudhe tranzitore.

Përmes vizitave të rregullta në terren, Drejtorja mbledhi të dhëna përkatëse për nivelet e furnizimit me libra dhe përcolli me krijdes trendet e furnizimit. Një takim u mbajt me drejtorët e shkollave ku u raportua mbi “gëndjen me libra”, për nivelin 6 – 9 dhe me mbështetjen e DKA-së shkollat bashkëpunuan për këmbimin e teksteve të tepërta mësimore, sipas nevojës nga shkolla në shkollë.

### Numri i nxënësve, viti shkollor 2023/2024

- ⇒ Niveli 0: ( grupmoshat 1-6 dhe çerdhet) 1148 fëmijë/nxënës
  - ⇒ Niveli 1 (klasa 1-5): 4882 nxënës
  - ⇒ Niveli 2 (klasa 6-9): 4002 nxënës
  - ⇒ Niveli 3 (klasa 10-12): 2265 nxënës
- Gjithsej nxënës 12297 nxënës

Në vijim paraqesim formën tabelare të IP "Foleja", Paralelja e ndarë e IP "Foleja" dhe IP "Foleja 2"

	Vushtrri	IP "Foleja "				
Nr	Grup moshë	Numri i femijëve në grup	Numri i dhomave	Numri i edukatoreve në IP	Numri i edukatoreve në grup	Numri i FNV
1	9 muaj-2 vjeç	12	1	3	2	
2	2-3 vjeç	16	1	2	1	2
3	3-4 vjeç	60	3	7	5	6
4	4-5 vjeç	48	2	5	4	3
5	5-6 vjeç	24	1	2	2	
6	Gjithsej	160	8	19	14	11

	Vushtrri	IP "Foleja "paralelja e ndarë				
Nr	Grup moshë	Numri i femijëve në grup	Numri i dhomave	Numri i edukatoreve në IP	Numri i edukatoreve në grup	Numri i FNV
1	9 muaj-2 vjeç	15	1	2	2	
2	2-3 vjeç	16	1	2	2	
3	3-4 vjeç	24	1	3	3	1
4	4-5 vjeç	23	1	3	3	2
5	5-6 vjeç	20	1	3	3	3
6	Gjithsej	98	5	13	13	6

Vushtrri	IP "Foleja 2"					
Nr	Grup moshë	Numri i fëmijëve në grup	Numri i dhomave	Numri i edukatoreve në IP	Numri i edukatoreve në grup	Numri i FNV
1	9 muaj-2 vjeç	12 (6+6)	2	5	2	
2	2-3 vjeç	18	1	2	2	1
3	3-4 vjeç	23	1	3	2	
4	4-5 vjeç	25	1	2	2	2
5	5-6 vjeç	28	1	2	2	2
6	Gjithsej	106	6	14	10	5

**Numri i institucioneve publike: 37 prej tyre:**

- ⇒ 2 çerdhe dhe 1 paralele e ndarë fizike e cila është në procedurë të pavarësimi
- ⇒ 3 shkolla fillore
- ⇒ 2 Shkolla të mesme të ulëta
- ⇒ 27 Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta
- ⇒ 3 shkolla të mesme të larta

**Numri i institucioneve private:**

- ⇒ 5 çerdhe private
- ⇒ 1 shkollë e mesme e mjekësisë

Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimitdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/24, ka pasur suksese dhe sfida në pëmbushjen e objektivave të përcaktuara, të cilat janë paraqitur në këtë informatë. Këto zhvillime u bënë duke u ndarë detyrat me kohë, me qëllim të përgjegjësisë dhe llogaridhënies reciproke. Gjatë kësaj kohe u realizuan këto aktivitete.

## Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat

- Janë zhvilluar monitorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë e që në objektivat kryesorë kishin: fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës, në funksion të sigurimit të cilësisë;
- Takime të rregullta me Inspektorët Regional të Arsimit;
- Takime të rregullta me KEFORIN slloven;
- Takime të rregullta të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiumi për Arsim;
- Nga ekipi komunal për vlerësimin e nxënësve janë vlerësuar 5 nxënës, si dhe rivlerësuar 5 nxënës me nevoja të veçanta arsimore;
- Kontrata të menaxhuara nga zyrtarët e DKA-së: kontrata për furnizim me material për mirëmbajtje të objekteve, kontrata për furnizim me inventarë zyrtarë shkollor, kontrata për furnizim me letër, kontrata për furnizim me shujta ditore për klasat 0-5, kontrata për furnizim me lëndë djegëse (dru) në shkolla, kontrata e transportit të nxënësve, kontrata për internet; kontrata për material zyrtar;
- Vizita të rregullta në qendrën arsimore të Komunitetit VORAE në Prelluzhë;
- Transporti i nxënësve është realizuar në 35 vija udhëtuëse;
- U mbajti punëtorja njëditore me ekipet për parandalimin e braktisjes së nxënësve të shkollave të mesme dhe të ulëta, organizuar nga ECMI- Kosova, UNICEF dhe MASHTI;
- Certifikimi i Eco-Club: Dy eko-klube të shkollave të mesme u certifikuan nga organizata CEDE, një arritje që nënvizon angazhimin tonë për edukimin mjedisor;
- Iniciativa për Barazi Gjimore: SHFMU “A.Z. Çajupi” është caktuar për një projekt nga Teach For Kosova, i cili do të themelojë një klub për barazi gjimore të përbërë nga 20 nxënës;
- Drejtorja e Arsimit, gjatë kësaj periudhe ka miratuar Planin e Veprimit për Sigurinë e Shkollave 2023-2026;
- U mbajti tryezë diskutimi me prindër, tema: Efektet negative të drogës në Gjimnazin “Eqrem Çabej” Vushtrri;
- Drejtorja Komunale e Arsimit ka organizuar pyetësor për dhunën në shkolla, si dhe e ka analizuar pyetësorin, dhe në bazë të kësaj analize i cakton ligjëratat vetëdijesuese në shkolla;
- U organizua tryezë diskutimi për të shënuar 19 Nëntori - Ditën botërore të parandalimit të abuzimit ndaj fëmijëve;
- U përfunduan parqet në SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri dhe në Gjimnazin “Eqrem Çabej” Vushtrri, projekt i financuar nga CARITAS zviceran- Ndikimi i Rinisë në Mjedis (YENI), dhe CEDE, projekti ka kushtuar 8800 euro, komuna ka participuar 800 euro;
- U shënuar themelimi i 60-vjetorit të gjimnazit “Eqrem Çabej” në Vushtrri;
- U shpërblyen 5 shkolla të Vushtrrisë të cilat më së miri i kanë futur të dhënat në SMLA (për dhunën e fëmijëve në shkollat); SHMU-1, SHMU-2, SHFMU “A. Z. Çajupi” Vushtrri, SHFMU “Latif Berisha” Doberllukë, dhe SHFMU “Liria” Stroc;

- SHFMMU “A. Z. Çajupi” u caktua shkolla për projektin nga Teach For Kosova, që do ta krijojë klubin e barazisë gjinore me përbërje prej 20 nxënës;
- Gjatë muajit nëntor 2023, u organizuan garat e matematikës “Olimpiada matematike e Kosovës”; për shkollat e mesme të ulëta klasat e VII-ta, vendi i parë SHFMMU “A. Z. Çajupi” Vushtrri, për klasat e VIII-ta vendi i parë SHMU-2 Vushtrri, për klasat e IX-ta SHMU-2 Vushtrri, dhe tre vendet e para për shkollat e mesme Gjimmazi “Eqrem Çabej” Vushtrri;
- Zyrtari i DKA-së, për shkolla të Mesme të Ulëta, më datë: 28. 29. 30 nëntor 2023, mori pjesë në konferencë ndërkombëtare në Tiranë, ku morën pjesë 20 shtete të rajonit për ta trajtuar pabarazinë në arsim;
- Ka filluar trjetëzimi teknik për digitalizimin e shkollave nga MASHTI, SHMU-1, SHMU-2, etj.
- U përrua salla e kabineit të IT-së në gjimnazin “Eqrem Çabej” Vushtrri;
- Takim me zyrtarët e MASHTI-it lidhur me fuzionimin e shkollave me numër të vogël të nxënësve;
- Janë shpallur 7 konkurse për mesim lëndorë, janë punësuar 20 mesimdhënës;
- Vizita të rregullta pune në QB “Nënë Tereza” Mitrovicë, Ekipi për Vlerësim Pedagogjik të FNV;
- Vlerësim i FNV me Ekipin për Vlerësim Pedagogjik të FNV;
- Përfshirje në projektin “Library Project Kosova”, Marrëveshje Bashkëpunimi me DKA, aktiviteti “Biblioteka Qarkulluese dhe Ora e Leximit”;
- Vizitë në Suedi, ekipi i edukatorëve në qytetin Vaxjo, nga dt. 1. 10. 2023 deri më 6. 10. 2023, vizitë studimore institucioneve parashkollore në qytetin Vaxjo;
- Takim pune me përfaqësueset e UNICEF, OIQ “Koralet” për nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit mes DKA dhe UNICEFIT, për vazhdimin e kontratave për tre edukatore;
- Shënimi i aktivitetit “Stop trafikimit të genieve njerëzore”, në SHFMMU “Bahri Kuqi” Shtruerë;
- Aktivitet: Muaji-Rozë u zhvillua në të gjitha shkollat;
- Në SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri, ka vazhduar projekti; mesimi në vendin e punës mbështetur nga GFA/GIZ dhe 170 nxënës të klasave XI-ta dhe XII-ta janë duke kryer praktikën në vendin e punës.
- SHMP “Bahri Haxha” do të jetë pjesë e programeve të Erasmus+ me projektin Culti Vëting.
- Në SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri, janë nënshkruar marrëveshjet për realizimin e “Mësimi dual”, me Interex dhe Viva Fresh, për nxënësit e profilit “Tregtarë me pakicë dhe shumicë”;
- SHFMMU “Bahri Kuqi” Shtitaricë, është përfutuese e një projekti KIST+ e mbështetur nga Organizata e Mbrojtjes së Bashkuar të Holandës, në mesin e 12 shkollave në nivel vendi për Edukim Medial.

## Investimet kapitale:

- Renovimi i çerdhes 1;
- Renovimi i çerdhes 2;
- Ndërtimi i depos për çerdhen III;
- Ndërtimi i depos për çerdhen II;
- Renovimi i SHFMU “Migjeni” Stanoc - lagjja Cakaj;
- Renovimi i SHFMU “Lumni Surdulli” Samadrexhë;
- Renovimi SHFMU “Enver Hadri” Smrekonicë;
- Ndërtimi i platos për SHFMU “Emin Duraku” Novolan;
- Ndërtimi i depos në SHFMU “Adem Voca” Pasomë;
- Ndërtimi i depos për SHFMU “Migjeni” - lagjja Cakaj;
- Ndërtimi i depos për SHFMU “Migjeni” Stanoc;
- Ndërtimi i depos për SHFMU “Enver Hadri” Smrekonicë;
- Ndërtimi i depos për SHF “Ali Kelmendi” Vushtrri;
- Ndërtimi i depos për SHFMU “7 Marsi” Bukosh;
- Ndërtimi i depos për SHFMU “Abdyll Frashëri” Druar;
- Rrethoja dhe muri mbrojtës për SHFMU “Bajram Curri” Dumnice;
- Fillimi i ndërtimit të objektri shtesë në SHFMU “Mustafë Venhari” Vushtrri;
- Renovimi i SHFMU “Latif Berisha” Doberllukë;
- Renovimi i SHFMU “Lirja” Stroc – Gllavotin;
- Renovimi i SHFMU “Martirët” Reznik;
- Renovimi i SHFMU “12 Qershor” Mihalig;
- Renovimi i SHFMU “Rilindja” Maxhunaj;
- Renovimi i SHF “Ali Kelmendi” Vushtrri;
- Renovimi i SHFMU – Lumadh;

- Renovimi i SHFMMU “Adem Vocca” Pasomë;
- Ndërtimi i platos për SHFMMU “28 Nëntori” Vërnice;
- Ndërtimi i depos për SHFMMU “Martirë” Reznik;
- Pajisje për praktikë profesionale SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri;
- Meremetimi i Gjinnazit “Eqrem Çabej” Vushtrri;
- Meremetimi i SHMT “Lufti Musiqi” Vushtrri;
- Teknologji informative SHMT “Lufti Musiqi” Vushtrri;
- Teknologji informative gjinnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri
- Teknologji informative SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri
- Blerja e pajisjeve të TI (televizor) “Bahri Haxha” Vushtrri;
- Ndërtimi i tualeteve në SHMMU “Ernin Duraku” Novolan;
- Pajisje për praktikë profesionale SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri;
- Meremetimi i SHFMMU “Rexhep Musa” Ceceji;
- Renovimi i SHF “Ali Kelmendi” Vushtrri;
- Renovimi i SHFMMU – Lunadh;
- Renovimi i SHFMMU “Lummi Surdulli” Samdrexhtë;
- Renovimi i SHFMMU “Rilindja” Maxhamaj;
- Renovimi i SHFMMU “Hajrullah Shala” Akrashiticë.

## **Trajnime:**

- Zyrtarët e DKA-së, morën pjesë në trajnimin për vlerësim të tenderëve ekonomikisht më të favorshëm, organizuar nga USAID për Integritet të Komunave të Kosovës, zbatuar nga DAI Global LLC;
- Mësimdhënës të SHMU-2, SHFMMU “Liria” Stroc dhe të SHFMMU- Pestova, u trajnuan për orientim në karrierë nga organizata gjermane-GIZ;
- Zyrtarët e DKA-së, u trajnuan për ta hartuar planin kundër braktisjes së shkollës;
- Trajnimi i edukatoreve të IP “Foleja 2”, pilot-projekt i MASHT, Kurrikula në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme;
- Nxënës dhe mësimdhënës të SHFMMU “Bahri Kuqi” Shtitaricë, janë trajnuar në kuadër të projektit KIST+ e mbështetur nga Organizata e Mbrojtërisë së bashkuar të Holandës, në mesin e 12 shkollave në nivel vendi për Edukim Medial;
- Mësimdhënës të SHFMMU “Hajrullah Shala” Akrashitcë, ka ndjekur trajnimin: “Pluralizmi dhe respektimi i diversitetit përmes edukimit” dhe “Edukimi (orientimi) në karrierë”;
- Janë trajnuar mësimdhënësit e SHFMMU “Liria” Stroc, për: “Të mësuarit e ndërsjellë, shkëmbimi i praktikave dhe përvojave, si dhe mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të Planeve të Veprimit, për adresimin e nevojave të fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik”, nga BE – Qendra për Arsimit e Kosovës KEC;
- Janë trajnuar 8 psikologë të shkollave dhe 1 psikologe nga DKA dhe janë pajisuar me certifikatën e ABA-terapisë nga Qendra Profesionale për Gjithpërfshirje- Prishtinë;
- Janë trajnuar 22 nxënës të SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri dhe certifikuar në trajnimin: “Zhvillimi i aftësive kreative për film dhe Animacion” tek të rinjtë, nga Instituti për zhvillim dhe integrim;
- Zyrtarët e Qendrës së Karrierës janë trajnuar për orientim e këshillim në karrierë dhe SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri është marrë si model nga MASHT për hartimin e strategjisë, për këshillim dhe orientim në karrierë.



## Donacionet

- Kompania “Rida Com” me pronar Naser Zymberi, ka rregulluar pjesët e mbetura për gjelbërim brenda oborrit të SHFMU “Emin Duraku” Novolan;
- SHFMU “Andon Zako Çajupi” & Interex, Union-SHPK dhe SHPK- Camel - Në kuadër të festave të fund vinit kanë shpërndarë dhurata për të gjithë nxënësit e nivelit 1 (klasa 1-5);
- SHFMU “Gj. K. Skënderbeu” Pantinë, ka pranuar donacion nga IPKO: 4 TV “Fuego 55”, 1 Printer laser MFP 135a, 1 Laptop Acer, 4 Mbajës TV, 4 Kaballo HDMI (5m), 1 USB, Donacioni nga “Aztech”: 1 TV “Toshiba 58”, Donacion nga Extra Color: Ngjyrë e bardhë, 25 l.
- SHFMU “Enver Hadri” Smrekonicë, ka pranuar donacion: 11 kompjuterë për nxënës (nga firma zvicerane FON FON LLC, me menaxher Rafet Mehmeti), klimë për parafillorët dhe tepison. Donacion nga KFOR-i slloven për parafillorët: Një televizor, një tepih puzzle, lodra për fëmijë, mjete pune dhe konkretizimi;
- SHFMU “Abdyll Frashëri” Druar, ka përfutur një kosh për basket nga USAID-i;
- SHFMU “Liria” Stroc, ka pranuar: Smart Bord (Tabelë e mençur) nga organizata gjermane GIZ;
- SHF “Mustafë Venhari” Vushtri, ka pranuar nga Fadil Saraçi 1500 euro, si dhe 200 euro nga një prind që deshi të mbetej anonim.
- SHFMU “Migjeni” Stanoc i E., Ordinanca “Drita”- Stanoc i Epërm, Dr. Nystret Haradinaj, dhuron libra për nxënësin e klasës së dytë dhe pajisje shkollore. Gjatë muajit tetor mobileria Eli Decor-Stanoc i Ep., me pronar Hajrush Shala pajisi klasat në lagjen Cakaj me dollapa për nxënës dhe tabela për vendosjen e punimeve të nxënësve. OJQ ACCESS- bëri dekorimin e shkollës dhe krijoi një ambient shumëngjyresh dhe motivues.
- Prindërit e shkollës në Pestovë, ngjyrosen vijat e fushave dhe rregullimin e tabelës së basketbollit. Tavolinën e ping-pongut, si dhe pajisjen me dollapa për një klasë.

## Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, 2023/24

Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, viti shkollor 2023/24 Klasa 1 - 5, krahasuar me periudhën e njëjtë						
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar
2023	64.62%	20.05%	11.14%	2.98%	1.20%	0.00%
2022	62.04%	21.81%	12.12%	3.34%	0.66%	0.02
Krahasueshmëria	2.58%	-1.76%	-0.98%	-0.36%	0.54%	-2.00%

Shkëlqyeshëm: ka ngritje të suksesit për 2.58 %


Shumë mirë: ka rënie të suksesit për 1.76 %

Mirë: ka rënie të suksesit për 0.98 %

Mjaftueshëm: ka rënie të suksesit për 0.36 %

Të pamjaftueshëm: ka ngritje të pamjaftueshmërisë për 0.54 %

## Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, viti shkollor 2023/24 klasa:1-5



### Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, viti shkollor 2023/24 klasa: 6- 9, krahasuar me periudhën e njëjtit

Periudha e njëjtit	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjafueshëm	Të pamjafueshëm	Të panotuar
2023	24.89%	21.06%	18.31%	4.49%	30.80%	0.45%
2022	27.50%	22.33%	20.92%	4.34%	24.40%	1%
Krahasueshmëria	-2.61%	-1.27%	-2.61%	0.15%	6.40%	-0.05%

Shkëlqyeshëm: ka rënie të suksesit për 2.61 %


Shumë mirë: ka rënie të suksesit për 1.27 %

Mirë: ka rënie të suksesit për 2.61 %

Mjafueshëm: ka ngritje të suksesit për 0.15 %

Të pamjafueshëm: ka ngritje për 6.40 %

## Suksesi i gjysmëvetorit të parë, viti shkollor 2023/24, klasa:6-9



## Numri i mungesave të gjysmëvejtorit të parë, të vitit shkollor 2023/24

Klasa	Numri i nxënësve	Të arsyeshme	Numri i mungesave të arsyeshme për nxënës	Të paarsyeshme	Numri i mungesave të paarsyeshme për nxënës
Klasa 1	956	7922	8	703	0.7
Klasa 2	988	7619	8	758	0.8
Klasa 3	955	8496	9	1008	1
Klasa 4	941	7676	8	948	1
Klasa 5	1007	9366	9	1938	2
Klasa 6	1012	12977	13	1269	1
Klasa 7	960	11846	12	4329	5
Klasa 8	1005	14760	15	3841	4
Klasa 9	958	15937	17	6709	7
Klasa 10	793	13586	17	7929	10
Klasa 11	723	14193	20	10724	15
Klasa 12	713	15331	22	13763	19

## X. Sfidat

- Dështimi i konkurseve vetëm me një kandidat (edhe pse është i kualifikuar):
- Mungesa e të kualifikuarve për lëndët shkencore:
- Mungesa e të kualifikuarve për lëndën e IT;
- Rritja e zhvillimit të praktikave profesionale;
- Gjithëpërfshirja; mungesa e asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore;
- Mungesa e sallave sportive;
- Mungesa e kabineteve dhe mjeteve didaktike;
- Fuzionimi i shkollave;
- Mungesa e komunitetit të prindërve në procesin e përfshirjes.
- Kërkesat e mësimdhënësve për pushime disa ditore jashtë vendit ( liberalizimi )
- Numri i vogël i nxënësve në shkolla të fshatrave; (paraqesim edhe në formë tabelare );

Nr.	Shkolla	Vendi	Nr. nx.
1	SHFEMU "Adem Voca"	Sumë	54
2	SHF"Ali Kelmendi"	Studime e Posthme	24
	SHF"Ali Kelmendi"	Studime e Epërme	21
4	SHFEMU" Azem Bejta "	Dobofc	32
	SHFEMU" Azem Bejta "	Begic	32
5	SHFEMU" Bajram Curi "	Dumnicë e Epërme	12
6	SHFEMU" Liria "	Gllayovin	15
7	SHFEMU" Dëshmorët "	Zhitivode	19
8	SHFEMU "Rexhep Musa "	Ceceli	48



Republika e Kosovës  
Republika Kosova ▪ Republic of Kosova



Komuna Vushtrri  
Opstina Vucitrn ▪ Municipality of Vushtrri

<b>DATE/A</b>	25/03/2024
<b>REFERENC-Ë:</b>	013.Nr.67/24
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Kuvendin Komunal -Vushtrri
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH</b>	Kryetarit të Komunës z.Ferit Idrizi
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Bujar Pllana Drejtor i Drejtorisë për Inspektime
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Informatë për Kuvend</b>

Duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësit, në mbështetje të legjislacionit aktual në fuqi si organ mbikëqyrës, Inspektorati komunal i ndërtimit me një inspektor të vetëm, gjatë vitit 2023 ka ushtruar disa aktivitete inspektuese në terren lidhur me ndërtimet e reja në territorin e Komunës së Vushtrrisë .

Po ashtu krahas aktiviteteve inspektuese të cilat janë zhvilluar qoftë sipas detyrës zyrtare apo edhe duke u bazuar në ankesat e qytetarëve, në ato raste kur kemi hasë në parregullsi kemi marrë masa ligjore komfor ligjeve në fuqi.

Gjatë kësaj periudhe të vitit kalendarik janë kryer inspektime në bazë të ligjit dhe rregulloreve që janë në fuqi për fushën e ndërtimit deri në muajin e Prill, planifikimi dhe rrjedha e punëve ishte në nivelin e duhur të dinamikës së punëve, përjashtimisht rasteve emergjente të paplanifikuara. Planifikimi është bërë duke u bazuar në aktivitetet e planifikuara dhe të implementuara.

Për këtë periudhë janë kryer inspektime lidhur me ndërtimet e objekteve të ndërtimit të lartë dhe të ulët, duke kontrolluar terrenin e komunës së Vushtrrisë, ndërprerjen e të gjitha ndërtimeve pa leje, kontrollimin e objekteve me leje ndërtimi, rrënimin e objekteve pa leje si dhe rrënimin e disa objekteve të vjetra shkollore duke u bazuar në raportin e vlerësimit nga ana e komisionit lidhur me ato objekte të vjetra të cilat paraqesin rrezik për shoqërinë.

Për të ardhur deri te një analizë sa më e saktë e punëve kemi bërë grumbullimin e të dhënave për aktivitetet a planifikuara dhe atyre të realizuara, duke nxjerrë statistika e deri te rekomandimet për të rritur efikasitetin në punë.

Ligjet në të cilat duhet bazuar:

- Ligji Nr. 04/L-110 Për Ndërtim;
- Ligji Nr.04/L- 175 Për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit;
- Udhëzimi Administrativ 05/2017 Për Mbikëqyrjen Inspektuese dhe Procedurën për Lëshimin e Certifikatës së Përdorimit;
- Udhëzim Administrativ Nr. 20/2013 Për Mënyrën Dhe Shumën e Gjobave Ndaj Pjesëmarrësve Në Ndërtim;
- Udhëzim Administrativ 04/2017 Për Kategorizimin e Ndërtimeve;
- Rregullore Nr.205/13 Për Rregullat Dhe Procedurat e Ndërtimit Të Objekteve.

Aktivitetet e planifikuara

- Planifikimi dhe zbatimi i punëve të planifikuara në kuadër të Drejtorisë për Inspektime,
- Njoftimi dhe aplikimi me bazën ligjore që do të përdoret në kuadër të sektorit,
- Identifikim i problemeve dhe propozimet për tejkalimin e tyre,
- Përgatitja e raporteve javore, mujore.
- Kontrollimi i terrenit,
- Ndërprerja e ndërtimeve pa leje,
- Kontrollimi i ndërtimeve me leje,
- Inspektimi përfundimtar i objekteve të ndërtuara,
- Rrënimi i objekteve pa leje ndërtimi dhe objekteve të vjetra të cilat paraqesin rrezik për shoqërinë.



### Aktivitetet e implementuara

- Në kuadër të kontrollimit të terrenit, janë përpiluar procesverbalet dhe Aktvendime për ndërprerje të punimeve lidhur me ndërtimet pa leje ndërtimi.
- Ndërprerja e ndërtimeve pa leje ndërtimi, ndalimi i punimeve është urdhëruar me afat kohor menjëherë si dhe janë vendosur shirit rrethues të cilët ndalojnë punimet pa leje deri në pajisjen me dokumentacion përkatës të lejes ndërtimore, shumica e ndërtimeve pa leje janë shtëpi banimi, por ka edhe objekte afaristë.
- Kontrollimi i objekteve me leje ndërtimi.
- **Procesverbale.....78**

Procesverbalet janë lëshuar për ndërtimet të bëra pa leje ndërtimi dhe pa pëlqime urbanistike, kryesisht për ndërtime të banimit individual, por ka pas edhe raste të ndërtimeve për të cilat kërkohen pëlqimet urbanistike, siç janë: terasat para objekteve, ndryshimet në objektet ekzistuese me leje ndërtimi, ndryshimet në kulmet e objekteve dhe në fasadat e tyre.

- **Vendime për ndërprerjen e ndërtimeve pa leje ndërtimi 13**

Vendimet për ndërprerje të punimeve janë lëshuar për objektet që kërkohet leja e ndërtimit por të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi, vendimet për ndërprerjen të punimeve kanë karakter të urdhëresës së prere për ndërprerje të punimeve deri në pajisje me leje ndërtimi.

- **Vendimet për rrënim .....1**
- **Gjoba mandatorë .....3**

Gjobat mandatorë janë lëshuar në bazë të udhëzimit administrativ për shqiptimin e gjobave mandatorë, për ndërtimet e bëra pa leje dhe pjesëmarrësve në ndërtim të cilën kanë punuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në lidhje me ndërtimin e objekteve.

- **Takimet me palë .....13**
- **Lëndët (kërkesat) e pranuar .....240**
  - Lëndët e përfunduara .....236
  - Lëndët të refuzuara .....2

- Lëndët e pezulluara.....0
- Lëndët në procedurë.....2

Kërkesat që i janë drejtuar Drejtorisë Për Inspektime, përkatësisht sektorit të ndërtimit kanë të bëjnë kryesisht me inspektimet rutinë të cilat bëhen nga Investitorët e ndërtimeve me leje ndërtimi për inspektimet e fazave të ndërtimit, prej fillimit të ndërtimeve deri në përfundimi të ndërtimit, ne si drejtori i jemi përgjigjur këtyre kërkesave duke vizituar vend ndërtimet dhe plotësuar kartelën e inspektimit.

Kemi pas edhe kërkesa të natyrës së ndryshme të ankesave nga qytetarët të cilët kanë kërkuar inspektime të gjendjeve faktike në terren.

Për të gjitha kërkesat e drejtuar drejtorisë sonë i jemi përgjigjur komfor përgjegjësive dhe kompetencave.

Pyetje nga KPF.

1. Raport për objektin që është duke u ndërtuar përball postës?

Objekti në fjalë posedon leje ndërtimore dhe punimet e ndërtimit janë duke i zhvilluar sipas lejes ndërtimore.

2. Raport për objektin përballë urës së gurit?

Duke u bazuar në dokumentacion e pranuar përmes protokollit zyrtar, konstatojmë se investitori në fjalë ka dorëzuar projektin kryesor si dhe projektin e statikes me numër të protokollit me të cilën vërtetohet se sipas Drejtorisë për Inspektime projekti në fjalë është valid konform lejes ndërtimore me numër të lartcekur dhe si i njëjti ligjërisht ka plotësuar kushtet e parapara për vazhdimin e ndërtimit sipas projektit në fjalë.

### **Sfidat**

Pavarësisht mbarëvajtjes së punës, në Drejtorinë për Inspektime kemi hasur edhe në sfida të ndryshme të cilat kanë penguar rrjedhën normale të punës, që edhe ka qar deri te shkelja e ligjit nga ana e qytetarëve, ndër sfidat kryesore të evidentuara janë:

- Mungesa e Planifikimit Hapësinor, Mungesa e Hartës Zonale dhe Planeve Rregulluese të hollësishme, në shumicën e zonës mungojnë planet rregulluese po ashtu pa përputhshmëria e planeve me gjendjen faktike në terren, mangësi të tilla detyrojnë qytetarët të ndërtojnë objekte pa leje ndërtimi.

- Vonesat procedurale në lëshimin e lejeve ndërtimore,
- Pamundësia për tu pajisur me leje ndërtimore (mungesa e Planeve Rregulluese, zona nën komasacion, problemet pronësore, etj.), propozojmë që kuvendi komunal të hartojë rregullore komunale për lehtësimin dhe tejkalimin e këtyre sfidave,
- Nevoja për banim (rritja e familjes, shtimi i numrit të të martuarve, nevoja për banim më të qëndrueshëm),
- Kërcënimet dhe sulmet e vazhdueshme ndaj stafit, mungesa e mbështetjes shëndetësore dhe financiare,
- Mungesa e stafit, ku gjatë tërë vitit Inspektorati i ndërtimit ka qenë me një inspektor të vetëm gjë që nuk reflekton mirë për Komunën e Vushtrrisë në aspektin e inspektimit sa i përket inspektimit në fushën e ndërtimit me arsyetimin, duke u nisur nga fakti se në territorin e Komunës së Vushtrrisë janë duke u kryer punime lidhur me ndërtime të reja e që është e papërbalueshme për një inspektor të vetëm të ndërtimit kjo përgjegjësi për tërë Komunën e Vushtrrisë.
- Mungesa e automjeteve dhe pajisjeve teknologjike për terren,

### Rekomandimet

Analiza e aktiviteteve të planifikuara dhe atyre të realizuara si dhe sfidave na dërgon deri te rekomandimet, me përmirësimin e të cilave puna dhe efikasiteti në Drejtorinë për Inspektime përkatësisht në sektorin e ndërtimit do të rritet, si rekomandime kryesore që do të ndikonin në performancë janë:

- Rritja e numrit të inspektorëve,
- Profesionalizimi dhe trajtimet adekuate,
- Automjetet për inspektime,
- Pagesa për rrezikshmërinë,
- Mjetet teknologjike për punë



Nga kjo që u tha më lartë, duke parë sfidat me të cilat ballafaqohet Komuna e Vushtrisë, dhe duke u bazuar në përvojën dhe praktikën profesionale shprehim gatishmërinë në ofrimin e të gjitha këshillave të nevojshme për tejkalimin e këtyre sfidave.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrisë**  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



---

**Për:** KPF-në dhe Kuvendin e Komunës  
**Propozues:** Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës   
**Hartues:** DBZHR, Ergin Sunguri   
**Tema:** Propozim- drfat-rregullorja për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat.

---

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12, shkronja “c” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 qershor 2008”; neni 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27 e datës 3 qershor 2018”, neni 36, paragrafi 3 i rregullores financiare Nr.01/2013 e datës 25 gusht 2013 të MF Shpenzimi i parave publike si dhe nenin 19, paragrafi 1.3 të Statutit të komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2024 miraton këtë:

**DRAFT - RREGULLORE**

**PËR PËRKRAHJEN E FERMERËVE NË BUJQËSI DHE BIZNESEVE NË SEKTORIN PRIVAT**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton kriteret, standardet dhe procedurat themelore për financimin publik të personave fizikë dhe juridikë me qëllim të vendosjes së një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin me fonde publike të programeve dhe projekteve që janë të interesit publik.

## Neni 2 Fushëveprimi

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga organet dhe drejtoritë e komunës, sipas një thirrje publike për financim të projekteve dhe programeve, dhe që i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje.
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk aplikohen për thirrjet e publikuara para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

## Neni 3 Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, përkufizimet në vazhdim kanë këtë kuptim:

1. **Burimet publike të financimit** - nënkupton të gjitha fondet e ndara në kuadër të buxhetit të komunës për njësitë buxhetore, përfshirë këtu edhe fondet nga burimet e huaja të cilat menaxhohen nga njësitë buxhetore, me kusht nuk është arritur ndonjë marrëveshje e veçantë e cila përcakton modalitete dhe procedura të veçanta të menaxhimit të tyre;
2. **Mbështetje financiare** – nënkupton çdo formë të mbështetjes, e cila shprehet në vlerë monetare, pa marrë parasysh emërtimin e saj;
3. **Mbështetje jo-financiare** – nënkupton mbështetjen jo-financiare përmes ofrimit të pajisjeve dhe makinave, serrave, materialit fidanor, bagëti, bletë, farëra, repromaterial, dhe format e tjera të mbështetjes që nuk jepen në vlerë monetare;
4. **Subvencion** – nënkupton të gjitha transferet e njëanshme të pakthyeshme për personat fizikë dhe juridikë, të cilat bazohen në një marrëveshje të nënshkruar në mes përfituesit dhe komunës.
5. **Grante** – nënkupton shumën e caktuar të parave të cilat transferohen te personi fizik dhe juridik për realizimin e një qëllimi të caktuar, ku specifikohet paraprakisht në detaje mënyra e shpenzimit të parave.
6. **Aplikues** – nënkupton fermerin, individin, biznesin, e regjistruar në Republikën e Kosovës në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, që ka aplikuar për mbështetje financiare në kuadër të ndonjë thirrje publike për mbështetje financiare;
7. **Përfitues** – nënkupton fermerin, individin, biznesin, e regjistruar në Republikën e Kosovës në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të cilët janë kontraktuar sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje;
8. **Banor resident** – nënkupton personin që jeton në territorin e Komunës së Vushtrrisë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.
9. **Investitor në territorin e komunës së Vushtrrisë** – nënkupton personin që jeton jashtë territorit të komunës së Vushtrrisë por zhvillon aktivitet ekonomik dhe bujqësor brenda territorit të komunës së Vushtrrisë.

## Neni 4 Parimet e përgjithshme

1. Komuna ofron mbështetje financiare duke u bazuar në parimet si në vijim:
  - 1.1. Konkurrenca;
  - 1.2. Trajtimi i barabartë dhe mos diskriminim i aplikuesve, si dhe gjithë përfshirja gjinore e përfituesve
  - 1.3. Transparenca në procedura dhe vendimmarrje në gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kriterëve dhe procedurave, aplikimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e përfituesve;
  - 1.4. Kriete të caktuara më parë të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të aplikuesve kundrejt objektivave dhe prioriteteve të mbështetjes financiare;
  - 1.5. Parimi i efektivitetit dhe i ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e parapara me një kosto sa më të favorshme për shoqërinë;
  - 1.6. Respektimi i plotë i parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në shfrytëzimin e fondeve publike;
  - 1.7. Financim përmes fondeve publike të projekteve dhe programeve që janë me prioritet për komunën dhe në interes të publikut;
  - 1.8. Ruajtjen e pavarësisë së përfituesve;
  - 1.9. Parandalim të çfarëdo konflikti të interesit;
  - 1.10. Sigurimin e dyshkallshmërisë në trajtimin e ankesave të aplikantëve; dhe
  - 1.11. Parandalimin e financimit të çfarëdo aktiviteti që është në kundërshtim me këtë rregullorë.

## Neni 5 Planifikimi i mbështetjes financiare

Komuna planifikon mbështetje financiare në kuadër të buxhetit vjetor të komunës, në linjë me prioritetet dhe objektivat strategjike dhe në konsultim me palët e interesit dhe shoqërinë civile.

## Neni 6 Fusha e mbështetjes

**Bizneset-** persona juridikë të regjistruar në ARBK të cilët zhvillojnë ndonjërin prej veprimtarive ekonomike dhe që veprimtarinë e tyre e zhvillojnë në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

**Fermerë-** persona fizikë dhe juridikë të cilët merren me aktivitete bujqësore, respektivisht: mbarëshkrimin e kafshëve, kultivimin e bimëve me qëllim të prodhimit të ushqimit për njerëz dhe

kafshë, kultivimin e bimëve dekorative - aromatike dhe mjekësore, kërpudhave dhe prodhime të tjera për nevoja të njeriut.

### **Neni 7** **Kapacitetet institucionale**

1. Kryetari i komunës duhet të emërojë zyrtarin përgjegjës apo të themelojë ekip të veçantë me qëllim të monitorimit të zbatimit të projektit/programit si dhe vlerësimit të përmbushjes së objektivave dhe arritjes së rezultateve të parapara.
2. Komuna duhet të disponojnë me kapacitete institucionale, duke përfshirë burimet e nevojshme njerëzore për të zbatuar kërkesat e kësaj Rregulloreje.

### **Neni 8** **Komisioni vlerësues**

1. Kryetari i komunës themelon Komisionin Vlerësues, i përbërë nga anëtarët që kanë përvojë dhe integritet, me mandat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve.
2. Përbërja e komisionit, kohëzgjatja dhe mandati i tij caktohet me vendim të Kryetarit të komunës.
3. Komisioni Vlerësues përbëhet nga tre deri pesë (3 deri 5) anëtarë, numri i anëtarëve duhet të jetë tek.
4. Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit Vlerësues nga paragrafi 3 i këtij neni, duhet të parashihet me vendim edhe një (1) anëtar rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevoje anëtarin e Komisionit Vlerësues i cili ka konflikt interesi.
5. Komisioni Vlerësues themelohet gjatë kohës sa thirrja publike është e hapur dhe emrat e anëtarëve të Komisionit Vlerësues bëhen publik brenda shtatë (7) ditëve pas themelimit të Komisionit.
6. Komisioni Vlerësues në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës, përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision dhe këto rregulla bëhen publike brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit.
7. Anëtarë të komisionit vlerësues nuk mund të jenë të emëruarit politikë.

### **Neni 9** **Komisioni i ankesave**

1. Kryetari i komunës themelon Komisionin e Ankesave, i përbërë nga anëtarët që kanë përvojë dhe integritet, i cili ka për mandat shqyrtimin e ankesave të aplikantëve.
2. Komisioni i Ankesave ka mandat të shqyrtojë ankesat ndaj vendimeve për moskualifikim si rezultat i mospërmbushjes së kriterëve procedurale të parapara në thirrjen e publikuar, si



dhe ankesat ndaj vendimit për ndarje të mbështetjes financiare, në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare.

3. Komisioni i Ankesave përbëhet nga 3 anëtarë dhe ka mandat 2 vjeçar.
4. Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit të Ankesave nga paragrafi 3 i këtij neni, ofruesi i mbështetjes financiare duhet të parasheh me vendim edhe një (1) anëtar rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e komisionit i cili ka konflikt interesi.
5. Përbërja e komisionit caktohet me vendim të Kryetarit të komunës, në Komisionin e Ankesave nuk mund të marrin pjesë anëtarët të cilët kanë marrë pjesë në shqyrtimin e aplikacionit në kuadër të Komisionit Vlerësues dhe të emëruarit politik.

## **KRITERET DHE PROCEDURAT E THIRRJES PUBLIKE DHE APLIKIMIT**

### **Neni 10**

#### **Shpallja publike e thirrjes**

1. Çdo mbështetje financiare duhet të shpallet me thirrje publike, e cila duhet të publikohet në ueb faqen e komunës.
2. Thirrja duhet të jetë e hapur për së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë pune.
3. Gjatë kohës kur thirrja është e hapur, palët e interesuara mund të kërkojnë sqarime përmes postës elektronike dhe informacione shtesë përkritazi me thirrjen, por jo më vonë se tetë (8) ditë pune para mbylljes së thirrjes publike.
4. Komuna është e obliguar të jap sqarime dhe përgjigje me shkrim, dhe të njëjtat t'i publikojë në faqen e njëjtë në të cilën është publikuar thirrja, të paktën tetë (8) ditë para mbylljes së thirrjes.
5. E gjithë korrespondenca e përshkruar në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni përkritazi me sqarimet e dhëna për aplikuesit, duhet të ruhet në dosjen e thirrjes.

### **Neni 11**

#### **Kriteret e thirrjes publike dhe dokumentacioni i kërkuar**

1. Thirrja publike duhet të përmbajë informacionin në vijim:
  - 1.1. udhëzimet e thirrjes për aplikantët, duke përfshirë kriteret për përzgjedhjen e përfituesve;
  - 1.2. formularin për përshkrimin e projektit/programit (nëse aplikohet);
  - 1.3. formularin e buxhetit (nëse aplikohet);
  - 1.4. listën e plotë të dokumenteve të nevojshëm për t'u paraqitur në thirrje;
  - 1.5. datën e hapjes dhe mbylljes së thirrjes;
  - 1.6. të dhëna për mënyrën e dorëzimit të aplikacioneve; dhe
  - 1.7. të dhëna për kalendarin tentativ të realizimit të thirrjes dhe kontraktimit.

## Neni 12

### Përmbajtja e udhëzimeve për aplikantët

1. Me rastin e hapjes së thirrjes, duhet të publikohen udhëzimet e thirrjes për aplikantët.
2. Udhëzimet për aplikantët duhet japin informacion mbi arsyet dhe objektivat e thirrjes, kushtet e thirrjes, metodën e aplikimit dhe zbatimin të procedurës së thirrjes, si dhe duhet të përfshijnë informacionin në vijim:
  - 2.1. një përshkrim të problemit i cili synohet të adresohet përmes thirrjes;
  - 2.2. objektivat e përgjithshme të thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e burimeve financiare;
  - 2.3. një përshkrim të fushave në të cilat aplikanti mund të parashikojë zbatimin e programeve apo projekteve;
  - 2.4. numri i përafërt i kontratave të cilat do të mund të financohen për pjesët e veçanta të programit/projektit dhe shuma e përgjithshme e mjeteve financiare në dispozicion;
  - 2.5. shumat më të ulëta dhe më të larta financiare për çdo program ose projekt dhe numrin e pritshëm të programeve apo projekteve që do të financohen në bazë të thirrjes;
  - 2.6. kohëzgjatja e projekteve të financuara;
  - 2.7. dokumentacioni i detyrueshëm dhe jo të detyrueshme për aplikim në kuadër programit apo projektin, duke përfshirë formularët e nevojshëm për aplikim dhe dokumentacionin me të cilin dëshmohet plotësimi i kriterëve ligjore për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike;
  - 2.8. datën e publikimit të thirrjes dhe afatin e fundit për dorëzimin e aplikacioneve;
  - 2.9. adresën dhe mënyrën e paraqitjes së aplikacionit;
  - 2.10. kushtet dhe mënyrën e parashtrimit të pyetjeve në lidhje me thirrjen dhe mënyrën e shpërndarjes dhe publikimit të përgjigjeve në pyetjet e parashtruara;
  - 2.11. kushtet dhe mënyrën e paraqitjes së ankesave;
  - 2.12. informacione mbi kontraktimin e projektit;
  - 2.13. procedura për monitorimin e zbatimit të programit ose projektit, si dhe metoda dhe përmbajtja e raportimit; dhe
3. Udhëzimet e thirrjes mund të korrigjohen apo ndryshohen, por jo më vonë se shtatë (7) ditë pune para afatit të fundit për dorëzimin e aplikacioneve, dhe të gjitha ndryshimet publikohet në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtin vend, si dokument bazë. Në rast të ndryshimeve të tilla, duhet të shpjegohen arsyet e ndryshimeve të tilla dhe të bëhen publike në të njëjtën mënyrë sikurse thirrja publike.
4. Korrigjimet apo ndryshimet nga paragrafi 3 i këtij neni nuk mund të jenë në dëm të aplikantëve të cilët kanë aplikuar deri në datën e publikimit të korrigjimeve të tilla. Nëse ka korrigjime të tilla, aplikantëve duhet t'u jepet mundësia të korrigjojnë aplikacionin e tyre apo të sigurojnë dokumentacion shtesë.

### **Neni 13**

#### **Mënyra e aplikimit**

1. Dokumentacioni që duhet dorëzuar dhe formati i tij specifikohet me udhëzimet e thirrjes publike, në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje.
2. Aplikacionet mund të pranohen edhe përmes platformave elektronike, me kusht që të sigurojnë konfidencialitetin dhe pacenueshmërinë e aplikacioneve që pranohen.
3. Në momentin e hapjes së thirrjes publike, duhet të përcaktohet adresa e saktë ku duhet të dorëzohet aplikacioni, si dhe datën e fillimit dhe mbarimit të pranimit të aplikacioneve.

### **KRITERET DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT TË APLIKACIONEVE**

#### **Neni 14**

##### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe vendimmarrja**

1. Komisioni Vlerësues ka këto detyra dhe përgjegjësi:
  - 1.1. të vlerësojë aplikacionet nga aspekti procedural sipas procedurës së përcaktuar me këtë Rregullore dhe të vendos nëse aplikantët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të parapara me dispozitat e kësaj Rregulloreje, për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike;
  - 1.2. të shqyrtojë dhe vlerësojë aplikacionet/propozimet e aplikantëve të kualifikuara për mbështetje financiare nga aspekti përmbajtjesor, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Rregullore dhe në thirrjen publike;
  - 1.3. të sigurojë që projektet/programet e përzgjedhura për mbështetje financiare i plotësojnë të gjitha kriteret e thirrjes publike, dhe i kontribuojnë arritjes së prioritetëve dhe objektivave të thirrjes;
  - 1.4. të kërkojë dokumentacion shtesë të nevojshëm nga aplikuesit pas publikimit të listës paraprake të përfituesve dhe para nënshkrimit të kontratës; dhe
  - 1.5. të përzgjedh përfituesit e mbështetjes financiare sipas thirrjes publike.
2. Secili nga anëtarët e Komisionit Vlerësues, para se të bëjë vlerësimin nënshkruan deklaratën mbi paanshmërinë dhe konfidencialitetin në vendimmarrje.
3. Në përfundim të procesit të vlerësimit Komisioni Vlerësues nxjerr vendim me shkrim me të cilin përcaktohen aplikantët e kualifikuar të cilët përfitojnë mbështetje financiare, sipas renditje së pikëve.
4. Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues.
5. Vendimet e Komisionit Vlerësues lidhur me përfituesit e mbështetjes financiare publikohen në faqen elektronike të komunës brenda shtatë (7) ditëve nga marrja e vendimit.
6. Komisioni Vlerësues mban procesverbal për gjithë procesin e vlerësimit të aplikacioneve që nga procesi i hapjes së aplikacioneve deri tek marrja e vendimit. Me kërkesë të palëve të interesit, Komisioni mund të hartoj dhe të dërgojë një raport përmbledhës për gjithë procesin e vlerësimit.

## **Neni 15**

### **Vlerësimi i aplikacionit nga aspekti procedural**

1. Brenda pesë (5) ditëve nga data e mbylljes së thirrjes publike, Komisioni Vlerësues bën hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni, nëse ato i plotësojnë kriteret formale duke përfshirë kriteret për kualifikim të aplikantëve për mbështetje publike financiare sipas neneve të kësaj Rregulloreje.
2. Vetëm aplikacionet të cilat i plotësojnë kriteret e parapara me nenet e kësaj Rregulloreje dhe kriteret e thirrjes publike vlerësohen nga Komisioni Vlerësues.

## **Neni 16**

### **Vlerësimi i aplikacioneve nga aspekti përmbajtjesor**

1. Me rastin e vlerësimit duhet të përdoren kriteret e njëjta uniforme për të vlerësuar aplikacionet e dorëzuara për secilën thirrje publike, duke i marrë parasysh kushtet dhe kriteret e përcaktuara me thirrjen publike.
2. Në rast se numri i aplikantëve është më i madh se sa numri i paraparë i përfituesve për atë thirrje, aplikantët me më shumë pikë do të jenë përfitues.
3. Kriteret për vlerësimin e aplikacionit duhet të bëhen publike paraprakisht si pjesë e udhëzimeve për aplikantët.

## **Neni 17**

### **Parandalimi i konfliktit të interesit**

1. Me rastin e përzgjedhjes së përfituesve, duhet të sigurohet që të mos ekzistojë konflikt i interesit i përcaktuar me legjislacionin në fuqi.
2. Duhet të sigurohet shmangia e çfarëdo konflikti të interesit me rastin e marrjes së vendimit për aplikacionet.
3. Anëtarët e emëruar të Komisionit Vlerësues, përkatësisht të Komisionit të Ankesave duhet paraprakisht të sigurohen që pjesëmarrja e tyre në këto komisione është në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, duke nënshkruar një deklaratë me të cilën deklarojnë se nuk ekziston konflikt i interesit.
4. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtarët duhet të kërkojnë nga udhëheqësi zëvendësimin e tyre.
5. Anëtari rezervë i komisionit zëvendëson anëtarin i cili tërhiqet për shkak të ekzistencës së konfliktit të interesit.

## **Neni 18**

### **Përfundimi i vlerësimeve dhe publikimi i rezultateve**

1. Pas përfundimit të vlerësimeve, rezultatet paraprake të vlerësimit publikohen në faqen elektronike të komunës brenda shtatë (7) ditësh.
2. Në këtë fazë Komisioni Vlerësues ka të drejtë të kërkojë sqarime shtesë nga aplikuesit.
3. Rezultatet paraprake shndërrohen në rezultatet përfundimtare nëse brenda afatit të paraparë me këtë Rregullore nuk paraqitet ndonjë ankesë.

## **Neni 19**

### **Afatet dhe procedurat e paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave**

1. Kundër vendimit të Komisionit Vlerësues aplikantët mund të ushtrojnë ankesë pranë Komisionit të Ankesave, si në vijim:
  - 1.1. . ankesë ndaj vendimit për diskualifikim për shkak të mospërmbushjes së kriterëve formale gjatë vlerësimit të aplikacionit në aspektin procedural; dhe
  - 1.2. ankesë ndaj vendimit për ofrimin apo mosofrimin e mbështetjes financiare;
2. Ankesat duhet të dorëzohen brenda 5 ditësh nga dita e publikimit të vendimit.
3. Komisioni i Ankesave vendos mbi ankesën brenda pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të saj.
4. Komisioni i Ankesave mund të nxjerr vendim për të pranuar ose refuzuar ankesën.
5. Vendimi i Komisionit të Ankesave është vendim përfundimtar në procedurën administrative.
6. Vendimi duhet t'i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe Komisionit Vlerësues.
7. Komisioni i Ankesave mban procesverbal për gjithë procesin e trajtimit të ankesave dhe vendimmarrjes.

## **Neni 20**

### **Kontrata me përfituesin**

1. Komuna lidh kontratë me shkrim me përfituesin mbështetjes financiare brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e mbylljes thirrjes publike.
2. Kontrata me përfituesin përmban:
  - 2.1. detaje lidhur me shumën e financimit, periudhën e zbatimit, monitorimin e zbatimit dhe raportimin për projektin/programin e përfituesit;
  - 2.2. dispozita me të cilat përcaktohet qartë se cili është qëllimi i mbështetjes financiare dhe ndalimin e përdorimit të mjeteve për qëllime tjera;
  - 2.3. dispozita me të cilat obligohet përfituesi që mjetet nga mbështetja financiare t'i shpenzojë përmes transaksioneve bankare në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
  - 2.4. dispozita me të cilat tregohet mënyra dhe afatet e pagesës duke përfshirë shumën në paradhënie;

- 2.5. dispozita me të cilat shmanget konflikti i interesit gjatë shpenzimit të mjeteve nga mbështetja financiare;
- 2.6. dispozita lidhur me rastet kur mund të shkëputet kontrata;
- 2.7. dispozita me të cilat rregullohet kthimi i mjeteve në rast të shkëputjes së kontratës;

**Neni 21**  
**Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen Rregullorja 03/2022 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat, miratuar 27.02.2022 dhe Rregullorja 01/2022 për ndryshim dhe plotësim të Rregullorës 03/2022 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat miratuar 30.06.2022.

**Neni 22**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit të saj në ueb faqen zyrtare të komunës.

**Melihate Basholli Latifi**

---

**Kryesuese i Kuvendit**

## Arsyetim

Drejtoria për bujqësi dhe zhvillim rural, me qëllim të zbatimit të politikave për zhvillimin e bujqësisë dhe bizneseve ka hartuar drfat-rregulloren për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat me të cilën rregullore do të mundësohet përkrahje me cilësore , më transparente dhe gjithëpërfshirëse për fermerët dhe bizneset ne komunën e Vushtrrisë. Me rregulloren 03/2022 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat, miratuar 27.02.2022 dhe Rregullorja 01/2022 për ndryshim dhe plotësim të Rregullorës 03/2022 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat miratuar 30.06.2022, ka pasur vështirësi në implementimin e politikave përkrahëse të komunës kundrejt fermerëve dhe si rrjedhojë është hartuar drafti i ri i rregullores i cili draft ka kaluar të gjitha fazat e parapara me ligjet në fuqi, e ku tani i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.





REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

DATA/DATE:	29.01.2024
NGA/OD/FROM:	Zyra për Informim
PËR/ZA/TO:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
CC:	Melihate Basholli Latifi, Kryesuese e Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti për ecurinë e konsultimit dhe hartimit të Draft-Rregullores për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17. Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me datë 14.11.2023, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë ka formuar komisionin për përgatitjen e Draft-Rregullores për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat. Grupi punues i cili ka punuar në draftin e rregullores:

1. Tefik Maloku, kryesues i komisionit
2. Fatmir Feka, anëtar
3. Liridon Lahu, anëtar



Publikimi i njoftimit dhe rregullores në uebfaqe, platformën e konsultimeve publike, si dhe në rrjetin social facebook të Komunës së Vushtrrisë.

Publikimet:

**Me 26.12.2023**

**Në uebfaqe:**

**Njoftimi:**

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2023/12/Njoftim-per-konsultim-publik-Draft-Rregullore-per-perkrahjen-e-fermereve-ne-bujqesi-dhe-bizneseve-ne-sektorin-privat.pdf>

**Draft-Rregullorja:**

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2023/12/Draft-Rregullore-per-perkrahjen-e-fermereve-ne-bujqesi-dhe-bizneseve-ne-sektorin-privat.pdf>

**Në facebook:**

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=705001071761695&set=a.256978853230588>

**Në platformën e konsultimeve publike:**

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42228>

Me datë 15.01.2024 është ripërsëritur njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik në formë fizike:

**Në uebfaqe:**

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2024/01/Njoftim-per-Konsultim-Publik-1.pdf>

**Në facebook:**

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=710893801172422&set=a.256978846563922>

Lajmi i cili njofton se kur do të mbahet konsultimi publik i publikuar në uebfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/news/njoftim-per-konsultim-publik/>

Me datë 19.01.2024 është mbajtur konsultimi publik, në linkun më poshtë është lajmi për mbajtjen e konsultimit publik:

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/news/mbahet-konsultimi-publik-per-draft-rregulloren-per-perkrahjen-e-fermereve-ne-bujqesi-dhe-bizneseve-ne-sektorin-privat/>

Me datë 23.01.2024 është publikuar procesverbali nga konsultimi publik:

<https://kk.rks-gov.net/vushtri/wp-content/uploads/sites/33/2024/01/Procesverbali-nga-konsultimi-publik-per-Draft-Rregulloren-per-perkrahjen-e-fermerëve-ne-bujqësi-dhe-bizneseve-ne-sektorin-privat.pdf>

Draft-Rregullorja për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë dhe platformën e konsultimeve publike, nga data 26.12.2024 deri më 25.01.2024.

Tabela me të dhëna nga konsultimi publik:

Metoda e konsultimit	Data	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa/sugjerime	Numri i kërkesave të pranuar
1-Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë për Draft-Rregulloren për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat	19.01.2024	F M T 16 22 38	8	8

Nr	Kërkesat/Sugjerimet/Komentet	Kush e ka dhënë kërkesën/sugjerimin	Statusi i kërkesës/sugjerimit (pranuar, pjesërisht i pranuar apo refuzuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe refuzimin e komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. A do të ketë përkrahje për biznese dhe start-UP të cilat udhëhiqen nga gratë	Taibe Krasniqi, qytetare nga fshatin Begaj	Është në kompetencë të qeverisë komunale	Pyetja është e parashtruar jashtë fushës për të cilën është thirr konsultimi publik
2.	1. A ka mundësi që komuna të jep grante në blegtori me theks të veçantë për lopë qumështore	Nagip Shala, qytetar nga fshati Dobërlukë	Është në kompetencë të qeverisë komunale	Pyetja është e parashtruar jashtë fushës për të cilën është thirr konsultimi publik
3.	1. Kemi fermën e dhive dhe kemi nevojë për pajisje me makina për mjelje, a mundet komuna që të na ofrojë mbështetje qoftë	Mihane Mehmeti, qytetare nga fshati Oshlan	Është në kompetencë të qeverisë komunale	Pyetja është e parashtruar jashtë fushës për të cilën është thirr konsultimi publik

	financiare qoftë me pajisje/makina			
4.	1. Shpreh shqetësimin lidhur me aplikimin për subvencione të ministrisë e që aplikimi bëhet në komunë, ku kërkoj të krijohet një rregull më i mirë nga komuna duke mos u krijuar tollovi para sporteve	Avdurrahman Fazliu, qytetar nga fshati Kollë	Kërkesa është pranuar plotësisht	Kërkesa e qytetarit është pranuar plotësisht dhe do të adresohet në Drejtorinë për Administratë
5.	1. Shpreh shqetësimin tim lidhur me aplikimin për grante nga ministria ku po kemi probleme me marrjen e lejes për ndërtimin e stallave, ku kërkohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore e cila po merr shumë kohë	Blerim Kuçi, qytetar nga Vushtrria	Kjo është në përgjegjësi të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	Pyetja është e parashtruar jashtë fushës për të cilën është thirr konsultimi publik
6.	1. Problemi me lejet e ndërtimit për stallat	Bashkim Muli, qytetar nga Vushtrria	Kjo është në përgjegjësi të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	Pyetja është e parashtruar jashtë fushës për të cilën është thirr konsultimi publik
7.	1. Si mund të përfitojmë nga komuna si shoqatë	Sabile Xhaka, qytetare nga fshati Oshlan	Përmes thirrjeve publike	Pyetja është e parashtruar jashtë fushës për të cilën është thirr konsultimi publik
8.	1. Kërkoj të përmirësohet një gabim teknik në nenin 20, paragrafi 1, lidhur me afatin për lidhjen e kontratës në mes përfituesit dhe komunës	Bashkim Gashi, qytetar nga Vushtrria	Kërkesa është pranuar plotësisht	Sugjerimi i qytetarit ka qenë plotësisht i drejt pasi që ka vërejtur një lëshim teknik nga hartuesi i draftit

Shkurtesat: F-Femra, M-Meshkuj, T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik
2. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

Raporti është përgatitur nga:

Mirjeta Duraku-Zyrtare për Informim dhe Monitorim të Mediave

---



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

**Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**  
(Komisioni për hartimin e draftit të rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat)

Datë: 19.01.2024

## Procesverbal

I përpiluar me datë 19.01.2024 me rastin e mbajtjes së diskutimit publik me qytetar lidhur me hartimin e draftit të rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat.

Takimin e hapi dhe e udhëhoqi Tefik Maloku, kryetar i komisionit për hartimin e draftit të rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat.

Te pranishëm në takim ishin 38 pjesëmarrës të cilët shprehen interesimin e tyre lidhur me këtë rregullore e të cilët parashtruan edhe pyetje për këtë çështje.

Taibe Krasniqi nga fshati Begaj pyeti se a do të ketë përkrahje për biznese dhe start ape të cilat udhëhiqen nga gratë.

Nagip Shala nga fshati Dobërllukë pyet se a ka mundësi që komuna të jap grande në blegtori me theks të veçantë lopë qumështore.

Mihasnë Mehmeti nga fshati Oshlan, meqenëse ne kemi fermën e dhive dhe kemi nevojë për pajisje me makina për mjelje, a mundet komuna që të na ofrojë mbështetje qoftë financiare qoftë me pajisje/makina.

Avdurrahman Fazliu nga fshati Kollë shprehu shqetësimin e tij lidhur me aplikimin për subvencione të ministrisë e që aplikimi behet në komune ku kërkoj të krijohet një rregull me i mirë nga komuna duke mos krijuar tollovi para sporteleve.

Blerimi nga Vushtrria shprehu shqetësimin e tij lidhur me aplikimin për grande me ministri ku po kanë problem me marrjen e lejes për ndërtimin e stallave ku kërkohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore e cila po u merr shumë kohë.

Bashkim Muli nga Vushtrria paraqiti problemin e njëjtë lidhur me lejet e ndërtimit për stallat.

Sabile Xhaka nga fshati Oshlan pyet se si mundemi me përfitua nga komuna si shoqatë.


Ndërsa Bashkim Gashi nga Vushtrria ne pamundësi te jete i pranishëm ne takim, përmes telefonit komentoj lidhur me një gabim teknik që është lëshuar nga ana e komisionit në nenin 20 paragrafin 1 lidhur me afatin për lidhjen e kontratës në mes përlituesit dhe komunës.

Sa i përket draft-rregullores nuk pati ndonjë vërejtje apo propozim konkret por pjesëmarrësit më shume ishin të fokusuar se si do te përfitojnë nga fondet publike që ndahen për këto kategori.

Proces mbajtësi Fatmir Feka



Verifikuar nga : Tefik Maloku



Liridon Lahu



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republik of Kosovo  
 Komuna e Vushtrisë  
 Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



**Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**

(Komisioni për hartimin e draftit të rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat)

Datë: 19.01.2024

**Lista e pjesëmarrësve në diskutimin publik**

Nr.	Emri	Mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1	SABILETJARA	GJAKA	OSHLAN	
2	RESMIJE	HUSENI	OSHLAN	
3	Myret	BEQIRI	OSHLAN	
4	MYZAFERE	BEQIRI	OSHLAN	
5	Fakete	Hyseni	OSHLON	
6	Naime Manu		OSHLON	
7	VALBONE RILAND	PLANA	OSHLAN	
8	Sadele	MALI	OSHLAN	Sadele Mali
9	FAIK	MAXHUNI	MAXHUNAJ	
10	BLERIM	KUCI	DALAK	
11	KADRI	SALLANU	VERNICE	
12	Abdurrahman	SALLANU	Verni	
13	Mensur	KUCI	Dalak	
14	SEJDI	KACULLI	PESTOVE	
15	DAUT	SFARRE	ISTUDIMEULI	
16	GJYLAZIN	IBRAHIMI	AKRASHICE	
17	ALI	SALIHU	DRUAR	
18	REBEZ	BILALI	PASCH	
19	ARSIM	GASHI	LUMADA	
20	BESIM	MUSTAFA	REZNIK	
21	Gjime	Imam	Maxhuni	
22	Hamit	Makri	Reznik	
23	NAIM	SHALA	DOBERLLUK	
24	Abdurrahman	FZELI	Kollë	
25	Tadit Hysni	Hysni	Kollë	
26	Marsteje	KALU	DUBOC	
27	Adnan	Kajtazi	OSHLAN	
28	Bejter	HOZI	Dumric	
29	Rofo	Haradinaj	STANOVE	
30	FRAN	BERISHA	SHREKONIC	
31	Shkëlqet	Thojedimaj	Stomociperim	
32	Taribe	Krusmigi	Begaj	









**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



**Për:** KPF-në dhe Kuvendin e Komunës  
**Propozues:** Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës   
**Hartues:** Zyra komunale për komunitete dhe kthim   
**Tema:** Propozim : Plani Lokal i veprimit per avancimin e te drejtave te komuniteteve rom dhe ashkali ne komunën e Vushtrrise 2024-2026

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2 shkronja “d” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nenin 19, paragrafi 1.3 të Statutit të komunës, si dhe Strategjia p137r avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026.Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2024 miraton këtë:

**PLANI LOKAL I VEPRIMIT**  
**PËR AVANSIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE**  
**ROM DHE ASHKALI NË KOMUNËN E VUSHTRRISË**  
**2024-2026**

<b>PËRMBAJTJA</b> .....	Error!
Bookmark not defined.....	3
<b>SHKURTESAT</b> .....	4
<b>1. HYRJE</b> .....	5
1.1. Metodologjia.....	5
<b>2. ANALIZA E GJENDJES</b> .....	6
2.1. Arsimi.....	6
2.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale.....	7
2.3. Shëndetësia.....	8
2.4. Banimi.....	9
2.5. Diskriminimi.....	12
<b>3. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET</b> .....	11
3.1. Arsimi.....	12
3.1.1. Rezultatet e pritshme.....	123
3.1.2. Përshkrimi i aktiviteteve.....	134
3.1.3. Supozimet dhe rreziqet.....	16
3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale.....	17
3.2.1. Rezultatet e pritshme.....	167
3.2.2. Përshkrimi i aktiviteteve.....	18
3.2.3. Supozimet dhe rreziqet.....	20
3.3. Shëndetësia.....	21
3.3.1. Rezultatet e pritshme.....	20
3.3.2. Përshkrimi i aktiviteteve.....	21
3.3.3. Supozimet dhe rreziqet.....	22
3.4. Banimi .....	223
3.4.1. Rezultatet e pritshme.....	23
3.4.2. Përshkrimi i aktiviteteve.....	23
3.4.3. Supozimet dhe rreziqet.....	234
3.5. Diskriminimi.....	25
3.4.1. Rezultatet e pritshme.....	25
3.4.2. Përshkrimi i aktiviteteve.....	235

3.4.3. Supozimet dhe rreziqet.....	236
<b>4. BUXHETI.....</b>	<b>26</b>
<b>5. PLANI I ZBATIMIT .....</b>	<b>28</b>

## SHKURTESAT

<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>DSH</b>	Drejtoria e Shëndetësisë
<b>DMS</b>	Drejtoria e Mirëqenies Sociale
<b>IP</b>	Institucionet Parashkollore
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>OSHC</b>	Organizatrat e Shoqërisë Civile
<b>PLV</b>	Plani Lokal i Veprimit
<b>PRTAN</b>	Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes
<b>QKMF</b>	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
<b>QKUK</b>	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
<b>QM</b>	Qendra Mësimore
<b>QMF</b>	Qendra e Mjekësisë Familjare
<b>QPS</b>	Qendra për Punë Sociale
<b>QAP</b> xd	Qendra e Aftësimi Profesional
<b>IKAP</b>	Institucioni i Kosovës për Administratë Publike
<b>SISH</b>	Sistemi i informimit shëndetësor
<b>SMIA</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
<b>SËOT</b>	Fuqite, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet
<b>ZP</b>	Zyra e Punësimit
<b>ZKKK</b>	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
<b>ZQM</b>	Zyra për Qeverisje të Mirë
<b>ZK</b>	Zyra e Kryeministrit
<b>KKV</b>	Komiteti Komunal Veprues

# 1. HYRJE

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM/ZKM) pranë Zyrës së Kryeministrit, ndërmori iniciativën për hartimin e Strategjisë së re për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Republikën e Kosovës. Pas një procesi të gjatë gjithëpërfshirës dhe konsultimesh me të gjithë aktorët, në korrik të vitit 2022, është aprovuar Strategjia për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026.

Komuna e Vushtrrisë sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 ka 69870 banorë. Sipërfaqja e Komunës së Vushtrrisë është rreth 345 km<sup>2</sup> dhe ka 67 vendbanime.

Sipas statistikave të vitit 2023, nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim ( ZKKK ) në Komunën e Vushtrrise jetojnë 77 familje të komuniteteve rom dhe ashkali, me gjithsej 311 anëtarë. komuniteti rom, ashkali kryesisht jetojnë në zonën rurale dhe urbane.

Për të adresuar problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen komunitetet rom dhe ashkali , Komuna e Vushtrrise, ka iniciuar procesin e hartimit të Planit lokal të veprimit për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali.

Për realizimin e këtij Plani lokal të veprimit, Komuna e Vushtrrise ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për themelimin e Komitetit Komunal Veprues.

## 1.1. Metodologjia

Komuna e Vushtrrisë ka formuar Komitetin Komunal Veprues. Jane zhvilluar takime dhe konsultime për nevojën e hartimit të PVL, është formuar grupi punues dhe është hartuar plani i punës i cili përfshinë dinamikën e draftit dokumentit, konsultimet publike deri në miratim nga Kuvendi i Komunës.

Bazuar në Strategjinë për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026. Ka identifikuar pesë fusha kryesore, të cilat edhe KKV ka vendosur që Plani lokal i Veprimit për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë të ketë këto pesë fusha kryesore:

1. Arsimi,
2. Punësimi dhe përkujdesja sociale,
3. Shëndetësia,
4. Banimi,
5. Diskriminimi.

## 2. ANALIZA E GJENDJES

Bazuar ne vlersimin nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim – ZKKK në komunën e Vushtrrisë jetojnë 89 familje të komuniteteve rom dhe ashkali, me gjithsej 583 anëtarë. 26 familje i përkasin komunitetit ashkali, përkatësisht 97 anëtarë, 55 familje të komunitetit rom, përkatësisht 320 anëtarë.

Sipas evidencave të ZKKK-së numri i nxënësve të përfshirë në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, janë të përfshirë 120 fëmijë.

Numri i familjeve të komunitetit rom,ashkali që janë në asistencë sociale në komunëne e Vushtrrisë është 51 familje me 214 anëtarë.

### 2.1. Arsimi

Në Komunën e Vushtrrisë, përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali në të gjitha nivelet e arsimit, mbetet në nivel jo të kënaqshëm.

Komuna e Vushtrrisë ofron mbështetje për nxënësit e komunitetit rom sidomos ne edukimin jo formal duke mos pasur mundesi që nje mbeshtetje e tille te behet ne kuader te sitemit arsimor te Republikes së Kosovës, ndërsa fëmijët e komunitetit ashkali jane te perfshire në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës.

Analiza SËOT paraqet gjendjen aktuale të arsimit të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë.

**Tabela e analizës SËOT në fushën e Arsimit**

Fuqite / pikat e forta	Dobesite
<ul style="list-style-type: none"><li>• Institucionet arsimore komunale me kapacitete te plota per zhvillimin e arsimit</li><li>• Infrastrukturë dhe hapësira komunale të mjaftueshme për zhvillimin e procesit edukativo arsimor,</li><li>• Baze e mjaftueshme ligjore per zhvillimin e procesit edukativo arsimor</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Mungesa e fushatave informuese për mundësitë e vazhimit të shkollimit</li><li>• Vetëdijësimi i ulët i prindërve të komuniteteve për rëndësinë e shkollimit</li><li>• Mosvazhdimi i shkollimit të mesëm të lartë nga komuniteti rom dhe ashkali</li><li>• Mungese e kuadrit adekuat nga vete komuniteti rom dhe ashkali</li></ul>

Mundesite	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunim i shtuar në mes Ekipeve për mosbraktisje të shkollës</li> <li>• Ndarja e bursave për student të komuniteteve rom dhe ashkali me kritere afirmative</li> <li>• Ndarja e mjeteve financiare / sumvencionim për zhvillimin e edukimit jo formal</li> <li>• Bashkëpunimi me shoqëri civile dhe donatorët për edukimin jo formal të komuniteteve rom dhe ashkali</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndikim i strukturave paralele me ndikim për mos përfshirje në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës</li> <li>• Martesat e hershme</li> <li>• Ndërprerja e shkollimit për shkak të kushteve socio - ekonomike</li> <li>• Puna e detyrueshme në moshe të hershme.</li> </ul>

## 2.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Papunësia në Kosovë sipas të dhënave të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës është 25.9 %. Raportet e fundit të publikuar nga ASK dhe nga hulumtime të ndryshme, tregojnë se shkalla e papunësisë të komunitetëve rom dhe ashkali është shumë më e madhe sesa vlerat në nivel vendi.

Statistikat nga ZKKK-ja tregojnë se gjatë vitit 2017, në institucione publike dhe private janë të punësuar 18 ashkali. Megjithatë, ekziston një diferencë e lartë në mes të numrit të të punësuarve nga komunitetët dhe punëkërkuarëve.

Niveli i lartë i papunësisë së pjesëtarëve të komuniteteve ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në mirëqenien sociale të tyre. Numri i familjeve të komuniteteve rom dhe ashkali që janë përfitues të asistencës sociale është 49 dhe rreth 91 familje që kanë gjendje jo të mirë ekonomike.

Analiza SËOT paraqet gjendjen aktuale në fushën e punësimit dhe kujdesjes sociale të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë.

### Tabela e Analizës SËOT në fushën e punësimit dhe të mirëqenies sociale

Fuqite	Dobesite
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e kekeses per fuqi punetore</li> <li>• Kapacitete institucionale per aftesim profesional</li> <li>• Baze e mjaftueshme ligjire per mundesi te punesimit</li> <li>• Asistenca sociale</li> <li>• Ofrimi i pakove të ndihmave nga Komuna për familjet në nevojë</li> <li>• Fushata për regjistrim civil falas gjatë muajit prill</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri jo i mjaftueshem i ofrimit të trajnimeve për pune</li> <li>• Mungesa e koordinimit të Zyrës së Punësimit me organet tjera komunale</li> <li>• Mosndarja e disa programeve të veçanta për avancimin e komuniteteve</li> <li>• Mundësi të kufizuara për punësim</li> <li>• Mungesa e kuadrove profesionale</li> <li>• Mungesa e buxhetit për shërbimet sociale</li> </ul>
Mundesite	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja e kuadrove për punësim</li> <li>• Ndjekja e kurseve QAP</li> <li>• Bashkëpunim të shtuar me Zyrën e Punësimit dhe QAP</li> <li>• Përfshirja ne pune praktike ne isnstiucionet publike dhe biznese</li> <li>•</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapacitete të limituara të institucioneve për ofrim të shërbimeve te nevojshme</li> <li>• Mos zbatimi i Ligjit të punës</li> <li>• Mungesa e fondeve për ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme në QAP</li> <li>• Mos-planifikimi familjar</li> <li>• Shtimi i numrit të rasteve sociale</li> <li>• Varësia nga ndihmat</li> </ul>

### 2.3. Shëndetësia

Shërbimet shëndetësore në komunën e Vushtrrisë kanë një shtrirje të gjerë dhe mbulojnë mjaft mirë të gjithë territorin e komunës. Drejtoria e Shëndetësisë ka bërë avancime shumë të mira përsa i përket kushteve në QMF dhe kualitetit të shërbimeve

Analiza SËOT paraqet gjendjen aktuale ne fushen e shendetesise të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë.



Tabela e Analizës SËOT në fushën e Shëndetësisë

Fuqite	Dobesite
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapacitete te mjaftueshme per ofrimin e sherbimeve shendetesore</li> <li>• Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shëndetin,</li> <li>• Qasje e lehtë në shërbimet primare të shëndetësisë</li> <li>• Ofrimi i shërbimeve shëndetësore falas për kategorite e caktuara</li> <li>• Vizita shendetesore ne shtepi dhe shkolla</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e barnave nga lista esenciale</li> <li>• Mungesa e SISH (Sistemi i Informimit Shëndetësor) për të siguruar informata të sakta për gjendjen shëndetësore</li> <li>• Nivel jo i kënaqshëm i vaksinimit të fëmijëve nga komunitetet</li> <li>• Edukimi i pamjaftueshëm shëndetësor</li> </ul>
Mundesite	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi i fushatave vetëdijësuese për përmirësimin e edukimit shëndetësor</li> <li>• Ofrimi i sherbimeve shendetsore ne te gjitha institucionet lokale shendetsore pa dallim</li> <li>• Lirimi nga pagesa për familjet në nevojë</li> <li>• Sigurimi i barnave esenciale</li> <li>• Organizimi i kontrollove sistematike për femra (rastet e kancerit të gjirit)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesë buxheti për rastet urgjente</li> <li>• Përhapja e sëmundjeve ngjitëse dhe epidemive</li> </ul>

## 2.4. Banimi

Gjendja në Komunën e Vushtrrisë përsa i përket çështjes së banimit për komunitetet rom dhe ashkali, është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme. Megjithatë, një numër i familjeve kanë probleme me kushte të vështira të banimit, kanë mungesë të pronave për ndërtim të shtëpive, kanë probleme me dokumentacion të pronës.

Analiza SËOT ka nxjerrë edhe disa të dhëna të tjera që janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

**Tabela e Analizës SËOT në fushën e Banimit**

Fuqite	Dobesite
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundesi e pageses per qera te banimit</li> <li>• Rregullimi i infrastrukturës përcjellëse në lagjet ku jetojnë komunitetet</li> <li>• Planifikimi per shurjen e vendbanimeve jo formale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mjete te pa mjaftueshme per pagaesa te qirasë</li> <li>• Buxheti i pamjaftueshëm</li> <li>• Mungese planifikimi te lagjeve formale</li> </ul>
Mundesite	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i shtëpive të reja me ndihmën e donatorëve</li> <li>• Renovimi i shtëpive</li> <li>• Rregullimi i infrastruktures sipas prioriteteve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Migrimi për shkak të mungesë së banimit</li> <li>• Mosrenovimi i shtëpive të vjetra</li> <li>• Ndërtimi i shtëpive në ambiente jo të banueshme</li> </ul>

## 2.5. Diskriminimi

Diskriminimi është prezent në gjithë popullatën, sidomos në aspektin gjinor, por tek komuniteti rom dhe ashkali është më shumë prezent për shkak të përkatësisë së tyre etnike.

Diskriminimi, është një fenomen që është prezent në fushën e arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe banimit.

**Tabela e Analizës SËOT në fushën e Diskriminimit**

Fuqite	Dobesite
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Infrastruktura ligjore ne mbrojtjen ndaj diskriminimit ne pergjithesi</li> <li>• Mekanizma lokal per mbrojtjen ndaj diskriminimit</li> <li>• Rritja e llogaridhënjes dhe ndëshkimit ndaj ushtruesve të diskriminimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mekanizma jo aktiv ne mbrojtjen dhe prmovimin kunder diskriminimit</li> <li>• Buxheti i pamjaftueshëm</li> <li>• Mungese e kapaciteteve trajnuese dhe programeve per mbrojtjen ndaj diskriminimit</li> </ul>
Mundesite	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Forcim i mekanizmave institucional ne mbrojtjen ndaj diskriminimit</li> <li>• Trajnime të vazhdueshme profesionale për zyrtarë publikë kundër diskriminimit</li> <li>• Ngritja e kapaciteteve profesionale në luftimin dhe parandalimin e diskriminimit</li> <li>• Fushata ndërgjegjësuese për dhunën në familje dhe në baza gjinore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mos integrimi ne shoqeri</li> <li>• Rritja dhunes dhe veprimve devijante</li> <li>• Migrimi jashte vendit</li> </ul>

### **3. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET**

Siç është paraqitur në analizën e gjendjes, ky Plan i veprimit do t'i ketë 5 fusha kryesore të bazuara edhe në Strategjinë për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës.

Për secilën nga këto fusha është përcaktuar një objektiv strategjik, ndërsa për çdo objektiv janë përcaktuar rezultatet të cilat do të arrihen duke i zbatuar aktivitetet specifike.

Më poshtë do të paraqiten objektivat strategjike, rezultatet dhe aktivitetet për secilën fushëveprim të Planit të veprimit.

### **3.1. Arsimi**

Ndryshimet në fushën e arsimit janë të domosdoshme për të siguruar një shoqëri kohezive dhe gjithëpërfshirëse. Ky Plan i veprimit parasheh disa aktivitete që do të përmirësojnë arsimin për komunitetet rom dhe ashkali.

#### **Objektivi strategjik 1**

Për të siguruar avancimin dhe rezultate të mira në fushën e arsimit është përcaktuar ky objektivi strategjik:

**Objektivi 1: Rritja dhe ofrimi i qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet rom dhe ashkali.**

#### **3.1.1. Rezultatet e pritshme**

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan veprimi për fushën e arsimit parashihet arritja e rezultateve si në vijim:

- **Rezultati 1.1.** Përmirësohet pjesëmarrja në arsimin parafillor të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali ;
- **Rezultati 1.2.** Përmirësohet pjesëmarrja në arsim fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali;
- **Rezultati 1.3.** Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali .

### 3.1.2. Përshkrimi i aktiviteteve

<b>REZULTATI 1.1:</b>	<b>Përmirësohet pjesëmarrja në arsimin parafillor të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali</b>
<b>AKTIVITETI</b>	<b>PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT</b>
<b>Aktiviteti 1.1.1</b> Organizimi i fushatave vetëdijësuese për regjistrim në edukimin parafillor	<p>ZKKK në bashkëpunim me DKA-në dhe shkollat ku frekuentojnë nxënësit nga komunitetet rom dhe ashkali, për çdo fillimvit shkollor organizon fushatë vetëdijësuese për regjistrim në edukimin parafillor të fëmijëve nga komunitetet rom dhe ashkali.</p> <p>Fushata vetëdijësuese përfshin organizimin e takimeve individuale me familjet e komuniteteve; shpërndarje të informatave për regjistrim. Fushatat organizohen nga shkollat, derisa ZKKK dhe DKA ofrojnë përkrahje për shkollat.</p>
<b>Aktiviteti 1.1.2</b> Subvencionimi i pagesave të çerdhes për rritjen e përfshirjes së komuniteteve rom dhe ashkali	<p>DKA, ZKKK në bashkëpunim me MASHT dhe OJQ do të bëjnë identifikimin e gjithë fëmijëve që mund të regjistrohen në qerdhe dhe DKA/MASHT do të subvencionojnë shkollimin e tyre parafillor.</p> <p>Ky aktivitet ka qëllim zvogëlimin e hendekut në pjesëmarrjen e arsimit parashkollor ndërmjet fëmijëve rom dhe ashkali në komunën e Vushtrrisë .</p>
<b>REZULTATI 1.2:</b>	<b>Përmirësohet pjesëmarrja në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali</b>
<b>AKTIVITETI</b>	<b>PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT</b>
<b>Aktiviteti 1.2.1</b> Organizimi i fushatave vetëdijësuese për regjistrim në edukimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë	<p>ZKKK në bashkëpunim me DKA-në dhe shkollat ku frekuentojnë nxënësit nga komunitetet rom dhe ashkali, për çdo fillimvit shkollor organizon fushatë vetëdijësuese për regjistrim në edukimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të fëmijëve nga komunitetet rom dhe ashkali.</p> <p>Fushata vetëdijësuese përfshin organizimin e takimeve individuale me familjet e komuniteteve; shpërndarje të informatave për regjistrim. Fushatat organizohen nga shkollat, derisa ZKKK dhe DKA ofrojnë përkrahje për shkollat.</p>

<p><b>Aktiviteti 1.2.2</b> Identifikimi i fëmijëve në nevojë dhe sigurimi i mjeteve arsimore</p>	<p>ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe QPS, bëjnë identifikimin e familjeve që kanë gjendje të rëndë ekonomike dhe që kanë fëmijë të moshës së arsimit të detyruar. Fëmijët e identifikuar duhet të pajisen me tekste shkollore së paku një herë në vit.</p> <p>Përveç përkrahjes me tekste shkollore nga Komuna, institucionet përgjegjëse mund të kërkojë edhe ndihmën e donatorëve dhe të bizneseve private për t'i përkrahur këta nxënës me materiale shkollore dhe kushte tjera të mundshme.</p>
<p><b>Aktiviteti 1.2.3</b> Adresohen rastet e braktisjes dhe fëmijëve të riatdhesuar</p>	<p>ZKKK në bashkëpunim me sektorët tjerë në nivel komune, identifikon të gjithë fëmijët që kanë braktisur shkollimin dhe familjet e ri-atdhesuara të cilat kanë fëmijë të moshës shkollore. Pas identifikimit, ZKKK ndërmerret të gjithë hapat për të adresuar në mënyrën më të mirë nevojat e këtyre familjeve.</p> <p>Në rastet e braktisjes, ZKKK dhe DKA aktivizojnë të gjithë mekanizmat për të siguruar vijimin e shkollimit nga nxënësit braktisës.</p> <p>Për rastet e fëmijëve të riatdhesuar, ZKKK krahas përkrahjes që ofron në kuadër të politikave të riatdhesimit, do të ofrojë edhe përkrahje shtesë për fëmijët e moshës shkollore, p.sh. përkrahje për t'u pajisur me dokumentacionin përkatës, përkrahje për të nostrifikuar dokumentet.</p>
<p><b>REZULTATI 1.3:</b></p>	<p>Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali</p>
<p><b>AKTIVITETI</b></p>	<p><b>PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT</b></p>
<p><b>Aktiviteti 1.3.1.</b> Organizohet mësimi plotësues dhe shtesë për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali</p>	<p>DKA në bashkëpunim me ZKKK dhe OJQ-të, organizojnë mësim plotësues dhe shtesë për fëmijët nga komunitetet rom dhe ashkali që kanë rezultate të ulëta të të nxënësve. Bartës kryesor për organizimin e mësimi shtesë mund të jenë OJQ-të, derisa DKA, shkollat dhe ZKKK ofrojnë mbështetje organizative dhe në mobilizimin e donatorëve.</p>
<p><b>Aktiviteti 1.3.2.</b> Organizohet arsimimi jo-formal për fëmijët që kanë vonesa në shkollimin e obliguar</p>	<p>DKA, ZKKK dhe shkollat në bashkëpunim me MASHT dhe OJQ-të, do të bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që kanë vonesa në shkollimin e obliguar.</p> <p>edukimi jo-formal do të aplikohet gjatë viteve të zbatimit të këtij Plani të veprimit, me qëllim të përfshirjes së të gjithë fëmijëve.</p>

	Megjithatë, do të maksimizohen mundësitë që rastet që kanë mundësi, të përfshihen në sistemin e rregullt shkollor.
<b>Aktiviteti 1.3.3.</b> Organizimi i trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve për mësimdhënësit	DKA në bashkëpunim me donatorët dhe me OSHC-të që ofrojnë trajnime të kësaj natyre, organizojnë trajnime periodike kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve për mësimdhënësit që punojnë me fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali.
<b>Aktiviteti 1.3.4.</b> Monitorimi i suksesit dhe qëndrueshmëria e intervenimit	ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe me shkollat monitorojnë suksesin e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali, të cilët janë përfitues të skemave të ndryshme përkrahëse (përfituesit e bursave, përfituesit e pakove shkollore, përfituesit e mësimi intensiv). Hartohet një raport i cili shpërndahet tek sektorët përgjegjës.

### 3.1.3. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 1, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për rritjen e nivelit të përfshirjes, zvogëlimin e rasteve të braktisjeve të shkollimit dhe përmirësimin e suksesit të nxënësve të komuniteteve rom dhe ashkali në arsimin parauniversitar, duke i realizuar aktivitetet e parapara me këtë dokument;
- MASHT tregon përkushtim për përfshirjen në mësim intensiv të fëmijëve nga komunitetet rom dhe ashkali që kanë vonesa në shkollimin e obliguar;
- Mësimdhënësit e trajnuar do të zbatojnë metoda dhe teknika në procesin mësimor për të siguruar një ambient mik për të gjithë fëmijët, pa dallime.

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 1, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Mosgatishmëria e shkollave për të zbatuar politikatat anti diskriminuuese;
- Mungesa e buxhetit nga MASHT për përkrahje të mësimi intensiv;
- Mosgatishmëria e komunitetit për të bashkëpunuar me institucionet për të adresuar problemet e përfshirjes në arsim.

### 3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Gjatë punës për hartimin e këtij Plani të veprimit është konstatuar se përmirësimet në këtë fushë do të kenë ndikim shumë të madh në përmirësimin e mirëqenies sociale, do të motivojë

të rinjtë që t'i kushtojnë më shumë rëndësi shkollimit, rrjedhimisht, shumë probleme të identifikuar në kuadër të këtij Plani do të adresoheshin apo zgjidheshin.

Marrë parasysh rëndësinë që kanë intervenimet në këtë fushë, punësimi dhe mirëqenia sociale është përmbledhur në një objektiv strategjik të Planit, që parasheh ndërmarrjen e disa veprimeve që do të ndikonin në përmirësimin e gjendjes ekonomike-sociale të komuniteteve rom dhe ashkali.

## **Objektivi strategjik 2**

Në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale është përcaktuar ky objektiv strategjik:

**Objektivi 2: Rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, si dhe ulja e varfërisë të komuniteteve rom dhe ashkali.**

### **3.2.1. Rezultatet e pritshme**

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan veprimi për fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale, parashihet arritja e rezultateve si në vijim:

- **Rezultati 2.1.** Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimin profesional;
- **Rezultati 2.2.** Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim, përmes senzibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali si dhe masave stimuluese për punëdhënës;
- **Rezultati 2.3.** Përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali në punësim në institucione publike lokale, sipas kuotave të përcaktuara me ligj.



### 3.2.2. Përshkrimi i aktiviteteve

<b>REZULTATI 2.1:</b>	Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimin profesional
<b>AKTIVITETI</b>	<b>PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT</b>
<b>Aktiviteti 2.1.1</b> Identifikimi i fuqisë punëtore nga komunitetet rom dhe ashkali dhe ofrimi i këshillave për punësim	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimin bën identifikimin e fuqisë punëtore nga komunitetet rom dhe ashkali (i të papunëve dhe punëkërkuësve). Në bazë të nevojës harton plane përkrahëse këshilluese. ZKKK ndërmjetëson në raste të ndryshme, me qëllim të rritjes së punësimin të përfaqësuesve të komuniteteve.
<b>Aktiviteti 2.1.2</b> Ofrimi i trajnimeve profesionale nga QAP për punëkërkuësit	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimin dhe në koordinim të ngushtë me Qendrat për Aftësim Profesional, duke u bazuar në nevojat e punëkërkuësve nga komunitetet rom dhe ashkali, harton plane për përfshirjen në trajnime për aftësim profesional.  Organizimi i trajnimeve mund të bëhet duke i përfshirë përfituesit potencialë në programe të ndryshme që janë duke u zbatuar nga USAID, GIZ etj.
<b>Aktiviteti 2.1.3</b> Monitorimi i rasteve të dhunës së grave dhe fëmijëve në familje, në strehimoren rehabilituese	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimin, OJQ-të monitorojnë dhe raportojnë në vazhdimësi tek autoritet për rastet e viktimitave të dhunës në familje.
<b>Aktiviteti 2.1.4</b> Identifikimi i familjeve që janë në asistencë sociale, dhe familjeve të cenueshme, ofrimi i ndihmave	ZKKK në bashkëpunim me QPS-të do të bëjë identifikimin e familjeve me asistencë sociale, ZKKK do të shpërndajë pako me material ushqimorë dhe higjienik për këto familje.

me pako ushqimore dhe higjienike	
<b>REZULTATI 2.2:</b>	Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim përmes senzibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali, si dhe masave stimuluese për punëdhënës.
<b>AKTIVITETI</b>	<b>PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT</b>
<b>Aktiviteti 2.2.1</b> Subvencionimi i bizneseve private për stimulim të punësimit të komuniteteve	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit, identifikon bizneset private që janë duke kërkuar fuqi punëtore. Në bashkëpunim me secilin biznes (aty ku ka gatishmëri dhe interesim) hartohet plani për punësimin e punëkërkuar nga komunitetet. Ky plan parasheh edhe subvencionimin nga ana e Komunës / ZKKK për biznesin.  ZKKK duhet të luaj rol koordinues në zbatimin e këtij aktiviteti përmes bashkërendimit të punëve me të gjitha drejtoritë përkatëse të Komunës, ZQM, ministritë e linjës dhe komunitetin e donatorëve.
<b>Aktiviteti 2.2.2</b> Parandalimi i punëve të rënda dhe mbrojtja e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali	Rastet e shumta të shfrytëzimit të fëmijëve qoftë për punë të rënda apo edhe shfrytëzimit të tyre për të kërkuar lëmoshë, obligojnë institucionet lokale që të zbatojnë masa për parandalimin e keqpërdorimit të fëmijëve.  ZKKK do të ketë rol monitorues dhe mobilizues për të njoftuar institucionet dhe mekanizmat tjerë, në mënyrë që të parandalohet çdo keqpërdorim i fëmijëve të komuniteteve qoftë nga familja, apo grupet tjera të interesit.
<b>Aktiviteti 2.2.3</b> Koordinim i shtuar në mes sektorëve komunal për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale	ZKKK do të themelojë një mekanizëm komunal ndërsektorial që do të ketë për mandat koordinimin e të gjithë akterëve për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim.  Në këtë mekanizëm do të bëjnë pjesë: ZKKK (koordinator), DSH, DMS, QPS, Zyra e punësimit, DKA, OJQ-të, bizneset etj. Varësisht nga nevojat, ky mekanizëm mund të zgjerohet edhe me përfaqësues nga palët me interes.
<b>Aktiviteti 2.2.4</b> Organizim i takimeve periodike për	ZKKK si koordinatore e Grupit koordinues, do të organizojë takime periodike për të siguruar ndërmarrjen e të gjithë hapave të

koordinim në mes të sektorëve	nevojshëm për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale.
<b>REZULTATI 2.3:</b>	<b>Përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali në punësim në institucione publike qendrore dhe lokale, sipas kuotave të përcaktuara me ligj.</b>
<b>AKTIVITETI</b>	<b>PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT</b>
<b>Aktiviteti 2.2.1</b> Fushatë informuese dhe avokuese për respektim të kuotës së punësimit për komunitetet	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit, dhe me përkrahjen e OSHC-ve dhe donatorëve të ndryshëm, organizojnë fushatë avokuese në nivel komunal për të avancuar zbatimin e kuotës së punësimit për komunitetet rom dhe ashkali.  Kjo fushatë do të koordinohet nga ZKKK dhe ka për qëllim informimin e të gjitha institucioneve në nivel komune, bizneseve, punëdhënësve potencialë, por edhe publikut në përgjithësi për kuotat e përcaktuara me ligj për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve.

### 3.2.3. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 2 të paraparë me këtë dokument, janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë dokument;
- Bizneset tregojnë gatishmëri për të punësuar pjesëtarë nga komunitetet rom dhe ashkali.

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 2 të paraparë me këtë dokument, janë:

- Mungesa e angazhimit dhe përkushtimit të palëve të përfshira për të marrë përgjegjësitë që dalin nga ky Plan;
- Mungesa e bashkëpunimit nga bizneset përfituese të subvencioneve;
- Mungesa e bashkëpunimit nga vetë pjesëtarët e komuniteteve.

### 3.3. Shëndetësia

Edhe përkundër shumë intervenimeve që janë bërë në përmirësimin e shëndetit të komuniteteve rom dhe ashkali në komunën e Vushtrisë, ka nevojë të intervenohet në disa aspekte.

Marrë parasysh rëndësinë që kanë intervenimet në këtë fushë, ky Plan parasheh ndërmarrjen e disa veprimeve që do të ndikonin në përmirësimin e gjendjes së shëndetit të komuniteteve rom dhe ashkali.

#### Objektivi strategjik 3

Në fushën e shëndetësisë është përcaktuar ky objektivi strategjik:

**Objektivi 3: Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komunitetit rom dhe ashkali dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore.**

#### 3.3.1. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan veprimi për fushën e shëndetësisë, parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 3.1.** Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore cilësore për komunitetet rom dhe ashkali;
- **Rezultati 3.2.** Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të shëndetit;
- **Rezultati 3.3** Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik për trajtim të barabartë dhe eliminim të diskriminimit të komuniteteve rom dhe ashkali.

#### 3.3.2. Përshkrimi i aktiviteteve

REZULTATI 3.1:	Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për komunitetet rom dhe ashkali
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
<b>Aktiviteti 3.1.1</b> Organizimi i vizitave periodike shëndetësore në familjet e komuniteteve nga QKMF	Rritja e besueshmërisë së familjeve të komuniteteve, veçmas fëmijëve, në raport me institucionet shëndetësore dhe familjarizimi me to, do të ndikonte në ngritjen e vetëdijes së pjesëtarëve të komuniteteve për të shfrytëzuar këto shërbime.  QKMF me përkrahjen e DSHMS dhe ZKKK, organizon vizita periodike në familjet e komuniteteve rom dhe ashkali. Qëllimi i vizitave do të jetë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë nevojtarët, dhe

	në të njëjtën kohë edhe informimi i familjeve për rëndësinë e përkujdesjes ndaj shëndetit.
<b>Aktiviteti 3.1.2</b> Identifikimi i fëmijëve të pa imunizuar dhe imunizimi i tyre	ZKKK në bashkëpunim me DSHMS bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që nuk iu kanë nënshtruar procesit të imunizimit.  Pas identifikimit të tyre, përmes vizitave familjare, apo edhe përmes organizimit të vizitave kolektive në lokacione të caktuara, bëhet imunizimi i tyre.  Ky aktivitet mund të organizohet në bashkëpunim me OJQ-të apo edhe me institucionet arsimore.
<b>REZULTATI 3.2:</b>	<b>Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali, përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të shëndetit</b>
<b>AKTIVITETI</b>	<b>PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT</b>
<b>Aktiviteti 3.2.1</b> Organizimi i ligjëratave rreth edukimit shëndetësor dhe planifikimit familjar	DSH në koordinim të ngushtë QKMF dhe QMF, duhet të organizojnë ligjëratat të strukturuar rreth edukimit shëndetësor për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali.  Vend të rëndësishëm gjatë këtyre ligjëratave duhet të zë edhe çështja e planifikimit familjar. Për të realizuar këto ligjëratat, DSH do të bashkëpunojë edhe me OJQ-të lokale që punojnë në këtë fushë, por edhe me udhëheqësit e lagjeve, përkatësisht përfaqësuesit e komunitetit.
<b>Aktiviteti 3.2.2</b> Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shërbimet që ofrojnë QMF	QKMF dhe QMF në bashkëpunim edhe me OSHC-të, duhet të organizojnë fushatave vetëdijësuese, ku target do të jenë familjet nga komunitetet rom dhe ashkali, me qëllim të informimit të tyre për shërbimet që ofrohen në QMF.
<b>Aktiviteti 3.2.3</b> Organizimi i vizitave periodike për mamografi – ne koordinim me ZKKK	DSH në bashkëpunim me ZKKK dhe MSh/QKUK organizojnë vizita periodike për mamografi. Kjo mund të realizohet duke i organizuar këto vizita në QKMF apo edhe duke i organizuar vizitat në komunitet përmes Mamografit mobil që menaxhohet nga MSH-ja.
<b>REZULTATI 3.3:</b>	<b>Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik për trajtim të</b>

	barabartë dhe eliminim të diskriminimit të komuniteteve rom dhe ashkali
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 3.3.1 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për ndërgjegjësimin e stafit shëndetësor për trajtim të barabartë të pacientëve	DSH në koordinim të ngushtë me QKMF-në dhe QMF-të, duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese për stafin shëndetësor që komunitetet rom dhe ashkali të trajtohen barabartë dhe pa asnjë diskriminim gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

### 3.3.3. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 3, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë plan;
- Gatishmëria e familjeve për të vazhduar ciklin e imunizimit të fëmijëve.

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 3, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Mungesa e angazhimit dhe përkushtimit të palëve të përfshira për të marrë përgjegjësitë që dalin nga ky plan;
- Mosgatishmëria e stafit të QKMF/QMF për të zhvilluar vizitat në terren.

### 3.4. Banimi

Kthimi dhe riatdhesimi i familjeve nga komunitet rom dhe ashkali mund ta vështirësoj dhe thelloj problematikën e vendbanimeve. Migrimi i shumë familjeve në fillimin e vitit 2014, ku shumë familje kanë shitur shtëpitë e tyre për të kërkuar jetë më të mirë në vendet e perëndimit, e ka thelluar dukshëm mungesën e vendbanimeve, sidomos pas kthimit të tyre.

Për të adresuar sa më mirë këtë çështje, Komuna e Vushtrrisë duhet të ndër marrë masa dhe veprime konkrete. Të gjitha këto masa dhe veprime janë përmbledhur në objektivin e katërt të këtij Plani.

#### Objektiva strategjike 4

Për të siguruar adresim të mirëfilltë të sfidave të renditura më lart në fushën e banimit, është përcaktuar ky objektivi strategjik:

**Objektivi 4: Rritja e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike për komunitetet rom dhe ashkali.**

### 3.4.1. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan veprimi për fushën e banimit parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 4.1.** Janë identifikuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve për banim adekuat dhe banim social

### 3.4.2. Përshkrimi i aktiviteteve

REZULTATI 4.1:	Janë identifikuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali për banim adekuat
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
<b>Aktiviteti 4.1.1</b> Hartimi i databazës së familjeve të pastrehë / familjeve në nevojë për banim	ZKKK në bashkëpunim me Komitetin për Komunitete dhe në koordinim me përfaqësuesit e komuniteteve rom dhe ashkali, bënë identifikimin e të gjitha familjeve të pastrehë apo që kanë nevojë për banim.  Të dhënat e detajuara për secilën familje do të futen në një databazë, e cila do të shfrytëzohet edhe nga institucione tjera komunale. Hartimi i kësaj databaze duhet të jetë një proces i vazhdueshëm për shkak të lëvizjeve të mëdha që ndodhin, më konkretisht, për shkak të ndërrimit të vendbanimeve nga familjet, riatdhesimin e familjeve, apo për shkak të paraqitjes së rasteve të reja për banim.

### 3.4.3. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 4 të paraparë me këtë dokument, janë:

- Institucionet qendrore të Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë përkrahin Komunën e Vushtrrisë për ndërtimin / renovimin e shtëpive për familjet e pastreha të komuniteteve rom dhe ashkali, në përputhje me masat dhe aktivitetet e parapara në "Strategjinë për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022 - 2026".

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 4, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Mosndarja e buxhetit nga institucionet qendrore të Kosovës dhe nga donatorët, siç parashihet në “Strategjinë për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022 - 2026”.

### 3.5. Diskriminimi

Diskriminimi në bazë të etnisë për komunitetet rom dhe ashkali është shkaktar i shumëfishtë i problemeve të këtyre komuniteteve dhe konsiderohet hendek kryesor i integritit të këtyre komuniteteve në shoqëri dhe ekonomi.

Për të adresuar sa më mirë këtë çështje, Komuna e Vushtrrisë duhet të ndërmarrë masa dhe veprime konkrete. Të gjitha këto masa dhe veprime janë përmbledhur në objektivin e katërt të këtij Plani.

#### Objektivi strategjik 5

Për të siguruar adresim të mirëfilltë të sfidave të renditura më lart në fushën e diskriminimit, është përcaktuar ky objektivi strategjik:

**Objektivi 5: Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjytimeve, stereotipeve dhe bullizmit.**

#### 3.5.1. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan veprimi për fushën e diskriminimit, parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 5.1.**

#### 3.5.2. Përshkrimi i aktiviteteve

<b>REZULTATI 5.1:</b>	<b>Luftimi i diskriminimit dhe racizmit në mënyrë sistematike përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave, programeve dhe projekteve</b>
<b>AKTIVITETI</b>	<b>PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT</b>



<p><b>Aktiviteti 5.1.1</b> Promovimi i platformës nacionale për mbrojtje nga diskriminimi ndaj komuniteteve rom dhe ashkali</p>	<p>Platforma për raportimin e rasteve të diskriminimit është një platformë e cila ju mundeson komuniteteve rom dhe ashkali të raportojnë antigjipsizmin si: diskriminimin, segregimin, gjuhën e urrejtjes, krimet e urrejtjes, stereotipet, paragjykimet. Është një mjet që i shërben grupit teknik për mbrojtje nga diskriminimi, e themeluar nga <b>ZK-ja</b>, për të trajtuar ankesat/rastet e diskriminimit ndaj komuniteteve rom dhe ashkali.</p> <p>Komuna jone angazhohet ne promovimin e platformës përmes vendosjes së posterëve të platformës (me QR kod) në sportelet e Komunes, vendosja e linkut të platformës në ueb-faqen e Komunes, shpërndarja e broshurave informuese, si dhe promovimi i storjeve të suksesit. Gjithashtu, do të organizohen edhe sesione informuese mbi platformën dhe mënyrën e përdorimit të saj.</p>
<p><b>Aktiviteti 5.1.2</b> Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve publik për mos diskriminimin racor</p>	<p>Komuna e Vushtrrise në bashkëpunim me Institutin e Kosovës per Administratë Publike dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë, do të hartohet një modul të trajnimit të trajnerëve për mos diskriminimin racor . Trajnerët e rinj do të trajnojnë zyrtarët publik nga gjithë Kosova, përfshirë zyrtarët publikë që punojnë në institucione të ndryshme në Komunën e Vushtrrisë.</p>
<p><b>Aktiviteti 5.1.3</b> Ngritja e kapaciteteve te mediave te gazetareve mos diskriminimin racor</p>	<p>Në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë, do të hartohet një modul i trajnimit të trajnerëve mos diskriminimin racor. Trajnerët do të trajnojnë gazetarët për mos diskriminimin racor dhe raportimin e përgjegjshëm etik.</p>

### 3.5.3. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 5, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë dokument;
- Institucionet të tregojnë gatishmëri për të bashkëpunuar.

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 5, të paraparë me këtë dokument, janë:

- Mungesa e angazhimit dhe përkushtimit të palëve të përfshira për të marrë përgjegjësitë që dalin nga ky Plan;
- Mungesa e bashkëpunimit nga vetë pjesëtarët e komuniteteve.

## 4. BUXHETI

Plani lokal i veprimit për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2024 - 2026”, parashihet që për periudhën trrvjeçare të zbatimit të ketë një buxhet total prej 43,634.40 euro (€), prej të cilave 40,034.40 € parashihen të mbuloen nga buxheti i Komunës, ndërsa 3,600.00 € parashihen të mbuloen nga donatorët e ndryshëm.

Në vijim është buxheti i detajuar për 3 vite i këtij Plani të veprimit, i ndarë sipas fushave, sipas viteve dhe sipas burimeve të financimit (i shprehur në euro).

Fusha	Burimi i financimit	Viti			Total €
		2024	2025	2026	
<b>1. Arsimi</b>	Buxheti i Komunës	7,844.80	7,844.80	7,844.80	23,654.40
	Donatorët	400.00	500.00	500.00	1,400.00
	<b>Total</b>	<b>8,244.80</b>	<b>8,344.80</b>	<b>8,344.80</b>	<b>25,054.40</b>
<b>2. Punësimi dhe mirëqenia</b>	Buxheti i Komunës	5,500.00	5,500.00	5,500.00	16,500.00
	Donatorët	200.00	200.00	200.00	600.00
	<b>Total</b>	<b>5,700.00</b>	<b>5,700.00</b>	<b>5,700.00</b>	<b>17,100.00</b>
<b>3. Shëndetësia</b>	Buxheti i Komunës	0.00	0.00	0.00	0.00
	Donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00
	<b>Total</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>4. Banimi</b>	Buxheti i Komunës	0.00	0.00	0.00	0.00
	Donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00

	<b>Total</b>	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>5.Dsikrlminlmi</b>	Buxheti i Komunës	0.00	0.00	0.00	0.00
	Donatorët	1,000.00	1,000.00	1,000.00	3,000.00
	<b>Total</b>	0.00	0.00	0.00	3,000.00
<b>Totali i buxhetit për të gjitha fushat</b>	Buxheti i Komunës	13,344.80	13,344.80	13,344.80	40,034.40
	Donatorët	1,200.00	1,200.00	1,200.00	3,600.00
	<b>Total</b>	14,544.80	14,544.80	14,544.80	43,634.40

Siç mund të shihet nga Plani i zbatimit, ku paraqitet buxheti i detajuar për secilin aktivitetet të paraparë në kuadër të këtij plani të veprimit, i ndarë sipas fushave, sipas viteve dhe sipas burimeve të financimit, i shprehur në euro, shumë aktivitete të këtij Plani nuk kanë kosto financiare, për arsye se ato zbatohen nga institucionet lokale, në kuadër të përgjegjësiive të punës.

Po ashtu, në Plan nuk janë përfshirë aktivitete të cilat kanë filluar më herët dhe vazhdojnë të zbatohet nga Komuna, OSHC-të apo donatorët.

## **5. PLANI I ZBATIMIT**

### **PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR AVANSIMIN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË KOMUNËN E VUSHTRISË**

# 2024 - 2026

Fusha: ARSIMI

Objektiv  
i 1:

Rritja efektive e ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet rom dhe ashkali.

Rezultati 1.1							Përmirësohet pjesëmarrja në arsimin parafillor të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali				
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/ organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	BUXHETI (EURO-€)			
								2024	2025	2026	Totali
1.1.1	Organizimi i fshatave vetëdijëse për regjistrim në edukimin parafillor	ZKKK në bashkëpunim me DKA-në dhe shkollat ku frekuentojnë nxënësit nga komunitetet rom dhe ashkali, për çdo fillimvit shkollor organizon fshatë vetëdijëse për regjistrim në edukimin parashkollor të fëmijëve nga komunitetet rom dhe ashkali. Fushata vetëdijëse përfshin organizimin e takimeve individuale me familjet e komuniteteve; shpërndarje të informatave për regjistrim. Fushatat organizohen nga shkollat, derisa ZKKK dhe DKA ofrojnë përkrahje për shkollat.	2024 - 2026	DKA, ZKKK, shkollat	OJQ-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	-	
1.1.2	Subvencionimi i pagesave të çerdes për rritjen e përfshirjes së komuniteteve rom dhe ashkali	DKA, ZKKK në bashkëpunim me MASHT dhe OJQ-të, do të bëjnë identifikimin e gjithë fëmijëve që mund të regjistrohen në çerdhe dhe DKA/MASHT do të subvencionojnë shkollimin e tyre parafillor. Ky aktivitet ka qëllim zvogëlimin e hendekut në pjesëmarrjen e arsimit parashkollor ndërmjet fëmijëve rom dhe ashkali të Vushtrrisë dhe populates së përgjithshme.	2024 - 2026	DKA, ZKKK, shkollat	MASHT, DKA	Subvencionim deri në 70 € Supozohet deri në 7 fëmijë në vit	Komuna	5,880.00 €	5,880.00 €	20,580.00 €	
Nën-Totali 1.1								5,880.00 €	5,880.00 €	5,880.00 €	20,580.00 €

Rezultati											
1.2. Përmirësohet pjesëmarrja në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali											
Kodi	Aktiviteti	Përkrahimi i Aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përkrahimi i kostos	Burimi i financimit	2024	2025	2026	Totali
1.2.1	Organizimi i fushatave vetëdijësuese për regjistrim në edukimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë	ZKKK në bashkëpunim me DKA-në dhe shkollat ku frekuentojnë nxënësit nga komunitetet rom dhe ashkali, për çdo fillimvit shkollor organizon fushatë vetëdijësuese për regjistrim në edukimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të fëmijëve nga komunitetet rom dhe ashkali. Fushata vetëdijësuese përfshin organizimin e takimeve individuale me familjet e komuniteteve; shpërndarje të informatave për regjistrim. Fushatat organizohen nga shkollat, derisa ZKKK dhe DKA ofrojnë përkrahje për shkollat.	2024 – 2026	DKA, ZKKK, shkollat	OJQ-të, Donatorët	Mbështetja financiare nga TDH për vitin 2024	TDH	/	/	/	-
1.2.2	Identifikimi i fëmijëve në nevojë dhe sigurimi i njeteve arsimore	ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe QPS, bëjnë identifikimin e familjeve që kanë gjendje të rëndë ekonomike dhe që kanë fëmijë të moshës së arsimit të detyruar. Fëmijët e identifikuar duhet të pajisen me pako shkollore, së paku një herë në vit. Përveç përkrahjes me pako shkollore nga vet Komuna, institucionet përgjegjëse mund të kërkojë edhe ndihmën e donatorëve dhe të bizneseve private për t'i përkrahur këta nxënësit me pako shkollore apo edhe me veshmbathje.	2024 – 2026	DKA, ZKKK	DSHMS, OPS, Donatorët	Për çdo vit shpërndahen pako shkollore për nxënësit	Komuna	1,964.8	1,964.8	1,964.8	7,859.2

1.2.2	Adresohen rastet e braktisjes dhe fëmijëve të ri-atdhesuar	<p>ZKKK në bashkëpunim me sektorët tjerë në nivel komune, identifikon të gjithë fëmijët që kanë braktisur shkollimin dhe familjet e riatdhesuara të cilat kanë fëmijë të moshës shkollore. Pas identifikimit, ZKKK ndërmerr të gjithë hapat për të adresuar në mënyrën më të mirë nevojat e këtyre familjeve.</p> <p>Në rastet e braktisjes, ZKKK dhe DKA aktivizojnë të gjithë mekanizmat për të siguruar vijimin e shkollimit nga nxënësit braktisës.</p> <p>Për rastet e fëmijëve të riatdhesuar, ZKKK krahas përkrahjes që ofron në kuadër të politikave të riatdhesimit, do të ofrojë edhe përkrahje shtesë për fëmijët e moshës shkollore, p.sh. përkrahje për t'u pajisur me dokumentacionin përkatës, përkrahje për të nostrifikuar dokumentet.</p>	2024 – 2026	ZKKK	DKA, OIQ-të dhe donatorët	Nuk ka kosto	/	/	/	/	7,859.2						
<b>Nën-Totali 1.2</b>											1,964.8	1,964.8	1,964.8	1,964.8	1,964.8	1,964.8	7,859.2

Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali											
Rezultati	Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/ organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	2024	2025	2026	Totali
1.3											
1.3.1	Organizohet mësimi plotësues dhe shtesë për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali	DKA në bashkëpunim me ZKKK dhe OJQ-të, organizojnë mësim plotësues dhe shtesë për fëmijët nga komunitetet rom dhe ashkali që kanë rezultate të ulëta të të nxënësve. Bartës kryesor për organizimin e mësimi shtesë mund të jenë OJQ-të, derisa DKA, shkollat dhe ZKKK ofrojnë mbështetje organizative dhe në mobilizimin e donatorëve.  Supozohet që në programin e mësimi plotësues dhe shtesë, do të përfshihen 50 fëmijë.	2024 - 2026	DKA, ZKK, Shkollat	OJQ-të, Donatorët	7600 (+5200 shujta ditore per 100 femije)	TDH	/	/	/	-
1.3.2	Organizohet arsimimi joformal për fëmijët që kanë vonesa në shkollimin e obliguar	DKA, ZKKK dhe shkollat, në bashkëpunim MASHT dhe OJQ-të, do të bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që kanë vonesa në shkollimin e obliguar. Duke u bazuar në gjendjen ekzistuese dhe në trendin e kthimit / riatdhesimit të familjeve nga vendet e ndryshme. Supozohet që brenda një viti shkollor rreth 10 fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali do të përfitojnë mësimi intensiv. Komuna e <b>Vushtrrisë</b> do të lirojë nga pagesa të gjithë nxënësit që do t'i nënshtrohen mësimi joformal.  Arsimi joformal do të aplikohet gjatë viteve të zbatimit të këtij Plani të veprimit, me qëllim të përfshirjes së	2024 - 2026	DKA, MASHT	OJQ-të, Donatorët	Komuna do të lirojë nga pagesa	Komuna	/	/	/	-



		të gjithë fëmijëve. Megjithatë, do të maksimizohen mundësitë që rrestet që kanë mundësi, të përfshihen në sistemin e rregullit shkollor.													
1.3.3	Organizimi i trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve për mësimdhënës	DKA në bashkëpunim me donatorët dhe me OSHC-të që ofrojnë trajnime të kësaj natyre, organizojnë trajnime periodike kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve për mësimdhënës që punojnë me fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali. Trajnimet e tilla do t'i përgatisin mësimdhënësit që të krijojnë një ambient miqësor dhe përkrahës për të gjithë fëmijët në klasë, pa kurrfarë dallime. Po ashtu, këto trajnime do të ndihmojnë mësimdhënësit që të krijojnë klasa gjithëpërfshirëse, duke përmbyshur nevojat e të gjithë nxënësve në klasë.	2024 - 2026	DKA, ZKKK	OJQ-të, Donatorët	1,400 € (Ndërtimi i kapaciteteve në politika të mbrojtjes së fëmijëve dhe menaxhimit të rasteve per fëmije ne konflikt me ligjin nën moshen e përgjegjësise penale	TDH	/	/	/	1,400.00 €				
1.3.4	Monitorimi i suksesit dhe qëndrueshmëria e intervenimit	ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe me shkollat monitorojnë suksesin e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali të cilët janë përfitues të skemave të ndryshme përkrahëse (përfituesit e bursave, përfituesit e pakove shkollore, përfituesit e mësimintenziv). Në baza vjetore hartohet një raport, i cili shpërndalet tek sektorët përgjegjës	2024 - 2026	ZKK, DKA	OJQ-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	/	-				
<b>Nën - Totali 1.3</b>												1,400.00 €			
<b>Totali i Objektivit 1:</b>												<b>7,844.80 €</b>	<b>7,844.80 €</b>	<b>7,844.80 €</b>	<b>29,839.20 €</b>

**Fusha: PUNËSIMI DHE MIRËQENIA SOCIALE**

**Objektivi**

**2:** Rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, si dhe ulja e varfërisë të komuniteteve rom dhe ashkali

**Rezultati 2.1** Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimi profesional;

Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/ organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	B U X H E T I (E U R O)		
								2024	2025	2026
2.1.1	Identifikimi i fuqisë punëtore nga komunitetet rom dhe ashkali (i të papunëve dhe punëkërkuësve) dhe ofrimi i këshillave për punësim	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimi bënë identifikimin e fuqisë punëtore nga komunitetet rom dhe ashkali (i të papunëve dhe punëkërkuësve) dhe harton një databazë. Në bazë të nevojës harton plane përkrashë këshilluese. ZKKK ndërmjetëson në raste të ndryshme me qëllim të rritjes së punësimi të përfaqësuesve të komuniteteve.	2024 -2026	ZKKK, Zyra e punësimi	OSHC-të, Donatorët	Nuk ka kosto	/	/	/	-
2.1.2	Ofrimi i trajnimeve profesionale nga QAP për punëkërkuësit	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimi dhe në koordinim të ngushtë me Qendrat për Aftësim Profesional, duke u bazuar në nevojat e punëkërkuësve nga komunitetet rom dhe ashkali, harton plane për përfshirjen në trajnime për aftësim profesional. Organizimi i trajnimeve mund të bëhet duke i përfshirë përftuesit potencialë në programe të ndryshme që janë duke u zbatuar nga USAID, GIZ etj.	2024 - 2026	Komuna	OSHC-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	-

Supozohet që brenda një viti, mund të kemi 10 të interesuar për pjesëmarrje në programin e aftësisimit profesional.													
2.1.3	Monitorimi i rasteve të dhunës së grave dhe fëmijëve në familje, në strehimoren rehabilituese	ZKJK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit, OJQ-të monitorojnë dhe raportojnë në vazhdimësi tek autoritet për rastet e viktimave të dhunës në familje	2024 - 2026	Komuna	OJQ, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	/			
2.1.4	Identifikimi i familjeve që janë në asistencë sociale, dhe familjeve të ceneshme, ofrimi i ndihmave me pako ushqimore, higjienike, dru zjarri dhe pako me dhurata	ZKJK në bashkëpunim me QPS-të do të bëjë identifikimin e familje me asistencë sociale, ZKJK do të shpërndajë pako me material ushqimore, higjienike dhe dru zjarri për këto familje	2024 - 2026	Komuna	Komuna	Shpërndarje e pakove ushqimore 6175 €, higjienike 2,480 €, dru zjarri rreth 30,000 € dhurata per fëmijë 1,250 €	Komuna	39,905.00 €	39,905.00 €	39,905.00 €	159,620.00 €	159,620.00 €	
<b>Nën-Totali 2.1</b>											39,905.00 €	39,905.00 €	159,620.00 €

**Rezultati 2.2 Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim përmes senzibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali, si dhe masave stimuluese për punëdhënës**

Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/ organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	2024	2025	2026	Totali
2.2.1	Subvencionimi i bizneseve private për stimulum të punësimin të komuniteteve	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimin, identifikon bizneset private që janë duke kërkuar fuqi punëtore. Në bashkëpunim me secilin biznes (aty ku ka gatishmëri dhe interesim) hartohet plani për punësimin e punëkërkuësve nga komunitetet. Ky plan parasheh edhe subvencionimin nga ana e Komunës / ZKKK për biznesin. ZKKK duhet të luaj rol koordinues në zbatimin e këtij aktiviteti përmes bashkërendimit të punëve me të gjitha drejtoritë përkatëse të Komunës, ZQM, ministrinë e linjës dhe komunitetin e donatorëve.	2024 - 2026	ZKKK, DShMS	QPS, OShC-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	/	-
2.2.2	Parandalimi i punëve të rënda dhe mbrojtja e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali	Rastet e shumta të shfrytëzimit të fëmijëve, qoftë për punë të rënda apo edhe shfrytëzimit të tyre për të kërkuar lëmshë, obligojnë institucionet lokale që të zbatojnë masa për parandalimin e keqpërdorimit të fëmijëve. ZKKK do të ketë rol monitorues dhe mobilizues për të njoftuar institucionet dhe mekanizmat tjerë, në mënyrë që të parandalohet çdo keqpërdorim i fëmijëve të komuniteteve qoftë nga	2024 - 2026	ZKKK, DShMS	OShC-të, Donatorët	4,350 (Aktivitete e kampanja vetedijesuese per rreziqet e fëmijëve nga punët e rënda, kerkim lëmshë në rrugë.	TDH	/	/	/	4,350.00 €



## Rezultati

2.3

## Përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali në punësim në institucione publike qendrore dhe lokale, sipas kuotave të përcaktuara nga ligji

Kodi	Aktiviteti	Përkrahimi i aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/ organizata mbështetëse	Përkrahimi i kostos	Burimi i financimit	2024	2025	2026	Totali
2.2.5	Fushatë informuese dhe avokuese për respektim të kuotës së punësimin për komunitetet	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimin si dhe me përkrahjen e OSHC-ve dhe donatorëve të ndryshëm, organizojnë fushatë avokuese në nivel komunal, për të avancuar zbatimin e kuotës së punësimin për komunitetet rom dhe ashkali.	2018 – 2019	ZKKK, DShMS	QPS, OSHC-të, Donatorët	Nuk ka kosto	/	/	/	-	-

e pjesëtarëve të komuniteteve.										
Nën-Totali 2.2										

Totali i Objektivit 2:		39.905.00€	39.905.00€	39.905.00€	39.905.00€	163,970.00€
------------------------	--	------------	------------	------------	------------	-------------

Fusha: SHËNDETËSIA

Objektivi

3: Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komunitet rom dhe askali dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbime ciësore shëndetësore

Rezultati 3.1	Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore cilësore për komunitet rom dhe askali						B U X H E T I (EURO)					
	Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/ organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	2024	2025	2026	Totali
3.1.1	Organizimi i vizitave periodike shëndetësore në familjet e komuniteteve nga QKMF	Rritja e besueshmërisë së familjeve të komuniteteve, veçmas fëmijëve, në raport me institucionet shëndetësore dhe familjarizimi me to, do të ndikonte në ngritjen e vetëdijes së pjesëtarëve të komuniteteve për të shfrytëzuar këto shërbime. QKMF me përkrahjen e DSH, DMS dhe ZKKK, organizon vizita periodike në familjet e komuniteteve rom dhe askali. Qëllimi i vizitave do të jetë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë nevojtarët, dhe në të njëjtën kohë edhe informimi i familjeve për rëndësinë e përkujdesjes ndaj shëndetit.	2024 - 2026	QKMF / QMF	DSH, DMS, ZKKK	Nuk ka kosto	/	/	/	/	-	
3.1.2	Identifikimi i fëmijëve të paimunizuar dhe imunizimi i tyre	ZKKK në bashkëpunim me DSH, DMS bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që nuk iu kanë nënshtruar procesit të imunizimit. Pas identifikimit të tyre, përmes vizitave familjare, apo edhe përmes organizimit të vizitave kolektive në lokacione të caktuara, bëhet imunizimi i tyre. Ky aktivitet mund të organizohet në bashkëpunim me OJQ-të apo edhe me institucionet arsimore.	2024 - 2026	ZKKK, DSH, QKMF / QMF	OJQ-të, shkollat	Nuk ka kosto	/	/	/	/	-	
<b>Nën-Totali 3.1</b>												



Rezultati 3.2 Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali, përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të shëndetit.											
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	2024	2025	2026	Totali
3.2.1	Organizimi i ligjëratave rreth edukimit shëndetësor dhe planifikimit familjar	DSH në koordinim të ngushtë QKMF dhe QMF-të, duhet të organizojnë ligjëratat të strukturuar rreth edukimit shëndetësor për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali. Vend të rëndësishëm gjatë këtyre ligjëratave duhet të zë edhe çështja e planifikimit familjar. Për të realizuar këto ligjëratat, DSH do të bashkëpunojë edhe me OJQ lokale që punojnë në këtë fushë, por edhe me udhëheqësit e lagjeve, përkatësisht përfaqësuesit e komunitetit.	2024 - 2026	DSH, QKMF / QMF, ZKKK, ZBGJ	OJQ-të dhe donatorët	Nuk ka kosto	/	/	/	/	=
3.2.2	Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shërbimet që ofrojnë QMF	QKMF dhe QMF-të në bashkëpunim edhe me OSHC-të, duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese, ku target do të jenë familjet nga komunitetet rom dhe ashkali, me qëllim të informimit të tyre për shërbimet që ofrohen në QMF.	2024 - 2026	DSH, QKMF / QMF, ZKKK	OJQ-të dhe donatorët	Nuk ka kosto	/	/	/	/	=
3.2.3	Organizimi i vizitave periodike për mamografi – ne koordinim me ZKKK	DSH në bashkëpunim me ZKKK dhe MSH/QKUK, organizojnë vizita periodike për mamografi. Kjo mund të realizohet duke i organizuar këto vizita në QKMF apo edhe duke i organizuar vizitat në komunitet përmes Mamografit mobil që menaxhohet nga MSH.	2024 - 2026	ZKKK, DSH, Zbgj	MSH	Nuk ka kosto	/	/	/	/	=
Nën-Totali 3.2											

**Rezultati 3.3 Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik për trajtim të barabartë dhe eliminim të diskriminimit të komuniteteve rom dhe ashkali**

Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	2024	2025	2026	Totali
3.3.1	Organizimi i fushatave vetëdijësuese për ndërgjegjësimin e stafit shëndetësor për trajtim të barabartë të pacientëve	DSH në koordinim të ngushtë me QKMF dhe QMF-të, duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese për stafin shëndetësor që komunitetet rom dhe ashkali të trajtohen barabartë dhe pa asnjë diskriminim gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore	2024 - 2026	DSH, QKMF / QMF, ZKKK	OJQ-të dhe donatorët	TDH Trajnim mbi antigitizmin	/	/	/		
<b>Nën-Totali 3.3</b>											
<b>Totali i Objektivit 3:</b>											

Fusha: BANIMI

Objektivi  
4:

Rritja e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike për komunitetet rom dhe ashkali.

Janë identifikuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve për banim adekuat dhe banim social												
Rezultati 4.1	Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	B U X H E T I (EURO)			
									2024	2025	2026	Totali
	4.1.1	Hartimi i databazës së familjeve të pastrehë / familjeve në nevojë për banim	ZKKK në bashkëpunim me Komitetin për Komunitete dhe në koordinim me përfaqësuesit e komuniteteve rom dhe ashkali, bënë identifikimin e të gjitha familjeve të pastrehë apo që kanë nevojë për banim. Të dhënat e detajuara për secilën familje do të futen në një databazë, e cila do të shfrytëzohet edhe nga institucione tjera komunale. Hartimi i kësaj databaze duhet të jetë një proces i vazhdueshëm për shkak të lëvizjeve të mëdha që ndodhin, më konkretisht, për shkak të ndërrimit të vendbanimeve nga familjet, riatdhesimin e familjeve, apo për shkak të paraqitjes së rasteve të reja për banim.	2024	ZKKK	DSHMS, OJQ, Urbanizmi	Nuk kosto	/	/	/	-	
<b>Nën-Totali 4.1</b>												
<b>Totali i Objektivit 4:</b>												

Fusha: **DISKRIMINIMI**

Objektivi

5: Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimeve, paragjyimeve, stereotipeve dhe bullizmit

Rezultati 5.1	Luftimi i diskriminimit dhe racizmit në mënyrë sistematike përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave, programeve dhe projekteve						B U X H E T I (EURO)				
	Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	2024	2025	2026
5.1.1	Promovimi i platformës nacionale për mbrojtje nga diskriminimi ndaj komuniteteve Rom dhe ashkali.	Platforma për raportimin e rasteve të diskriminimit është një platformë e cila iu mundëson komuniteteve rom dhe ashkali të raportojnë antijepsizmin, diskriminimin, segregimin, gjuhën e urrejtjes, krimet e urrejtjes, stereotipet, paragjykimet. Shtet një mjete që i shërben grupit teknik për mbrojtje nga diskriminimi e themeluar nga ZK, për të trajtuar ankesat/rastet e diskriminimit ndaj komuniteteve rom dhe ashkali. Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me "Terre Des Hommes" vazhdimisht promovon platformën. Aktivitet që do të implementohen me komunën janë: promovimi i platformes permes vendosjes së	2024	ZQM, Njësi komunal për të drejtat e njeriut	OJQ, donatorë	Promovimi i platformës	TDH	-	-	-	1,000.00 €

		posterëve të platformës (me QR kod) në sportelet e Komunes, vendosja e linkut të platformës në ueb-faqen e Komunës, shpërndarja e broshurave informuese, si dhe promovimi i storjeve të suksesit. Gjithashtu, do të organizohen edhe sesione informuese mbi platformën dhe menyrën e përdorimit të saj.												
		Në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë, do të hartohet një modul i trajnimit të trajnerëve mbi antigijsizmin në Kosovë. Trajnerët e rinj do të trajnojnë zyrtarët publikë nga gjithë Kosova, përfshirë zyrtarët publikë që punojnë në institucione të ndryshme në komunën e Vushtrrisë												
5.1.2	<b>Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve publikë mbi antigijsizmin në Kosovë.</b>	2024 – 2026	IKAP, ZQM	OJQ, Donatorë	Trajnim	TDH	-	-	-	-	3,000.00 €			
5.1.3	<b>Ngritja e kapaciteteve të medieve të gazetarëve mbi antigijsizmin dhe raportimin e përgjegjshëm dhe etik</b>	2024 – 2026	IKAP, ZQM	OJQ, Donatorë	Trajnim	TDH	-	-	-	-	5,000.00 €			



## Arsyetim

Zyra për Qeverisje të mirë (ZQM/ZKM) pran zyrës së Kryministrit, ndërmori iniciativë për hartimin e Strategjisë së re për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Republikën e Kosovës. Pas një procesi të gjatë gjithëpërfshirës dhe konsultimesh me të gjithë akterët në korrik të vitit 2022 është aprovuar Strategjia për avancimin e të drejtave rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës.

Për të adresuar problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen komunitetet rom dhe ashkali Komuna e Vushtrrisë, ka iniciuar procesin e hartimit të (PVL) planit lokal të Veprimit për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrise 2024-2026.

Pas konsultimeve Komitetin Komunal Veprues është parashtruar nevoja për hartimin e (PVL), është hartuar grupi punues për hartimin e këtij draft dokumenti, konsultimet publike deri në miratimin nga Kuvendi i Komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN

Nr. / Es. 8679/24

Nr. i lq. / Et. st. -8-

Data: / Pranim. 27.02.2024

VUSHTRRI - VUČITRN



**Republika e Kosovës - Komuna e Vushtrrisë**  
**Republika Kosova- Opstina Vucitrn**  
**Republic of Kosovo- Municipality Vushtrri**

**Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim**

---

**PROCESVERBAL**

Konsultimi publik për Draft-Planin Lokal të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2024-2026.

Datë: 21.02.2024

Ora: 10:00

Të pranishëm në këtë konsultim publik ishin edhe përfaqësuesit e OSBE-së, takimin e shpalli të hapur z Ekrem Merovci i cili edhe e prezantoi draft planin, i cili plan bazohet në pesë shtylla:

1. Arsimi
2. Punësimi dhe përkujdesja sociale
3. Shëndetësia
4. Banimi
5. Diskriminimi

Tek analiza e gjendjes pati diskutime rreth numrit të komuniteteve.

**Selatin Emni**, përfaqësues i komunitetit rom, tha se në Komunën e Vushtrrisë janë 55 familje të komunitetit rom me 320 anëtar.

**Kadrije Meniqi**, zyrtare e DKA, së tha se në shkollat e komunës së Vushtrrisë të cilat punojnë me plan program të Republikës së Kosovës, nxënësit e komuniteteve nuk janë të ndarë dhe nuk ka segregacion, komunitetet janë të integruara.

**Kimete Mehana**, nga Qendra për Punë Sociale, punësimi dhe mirëqenia sociale pati një përmirësim tek shfrytëzuesit e asistencës sociale, ku tha se janë të përfshira 97 familje tek te dy komunitetet.

**Kadrije Meniqi**, zyrtare në DKA, tha se të gjithë fëmijët parashkollorë subvencionohen.



**Selatin Emini**, përfaqësues i komunitetit rom në Prelluzhë, Qendra e edukimit e cila është në fshatin Prelluzhë ku iu ndihmon fëmijëve në mësimnxënie, komuna e subvencionon pagesën e qirasë deri në vitin 2025, shprehu dëshirën që të vazhdoj me subvencionimin e qendrës edhe pas vitit 2025.

**Blerim Ibrahim**i, nga shoqëria civile, pyeti se a ka DKA qasje në shkollën e Prelluzhës,

**Kadrije Meniqi**, zyrtare në DKA, ju përgjigj kësaj pyetje e cila theksoi se DKA nuk ka qasje.

**Selim Abazi**, menaxher i Qendrës edukative për mësim plotësues të komuniteti rom, tha se komuna e paguan qiranë, lëndë djegëse, material didaktik etj, mirëpo jam i pakënaqur me kushtet që punohet në këtë qendër edhe përkundër punës dhe angazhimit të mirë të tutorëve që janë duke e bërë në këtë qendër, ne duhet ta ndihmojmë këtë qendër edhe më tutje.

**Kimete Mehana**, nga Qendra për Punë Sociale, tha se qëllimi i këtij plani është që tu ndihmohet edhe më tutje këtyre komuniteteve, në shkollimin dhe edukimin e fëmijëve në mësim të rregullt, të fillohet të mësohet në gjuhën shqipe pasi që ka edhe interesim të prindërve.

**Nermin Shaqiri**, tutor në Qendrën mësimore, tha se kemi punuar që nga 2018 nuk ka asnjë fëmijë që nuk shkon në shkollë, dhe martesat e hershme i takojnë të kaluarës sepse tani nuk ka më.

**Naser Hyseni**, nga Zyra e Punësimit, deklarata për punësim u jepet të gjithë atyre të cilët e paraqesin kërkesën në Zyrën e Punësimit.

**Adem Hoti**, qytetar i komunitetit ashkali, më intereson se a ka dikush që merr bursa nga komuniteti ashkali.

**Ekrem Merovci**, nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim , tha se të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret pa marr parasysh etnitetit e shfrytëzojnë të drejtën e bursave për shkollim.

**Hyrie Uka-Hoxha**, zyrtare nga Njësi për të drejtat e njeriut, theksoi se duhet të inkuadrohen edhe gratë e këtyre komuniteteve në trajnime të ndryshme dhe të shtohet edhe ZBGJ në plan ku ceket fushëveprimtaria e grave. Fushata për vetëdijësimin për kancerin e gjirit të shtrihet edhe për gratë e këtij komuniteti.

**Branislav Vuksanoviq**, nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim, tha se çështja e banimit duhet të rregullohet me plan sepse nevoja për zgjerimin e shtëpive të banimit është e madhe, gjithashtu të gjendet një zgjidhje që kur të ketë vërshime mos tu hyj uji nëpër shtëpitë e tyre.

**Selatin Emini**, përfaqësues i komunitetit rom në Prelluzhë, theksoi se kemi disa familje që janë duke jetuar me qira dhe nuk po kanë mundësi që ta përballojnë pagesën e qirasë, kërkojmë nga institucionet që të bëjnë diçka për këto familje.

**Remzije Zekolli**, zyrtare për Barazi gjinore në Komunën e Vushtrrisë, theksoi që duhet të futet tek fusha e diskriminimit edhe zyrtarja për barazi gjinore, zyrtari kundër diskriminimit, njësi për të drejta të njeriut dhe mekanizmi kundër dhunës në familje.

**Selatin Emini**, përfaqësues i komunitetit rom në Prelluzhë, tha se si komunitet po ndihemi të diskriminuar në kulturë dhe tradita, kur e kemi më 8 prill ditën e komunitetit rom që dy vite komuna nuk na e ka nda mjete financiare.

**Ekrem Merovci**, nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim, tha se me sa e di unë çdo vit Komuna ndan mjete për të dyja këto komunitete, por duhet të planifikohet paraprakisht, të planifikohet se çka do të organizohet dhe kërkesa të adresohet me kohë në Komunë.

**Bekim Karagjija**, përfaqësues i OSBE-së, theksoi se PLVK është gjithëpërfshirës dhe vije nga Strategjia e nivelit qendror, gjithashtu e përgëzoi komisionin për hartimin e këtij plani kaq gjithëpërfshirës.

Procesverbalit i bashkëngjitet edhe listën e pjesëmarrësve.

Procesmbajtëse

Remzije Zekolli





Republika e Kosovës - Komuna e Vushtrrisë  
 Republika Kosova- Opstina Vucitrn  
 Republic of Kosovo- Municipality Vushtrri



Zyra komunale për komunitete dhe kthim

Konsultim publik me përfaqësues të institucioneve, komunitetit rom e ashkali, shoqëria civile, lidhur me Draft Planin e Veprimit për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali 2024-2026 në komunën e Vushtrrisë  
 E mërkurë, 21 Shkurt 2024; Vendi Hotel Amazona, Milloshevé

Nr	Emri Mbiemri	Organizata	emailadresa	Nr i telefonit	Nënshkrimi
1	Agrom Perçuku	KK. VUSHTRRI	agrom.perçuku@kcs.gov.net	044-619-212	
2	Berat Adem	KK VUSHTRRI	berataademi1987@gmail.com	044-654-335	
3	Berat Maxhuni	KK Vushtrri, Per Komunitete e KK-Vushtrri	maxhuni.berat3@gmail.com	044-347-508	
4	Aktere Dërvari	KK VUSHTRRI	aktoredervari@hotmail.com	044-382-734	
5	Branislav Vuksonoviq	OKIP Vucitrn	branislav.v@live.com	045-202-976	
6	Hyrie Uea-Hoxha	KK KONDIZ Vushtrri	hyrie.uea@eops.net	044-406-916	
7	Ermete Melharu	QPS Vushtrri	ermete.melharu@gmail.com	044 926132	
8	Vildane Mula-lau	OSCE M.C.	vildane.mulajca@outlook.com	044 842 460	
9	Lemije Perdy	ZB62		045-499-161	
10	Blesim Ibrahim	OSCE "stand out"	blesim.megdullari@gmail.com	044-853-252	
11	Jylsime Beku-ferati	KK Vushtrri	jylsime.beku@hotmail.com	044/431-958	
12	Fatmir Feka	KK Vushtrri	fatmir.feka@kcs.gov.net	044 495 343	
13	Xhavit Mehmeti	Vushtrri	xhavitm@ku	044 19845	
14	Ryan Scherbin	OSCE	Ryan.scherbin@osce.org	049 344674	
15	Cordelia Lallendy	OSCE	cordelia.lallendy@osce.org	049 807093	
16	Garica Filipanoviq	OSCE	garica.segovan	045-577 281	

17	Kadrije Memici	K. Vukobratovic DKA	kadrije.memici@rks-gov.net	044 347 556	Kadrije Memici
18	Xhaurije Halili	K. Vukobratovic DKA	xhaurije.halili@rks-gov.net	044 462372	Xhaurije Halili
19	ILIRJANA AZEMI	K. VUKOBRAVIC	ilirjana.azemi@rks-gov.net	044/347-419	Ilirjana Azemi
20	Jelena Kostic	DKA	serbia.dobro@rks-gov.net	044-821-317	Jelena Kostic
21	Bijana Uliugaj	K. Vukobratovic	ugaj.bijana@rks-gov.net	044-114 628	Bijana Uliugaj
22	Bekim Cuni	Antar i Kom. Ashkali		044-280-611	Bekim Cuni
23	ADAM HOTI	perfaqsus i Kom. Ashkali		04962330	Adam Hoti
24	SELATIA EMIRI	ROMANO ANGLI		044-823-901	Selatia Emiri
25	Florentina Jaska	Romano Angli	florentina.jaska@gmail.com	-043-55597	Florentina Jaska
26	Nermin Shagiri	R.A.		0491395788	Nermin Shagiri
27	ELMA EMINI	Romano Angli	eminiemaz@gmail.com		Elma Emiri
28	ALMIR HODICI	R.A.		043823515	Almir Hodici
29	ADJIJE HODIGI	Romano Angli	adji.hodici27@gmail.com	/	A. Hodigji
30	SELAT BURGAZI	R.A.		049166869	Selat Burgazi
31	NASER HYPENI	ZRRK	nasa.hipeni@rks-gov.net	044/330-862	Naser Hipeni
32	ERKEM MEROVIC	ZRRK	erkem.merovic@rks-gov.net	044 423756	Erkem Mervic
33					
34					
35					
36					
37					
38					
39					
40					



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNAVUSHTRI



Për,  
Propozues,  
Hartues,  
Çështja për shqyrtim,

Kuvendin e Komunës  
Kryetari i Komunës  
Drejtoria për Shërbime Publike  
Propozim-vendim

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 shkronja “d” dhe 14 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 13 paragrafi 1 pika 1.4, 18 paragrafi 1 pika 1.13 dhe 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës 01nr.126/17 për Aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë 2016-2024, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2024, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VARREZA TË KAFSHËVE NË**  
**TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRISË**

**Neni 1.**

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për varreza të kafshëve në pjesë të parcelës kadastrale P-70202027-00001-1, në sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 664806 m<sup>2</sup>, kualiteti i klasës kullosë e kl. 5, Zona Kadastrale Vushtri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2.**

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Mjedisit që do të bëjnë shenjëzimin e sipërfaqes në parcelën nga pika 1 e këtij vendimi.

**Neni 3.**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit

**Neni 4.**

Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**  
**Kryesues e Kuvendit**





Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

181/622

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202027-00001-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 18-622/24  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 05.03.2024 - 10:00  
Komuna / Opština / Municipality: VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Studime E Poshtme / Donja Sudinlja / Muhaxheri I Poshtëm  
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azuritano Updated
P-70202027-00001-1	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	664806			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azuritano Updated
STRAZHBA				

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJIA / TYPE OF USE

Numbri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korisçenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno korisçenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kualiteti i klasës Quality Class	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> ) Površina (m <sup>2</sup> )
1	Bujqësore/Poljoprovredno/Agriculture	Kullosor/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 5/Pashnjak 5 Klasë/5th Class Pasture	6648/06

## B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individuálna Drzavina / Single possessor	Komuna e Vushtrritë	600335001	VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI /		AHMET KRASNIQI	1/1		





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI  
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Studime E Poshtme

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-70202027-00001-1	Parcelë / Parcela / Parcel	664806



Shkalla/Razmëra/Scale: 1:19846

Punoi/Obradio/Created: Fadil Selimi  
Nënshkrimi/Potpis/Signature:  
Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 05.03.2024  
Koha/ Vreme/ Time: 10:06:11





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Studime E Poshtme

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-70202027-00001-1	Parcelë / Parcela / Parcel	664806



Shkalla/Razmera/Scale: 1:19846

Punoi/Obradio/Created: Fadil Selimi

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 13.03.2024

Koha/ Vreme/ Time: 09:19:36

## Arsyetim

Komuna e Vushtrrisë në kuadër të reformës në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe me qëllim të implementimit të Planit Lokal për menaxhimin e mbeturinave, si dhe Rregullores për menaxhim të mbeturinave, ka ndërmarr një varg aktivitetesh për përmirësimin e gjendjes në këtë fushë. Një prej sfidave të vazhdueshme ka qenë adresimi i çështjes së kafshëve të ngordhura.

Me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi Drejtoria për Shërbime Publike së bashku me Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër ka identifikuar parcelën kadastrale P-70202027-00001, në sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 664806 m<sup>2</sup> Zona Kadastrale Vushtrri pronë e Komunës së Vushtrrisë dhe konstaton se i plotëson kriteret mjedisore për caktim të lokacionit për varreza të kafshëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Prandaj bazuar në këtë kemi propozuar caktimin e këtij lokacioni për varrimin e kafshëve të ngordhura.

Drejtori i Drejtorisë



Benjamin Shala



Formulari per kerkese apo ankese

Drejtorati/Njesia  
Kuvendi i Komunës

Data 05/03/2024

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

Avdi Mehmeti

Numri personal

1021289201

Adresa e vendbanimit

Vushtrri

E-mail Adresa

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

44237293

2. Mënyra e pranimit

Peticion

Statusi i lëndës

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

01-104/02-0009910/24

Afati i zgjedhjes

04/04/2024

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kerkese -Peticion

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Avdi Mehmeti vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

\*Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: berat.januzi

PËR : Kuvendin komunal të komunës së Vushtrrisë-znjh.Melihate Bashollit

CC: Asamblistëve të kuvendit komunal-Vushtrri

LËNDA: PETICION

VENDI : VUSHTRRI

MË : 06.03.2024

## P E T I C I O N

A)Baza ligjore të peticionit është neni 69 i LIGJIT NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE

B)Situata/Çështja që nxiti dorëzimin e këtij peticioni është: Njoftimet për rënimin e lokaleve.

Parashtruesit e këtij peticioni janë qiramarrës të tokës komunale,në pronësi të komunës së Vushtrrisë,dhe atë në bazë të kontratave për qiradhënie të lidhura në mes të komunës së Vushtrrisë dhe parashtruesve të këtij peticioni. Objektet-lokalet gjinden në rrugën"Avni Saraqi",të regjistruara si pjesë e parcelës tokësore-Certifikatës Njësia Kadastrale **P-702022016-00001-1,Z.K.-Vushtrri**,pronë e komunës së Vushtrrisë.

Disa parashtrues të këtij peticioni kanë kontrata afatshkurta e disa kanë kontrata të plotfuqishme me komunën e Vushtrrisë deri më dt.04.12.2032.

Më dt.21.09.2023 parashtruesit e këtij peticioni kanë pranuar njoftime nga ana e Remzi Ahmetit-Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër pranë komunës së Vushtrrisë.Përmes këtyre njoftimeve parashtruesit e këtij peticioni njoftohen për fillimin e procedurës për shkëputje të parakohshme të kontratës nga ana e qiradhënësit-komunës së Vushtrrisë.Si "alibi"e shkëputjes së parakohshme të kontratës potencohet zgjerimi i rrugës"Avni Saraqi"si dhe ndërtimi i trotuarit dhe infrastrukturës përcjellëse,dhe se ekziston interesi publik,pa e arsyetuar fare interesin publik.

Poashtu neve na tërhiqet vërejtja se duhet liruar hapsira të cilën e kem marrë me qirra brenda 1 muaji.

Poashtu më dt.28.09.2023 pranojmë prapë një njoftim nga i njejtë organ(person),pothuajse me përmbajtje të njejtë,porse tani afati për lirim është 4 muaj.

Më dt.26.02.2024, inspektorati komunal i komunës së Vushtrrisë bënë inspektim në lokalet afariste dhe me këtë rast lëshon procesverbal për lirim të hapsirës publike ku parashtruesit i kanë të ndërtuar lokalet,dhe duke na caktuar afat prej 15 ditësh për lirim të hapsirës.Inspektorati me këtë rast nuk jep asnjë arsyetim ligjor se pse duhet t'a lirojmë hapësirën publike.

Ju bëjmë me dije se hapësira publike ku i kemi të ndërtuar lokalet afariste është pronë e komunës së Vushtrrisë,hapsirë e marr me qirra nga ana e parashtruesve të këtij peticioni dhe atë që nga viti 2005.Lokalet afariste që ekzekutivi i komunës kërkon t'i rënojmë janë ndërtuar me mjete financiare nga vet parashtruesit e peticionit.Në atë kohë,komuna na ka ndarë vetëm hapsirën-tokën për ndërtim,kurse ne me mjete financiare vetanake kemi bërë ndërtimin e lokaleve ekzistuese.

Ekzekutivi i komunës së Vushtrrisë neve e ka pasur për obligim të na njoftojë për planet që janë me interes publik siq parashihet me nenin 68 par.3 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale.

Deputet të nderuar të kuvendit komunal-Vushtrri,ne kërkojmë nga ana e juaj që të na dilni në ndihmë,duke penguar rrënimin e 7-8 lokaleve afariste që janë ndërtuar në pronën komunale,sepse neve nga ato lokale e sigurojmë ekzistencën e familjeve tona dhe të punëtorëve,ku numri i të punësuarëve në këto lokale arrin 23.

Deputet të nderuar ju informojmë se nuk qëndron arsyetimi i ekzekutivit të komunës,se rënimi i këtyre lokaleve është në interes publik.Ku ekziston interesi publik i komunës për mbyllje të 8 biznesve dhe lënia në rrugë e së paku 23 punëtorëve.Arsyetimi i ekzekutivit të komunës(Qeverisë lokale) se rënimi i lokaleve për zgjerimin e rrugës"Avni Saraqi",nuk qëndron sepse lokalet tona nuk e pengojnë zgjerimin e rrugës në fjalë,e poashtu ju njoftojmë se zgjerimi i rrugës në fjalë veq ka përfunduar,kurse projekt tjetër ekzekutivi i komunës nuk ka ofruar.

Në rast se nuk mund të pengohet rënimi i lokaleve kërkojmë nga ju që t'a obligoni ekzekutivin e komunës që t'na bëjë kompenzimin e loklave ,sepse të njejtat lokale i kemi ndërtuar ne me mjetet tona financiare,ose të obligohet ekzekutivi të na sigurojë ndonjë lokacion tjetër për ndërtimin e lokaleve (parcela komunale ku afaron UNITETI Sh.a.),afër Trafos kryesore të qytetit,si dhe të obligohet ekzekutivi I komunës që me mjete të veta të bëjë ndërtimin e lokaleve(provizore),ndërsa ne do të vazhdonim me pagesën e qirasë.Ne deklarojmë se ende që nga pandemia po ballafaqohemi me kriza financiare si shumica e bizneseve të komunës.

Ne ju përkujtojmë se në të kaluarën bartësit e ekzekutivit të komunës zotoheshin se do të jenë në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve lokale,ndërsa në praktikë fatkeqësishtë po ndodh e kundërta.

Poashtu edhe njëherë ju njoftojmë se komuna e Vushtrrisë është pronare e hapsirës publike dhe se e njejta nuk ka investuar asnjë cent në ndërtimin e lokaleve afariste,të cilat synon t'i rrënojë.Kjo vërtetohet edhe me parashtrësat-Njoftimet e organeve komunale ,e ku nga përmbajtja e parashtrësave rezulton se të njejtit kërkojnë lirimin e hapsirës komunale të marrë me qera e askund në asnjë parashtrësë të njejtit nuk i referohen lokaleve afariste.

Të nderuar asamblist luteni nga ana e jonë të ndërmerni të gjitha hapat e duhur ligjor në realizimin e kërkesave tona legjitime .

Ne poshtë të nënshkruarit deklarojmë me përgjegjësinë tonë se informacioni që kem dhënë është i vërtetë dhe i saktë, dhe se nënshkrimet që kem bërë janë autentik, dhe se ne kem mbështetur këtë peticion vetëm një herë.

Parashtruesit e Peticionit:

Nr.	Emri	Mbiemri	Nr.Tel	Nr.ID	Firma/Nënshkrimi
1.	Luan	Mehmeti	044-147-397	1004746526	
2.	Aurora	Istrefi	049-663430	1251658761	
3.	Adem	Gela	044-213-587	1004733629	
4.	Esida	Osmani	049-837-636	1012360645	

Peticionit ia bashkangjesim dokumentet shoqëruese





Republika e Kosovës



Komuna Vushtri

Drejtoria për Inspektime

# PROCESVERBAL

000200

Mbi inspektimin e kryer

Luan Mehmeti

Emri tregtar i subjektit afarist

Vushtri

lokali me seli

Tahir Sinani

rruga

Luan Mehmeti

NRB/Nr.Fiks

Pronari i subjektit afarist

Vushtri, rr" Lelija e Leljes"

vendbanim (rruga/Komuna)

1004746526

Nr.Lnj

Inspektimi është kryer me datë:

26.02

20

24

ora

10:00

, dhe është konstatuar :

Personi i kontaktuar është shprehur i pronës komerciale.

Moti për shprehjen ka shkolluar më 31.12.2019.

Personi momentalisht nuk posedon asnjë kontratë të re për shprehjen.

Në bazë të gjendjes të konstatuar:

15.03.2024

Ushtrohet që në afat prej 15 ditësh të llogaritjes publike.

Procesverbali u përpilua në kopje të mjaftueshme si për organin zyrtar ashtu edhe për palën

Pronari - pala prezente

Emri dhe mbiemri

Luan Mehmeti

Nënshkrimi

[Signature]

INSPEKTORI - RËT

1.

Sh. Behrami

nënshkrimi

2.

E. Januzi

nënshkrimi



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATE/A	28.09.2023
REFERENC-Ë:	18 nr.49/23
PËR/ZA/TO:	Ersida Osmani rr. Jeton Terstena , Vushtrri
PËRMES/PREKO/THROUGH NGA/OD/FROM:	z. Remzi Ahmeti Drejtor i drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për fillimin e procedurës për shkëputje të parakohshme të Kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për shkak të interesit publik

E Nderuar,

Në bazë të Kontratës për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afarist Nr.02/1370/17, dt.08.12.2017, jeni palë kontraktuese si qiramarrës i pronës komunale-lokalit afarist në rr. "Avni Saraqi" në sipërfaqe prej 48.84m<sup>2</sup>.

Në nenin 5 pika 2 të kontratës është parapa mundësia e shkëputjes së parakohshme të kontratës nëse komuna ka interes publik, pasi të jetë njoftuar me shkrim qiramarrësi një muaj para ndërprerjes së njëanshme të kontratës për shkak të interesit publik.

Ju njoftojmë se Komuna e Vushtrrisë në planin e realizimit të projekteve kapitale për këtë vit ka parapa zgjerimin e rrugës "Avni Saraqi" si dhe ndërtimin e trotuarit dhe infrastrukturës përcjellëse.

Me qëllim të implementimit të këtij projekti nga ju kërkojmë që brenda afatit prej 1 muaj nga dita e pranimit të këtij njoftimi të e largoni lokalit të cilin e keni të vendosur në pronën e komunës në bazë të kontratës për qiramarrje në mënyrë që komuna të mund të zhvilloj projektin në fjalë.

Në rast se brenda 4 muajsh nuk lirohet hapësira të cilën e keni marr me qira në bazë të kontratës nga komuna, atëherë do të jemi të detyruar që të ndërmarrim veprime ligjore konform legjislacionit në fuqi.

Me Respekt






REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

DATE/A	21.09.2023
REFERENC-Ë:	18 nr.44/23
PËR/ZA/TO:	Ersida Osmani rr. Jeton Terstena ,Vushtrri
PËRMES/PREKO/THROUGH	z. Remzi Ahmeti Drejtor i drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër
NGA/OD/FROM:	z. Ilmi Zeqiri Menaxher për zbatimin e Kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për fillimin e procedurës për shkëputje të parakohshme të Kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për shkak të interesit publik



E Nderuar,

Në bazë të Kontratës për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afarist Nr.02/1370/17, dt.08.12.2017, jeni palë kontraktuese si qiramarrës i pronës komunale-lokalit afarist në rr. "Avni Saraqi" në sipërfaqe prej 48.84m<sup>2</sup>.

Në nenin 5 pika 2 të kontratës është parapa mundësia e shkëputjes së parakohshme të kontratës nëse komuna ka interes publik, pasi të jetë njoftuar me shkrim qiramarrësi një muaj para ndërprerjes së njëanshme të kontratës për shkak të interesit publik.

Ju njoftojmë se Komuna e Vushtrrisë në planin e realizimit të projekteve kapitale për këtë vit ka parapa zgjerimin e rrugës "Avni Saraqi" si dhe ndërtimin e trotuarit dhe infrastrukturës përcjellëse.

Me qëllim të implementimit të këtij projekti nga ju kërkojmë që brenda afatit prej 1 muaj nga dita e pranimit të këtij njoftimi të e largoni lokalit të cilin e keni të vendosur në pronën e komunës në bazë të kontratës për qiramarrje në mënyrë që komuna të mund të zhvilloj projektin në fjalë.

Në rast se brenda 1 muaj nuk lirohet hapësira të cilën e keni marr me qira në bazë të kontratës nga komuna, atëherë do të jemi të detyruar që të ndërmarrim veprime ligjore konform legjislacionit në fuqi.

Me Respekt






**Republika e Kosovës**



**Komuna e Vushtrrisë**

Për: Kuvendin e Komunës  
Propozues:  Kryetari i Komunës  
Hartues: Zyra e Kryetarit  
Tema: Propozim – vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2023, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË VENDIMIT**

1. Me këtë vendim ndryshohet vendimi 01 Nr. 24/22 date.31.01.2022 për themelimin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si vijon

1.1 Në paragrafin 1, pika 1.9, z.Ejup Haziri, caktohet anëtar i KKS-së kurse z.Shemsi Rrahimi, pushon të jetë anëtar i KKS-së, sipas nenit 4, pika 1.9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Melihate Basholli Latifi  
Kryesuese e Kuvendit

## Arsyetim

Vendimi 01 Nr.24/22 datës 31.01.2022 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ndryshohet në bazë të nenit 15 pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL Për Këshillat Komunale Për Siguri në Bashkësi. Propozimi për ndryshim të këtij vendimi është dhënë për arsye si në vijim:

- Ejup Haziri, në mbledhjen e mbajtur më 26.02.2024 është zgjedhur Kryetar i Bashkësisë Islame (KBI) në Vushtrri, i cili poashtu duhet të jetë anëtar i KKSB-së sipas Udhëzimit Administrativ të cekur më lart.

Bazuar në të cekurat më sipër, i propozohet kuvendit të komunës që ta miratojë këtë propozim vendim si në dispozitiv.

## Kuvendi Komunal Vushtrri

---

**From:** Qemajl.Xh Hasani  
**Sent:** Monday, March 11, 2024 9:06 AM  
**To:** Kuvendi Komunal Vushtrri  
**Cc:** Melihate Basholli Latifi  
**Subject:** RE: Rikujtim lidhur me procedimin e materialit për mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

I/E nderuar,

Ju njoftojë se në Ndërmarrjen Publike Lokale "Përparimi" SH.A., në këtë kohë që po shkruajmë janë duke u zhvilluar aktiviteti I auditimit.

Auditori është në proces të auditimit të raportit ku mendohet që do përfundojë deri në fund të këtij muaji, pas përfundimit të këtij procesi për muajin Prill do te jetë gjithë çka e përgatitur.

Me respekt

Qemajl Hasani  
Kryesues i KKA i NPL "Perparimi"SH.A.

**From:** Kuvendi Komunal Vushtrri <kuvendi.vushtrri@rks-gov.net>  
**Sent:** Wednesday, March 6, 2024 9:41 AM  
**To:** Qemajl.Xh Hasani <qemajl.xh.hasani@rks-gov.net>  
**Subject:** FW: Rikujtim lidhur me procedimin e materialit për mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

**From:** Kuvendi Komunal Vushtrri  
**Sent:** Tuesday, March 5, 2024 2:48 PM  
**To:** Remzi N Ahmeti <remzi.n.ahmeti@rks-gov.net>; Hava Mlinaku <hava.mlinaku@rks-gov.net>; Fortuna Krasniqi <fortuna.krasniqi@rks-gov.net>; Lorik.Maxhuni <Lorik.Maxhuni@rks-gov.net>; Benjamin Shala <benjamin.shala@rks-gov.net>; Maliq Ferizi <maliq.ferizi@rks-gov.net>; Medina Bunjaku <medina.bunjaku@rks-gov.net>; Ergin Sunguri <ergin.sunguri@rks-gov.net>; Albanez Tahiraj <albanez.tahiraj@rks-gov.net>; Bujar Pllana <bujar.pllana@rks-gov.net>; Isuf Jashari <isuf.jashari@rks-gov.net>; Ilmi Azemi <ilmi.azemi@rks-gov.net>; 'raif.lahu@rks-gov.net' <raif.lahu@rks-gov.net>  
**Cc:** Ferit Idrizi <Ferit.Idrizi@rks-gov.net>; Shpetim Zhegrova <shpetim.zhegrova@rks-gov.net>; Melihate Basholli Latifi <melihate.basholli.latifi@rks-gov.net>  
**Subject:** Rikujtim lidhur me procedimin e materialit për mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Të nderuar drejtorë të drejtorive,

Gjeni të bashkëngjitura pikat që janë planifikuar në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për muajin mars 2024, për t'i proceduar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Me respekt

Sekretaria e kuvendit